

Janar 2014
Numri: 70
E përmuajshme


Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den

ETIKA

Qetësia në

FAMILLJE



SHËRBIMI PËR HIR TË ALLAHUT
NË JETËN E PEJGAMBERIT (A.S.)
OSMAN NURI TOPBASH



XHAFER DURMUGH
BILANCI I JETËS
NË FILLIM TË VITIT



NUREDIN JËLLDËZ
FETARIA E VETËDIJSHME



INTERVISTË ME
MASSIMO JEVOLELLA-S PËR LIBRIN
"RRËNJËT ISLAMIKE TË EVROPËS"



JE MYSAFIRE NË KËTË HAN
O ZEMËR!
SALIH ZEKI MERIÇ



SADIK DANA
GRADAT E ZEMRËS



ISSN 2227-3611
9 772227 361004 0 1

Janar 2014

VITI: VIII
NUMRI: 70

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Albert Halili
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 607 8484

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrove të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

"Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë."
(Rrum, 21.)

Nga ajeti kuranor kuptojmë që familja nuk është një dukuri individuale, që fillon dhe mbaron me një grup të vogël individësh. Përkundrazi, ajo është bërthama e shoqërisë, prej së cilës varet ekzistenca e shoqërisë. Prandaj Kurani e fton shoqërinë të mendojë thellë mbi familjen.

Nëse në familje nuk ka dashuri, por urrejtje, shoqëria duhet të shqetësohet.

Nëse në familje nuk ka mëshirë, por ashpërsi, shoqëria përsëri duhet të shqetësohet.

Nëse familja ka një sëmundje, atëherë shoqëria është e rrishtuar nga kjo sëmundje.

Nëse familja vuan nga ndonjë sëmbim, atëherë duhen rishikuar koordinatat e tri pikave që prek ajeti kuranor.

Për të arritur qetësinë në familje, është e domosdoshme dashuria dhe mëshira. Nga ajeti kuptojmë që Allahu e ka krijuar njeriun të aftë dhe të prirur për të dashur dhe mëshiruar. Po ashtu, nga ajeti kuptojmë që, kur hyhet nën çatinë e familjes, Allahu e rrit përqendrimin e dashurisë dhe mëshirës në zemrat e njerëzve.

Një mësim tjetër që nxjerrim nga ajeti, është se martesë është një rrugëtim drejt realizimit të dashurisë dhe mëshirës.

Mbushja e zemrave me dashuri dhe mëshirë duhet të jetë mision i familjes, shkollës, xhamisë, medias etj. Dashu-

ria dhe mëshira duhet të jenë pjesë e programeve edukative. Mbrujtja e zemrave me dashuri dhe mëshirë, do të sjellë manifestim të cilësive hyjnore në qenien tonë.

Nevoja për dashuri dhe mëshirë është e domosdoshme më tepër se kurrë në ditët tona, kur dashuria dhe mëshira midis bashkëshortëve dhe individëve është rrënuar.

Por në dashuri dhe mëshirë duhet të kërkojmë përmasën hyjnore të tyre. Prandaj zemrat duhet të përgatiten, në mënyrë që të jenë të përshtatshme për manifestimin e mëshirës dhe dashurisë.

Gjuha dhe zemra duhet të jenë vazhdimisht në gjendje dhikri dhe lutjeje.

Sepse dashuria dhe mëshira në familje kërkon përpjekje. Për zhvillimin dhe kultivimin e dashurisë dhe mëshirës, bashkëshortët së pari duhet të ndërtojnë ambientin e përshtatshëm për dashurinë dhe mëshirën.

Edhe fëmijët që do të rriten në një ambient plot dashuri, në të ardhmen do të krijojnë familje me bazë dashurinë dhe mëshirën.

Nga kjo pikëpamje, familja është shkolla e dashurisë dhe mëshirës.

Të mos harrojmë se qetësia dhe prehja në familje është një dhuratë hyjnore.

Nëse nuk ia ndërpresim rrugën dashurisë dhe mëshirës, kjo dhuratë patjetër do të arrijë tek ne.

Të mos harrojmë se lumturia e dy botëve fillon prej këtu.

E lusim Allahun të kultivojë në zemrat tona dashurinë dhe mëshirën, me të cilat mund të arrijmë lumturinë në këtë botë dhe botën tjetër!

Përmbajtja



8

Bota Islame: Familja është nën kërcënim
A. Jasin Demirxhi



**Shërbimi për hir të Allahut
në jetën e Pejgamberit (a.s.)**
Osman Nuri Topbash

34



15



18

Intervistë me Massimo Jevolella-s për librin
"Rrënjët Islamike të Evropës"
Përgatiti: Zija Vukaj


- 5 **Trekëndëshi i artë:
dashuri, mëshirë, qetësi**
Ahmet Tashgetiren
- 7 **Bilanci i një viti**
Ali Byjykçapar
- 10 **Fjala dhe mbeturian**
Osman Sëkëxhë
- 12 **Pse janë shkatërruar martesat?**
Mehmet Dinç
- 15 **Gradat e zemrës**
Sadik Dana
- 16 **Trashëgimia që ka lënë Ibrahim (a.s.)**
Dr. Kerim Bulladë
- 22 **Morali apo pamja
është thelbësore për lumturinë?**
Ali Riza Temel
- 24 **Bilanci i jetës në fillim të vitit**
Xhafer Durmush



44

- Fetaria e vetëdijshme** 28
Nuredin Jëlldëz
- Varfëria e zemrës** 30
Mesut Kaja
- Një Ajet - Një Hadith** 32

- Allahu më i miri i krijuesve** 37
Selman ibn Fehd el Aude
- Je mysafire në këtë han, o zemër!** 42
Salih Zeki Meriç
- Lëvizjet e shpejta që endin rrjetën** 44
Edison Çeraj
- Si duhet respektuar Kurani** 46
Idris Arpat
- Dijetarë të robëruar pas dynjasë** 48
Prof. dr. Sulejman Derin
- Meritokracia** 50
Nuredin Nazarko
- Kultura populiste dhe rinia** 54
Prof. dr. Mehmet Gërmez



**Edukimi i të Dërguarit të Allahut (a.s.),
bazuar tek mëshira**
Semih Jollaçan

26

Ukashe ibn Mihsani (r.a.), kalorësi më i mirë
Mustafa Erish

52



Qetësia në në familje

Ahmet Tashgetiren

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.” (Rrum, 21.)

Si çdo gjë tjetër edhe marrëdhënia bashkëshortore është një nga mirësitë e shumta dhuruar njeriut nga ana e Krijuesit të gjithësisë.

Sepse është Ai, që krijoi njeriun çift.

Është Ai që mbolli dashurinë në zemrat e njeri-tjetrit.

Është Ai që gdhendi mëshirën në qeniet e tyre.

Në këtë mënyrë, ata bashkëshortët arritën qetësinë dhe lumturinë bashkëshortore dhe familjare.

Familja është një institucion shumë i rëndësishëm, mbarëvajtja e të cilit i intereson gjithë shoqërisë.

Në të gjitha këto ka mesazhe të qarta për mendimtarët.

Themeli i familjes sipas Islamit, është dashuria, mëshira dhe prehja.

Ajeti kuranor i fton të gjithë të mendojnë dhe reflek-

tojnë thellë mbi familjen.

Nga ajeti kuranor kuptojmë që familja nuk është një dukuri individuale, që fillon dhe mbaron me një grup të vogël individësh. Përkundrazi, ajo është bërthama e shoqërisë, prej së cilës varet ekzistenca e shoqërisë. Prandaj Kurani e fton shoqërinë të mendojë thellë mbi familjen.

Nëse në familje nuk ka dashuri, por urrejtje, shoqëria duhet të shqetësohet.

Nëse në familje nuk ka mëshirë, por ashpërsi, shoqëria përsëri duhet të shqetësohet.

Nëse familja ka një sëmundje, atëherë shoqëria është e rrishtuar nga kjo sëmundje.

Nëse familja vuan nga ndonjë sëmbim, atëherë duhen rishikuar koordinatat e tri pikave që prek ajeti kuranor.

A KA PROBLEME FAMILJA NË DITËT TONA?

Sigurisht që ka.

Shenjat e sëmundjes së familjes janë të përhapura në të gjitha shoqëritë.

Në shumë shoqëri është vënë në rrezik vetë ekzistenca e familjes, kurse në disa shoqëri të tjera, duke përfshirë edhe shoqërinë islame, vihet re një çorientim i koordinatave të përcaktuara nga Kurani.

Në vend që të jetë burim qetësie, familja është shndërruar në burim zënkash, grindjesh, krizash dhe divorcesh.

Kjo gjendje është tregues i qartë i humbjes së dashurisë dhe mëshirës në familje. Kjo gjendje në fakt është tregues edhe i një problemi tjetër më të madh, kjo gjendje tregon që ka probleme në marrëdhënien e njeriut me Krijuesin e gjithësisë, burimin e mëshirës dhe dashurisë.

Në momentin që marrëdhëniet e njeriut me Krijuesin dobësohen, atëherë fillojnë problemet. Kjo është e vlefshme si për familjen, ashtu edhe për shoqërinë.

Është gabim i madh të mendosh që këto probleme nuk kanë lidhje me marrëdhënien e njeriut me Krijuesin.

Sepse dashuria dhe mëshira që ne kemi, burojnë prej emrave të bukur të Allahut, "El Vedud" dhe "Er Rahman. Er Rahim".

Nëse dëshirojmë që në familjet tona të mbjellim dashurinë dhe mëshirën, jemi të detyruar të lidhemi me burimin e tyre.

Por cila është pika lidhëse e njeriut me burimin e dashurisë dhe mëshirës? Pika lidhëse është ibadeti.

Pra, për të krijuar një atmosferë dashurie, dhembshurie dhe mëshire në familje, nuk duhet harruar në asnjë mënyrë ibadeti ndaj Allahut.

Familja nuk duhet shndërruar në një arenë për sundim dhe pushtet. Familja është mjedisi ku gjithësecili është në statusin e adhuruesit. Në fakt, gjithë jeta shoqërore është e tillë. Të gjithë njerëzit, si i pasuri, i varfri, i shëndetshmi, i sëmurë, sunduesi, i sunduari etj., me gjithë statusin e veçantë që mund të kenë në shoqëri, përballë Allahut janë në statusin e adhuruesit.

Nëse ndërgjegjësimi për ibadetin vendoset në zemër, realizohet edhe diçka tjetër, siç është vetëdija për mbikëqyrjen hyjnore. Pra, njeriu fillon të jetojë me vetëdijen e plotë sikur e shikon Allahun. Pas kësaj, njeriu hyn në garë për të fituar dashurinë dhe pëlqimin e Allahut.

Vetëdijësimi për ibadetin lind ndjeshmërinë për respektimin e të drejtave të tjetrit.

Respektimi i të drejtave të tjetrit në mjedisin familjar është neglizhuar. Mirëpo, e vërteta është se çdo fjalë e rëndë, fyerje apo përdorim force ndaj njëri-tjetrit është objekt i gjykitimit hyjnor. Dhe përballë gjykitimit hyjnor nuk ka dallim midis femrës dhe mashkullit.

Të gjitha këto janë shumë të rëndësishme për një shoqëri që mendon thellë.

Për të arritur qetësinë në familje, është e domosdoshme dashuria dhe mëshira. Nga ajeti kuptojmë që Allahu e ka krijuar njeriun të aftë dhe të prirur për të dashur dhe mëshiruar. Po ashtu, nga ajeti kuptojmë që, kur hyhet nën çatinë e familjes, Allahu e rrit përqendrimin e dashurisë dhe mëshirës në zemrat e njerëzve.

Pra, njeriu që bën përpjekje për përmbushjen e qëllimit hyjnor, patjetër që do të drejtohet nga dashuria dhe mëshira. Kurse mungesa e dashurisë dhe mëshirës në familje sjell ndërprerjen e dashurisë dhe mëshirës në zemrat e njerëzve.

Një mësim tjetër që nxjerrim nga ajeti, është se martesë është një rrugëtim drejt realizimit të dashurisë dhe mëshirës.

Mbushja e zemrave me dashuri dhe mëshirë duhet të jetë mision i familjes, shkollës, xhamisë, medias etj. Dashuria dhe mëshira duhet të jenë pjesë e programeve edukative. Mbrujtja e zemrave me dashuri dhe mëshirë, do të sjellë manifestim të cilësive hyjnore në qenien tonë.

Nevoja për dashuri dhe mëshirë është e domosdoshme më tepër se kurrë në ditët tona, kur dashuria dhe mëshira midis bashkëshortëve dhe individëve është rrënuar.

Por në dashuri dhe mëshirë duhet të kërkojmë përmasën hyjnore të tyre. Prandaj zemrat duhet të përgatiten, në mënyrë që të jenë të përshtatshme për manifestimin e mëshirës dhe dashurisë.

Gjuha dhe zemra duhet të jenë vazhdimisht në gjendje dhikri dhe lutjeje.

Sepse dashuria dhe mëshira në familje kërkon përpjekje. Për zhvillimin dhe kultivimin e dashurisë dhe mëshirës, bashkëshortët së pari duhet të ndërtojnë ambientin e përshtatshëm për dashurinë dhe mëshirën.

Edhe fëmijët që do të rriten në një ambient plot dashuri, në të ardhmen do të krijojnë familje me bazë dashurinë dhe mëshirën.

Nga kjo pikëpamje, familja është shkolla e dashurisë dhe mëshirës.

Të mos harrojmë se qetësia dhe prehja në familje është një dhuratë hyjnore.

Nëse nuk ia ndërpresim rrugën dashurisë dhe mëshirës, kjo dhuratë patjetër do të arrijë tek ne.

Të mos harrojmë se lumturia e dy botëve fillon prej këtu.

E lusim Allahun të kultivojë në zemrat tona dashurinë dhe mëshirën, me të cilat mund të arrijmë lumturinë në këtë botë dhe botën tjetër!

Bilanci

i një vit

All Byjyqçapar

E lamë edhe një vit tjetër pas. Llogaria e së shkuarës i përket Allahut, kurse për të ardhmen tonë nuk dimë asgjë.

Ekzistenca jonë është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me kohën. Çdo gjë ndodh në kufijtë e kohës. Të kaluarën e kemi lënë pas, të ardhmen para, kurse ne jemi në të tashmen. Pjesa më e madhe e njerëzve nuk e njohin si duhet kohën dhe përpiqen t'i shmangen asaj, duke harruar që në këtë mënyrë shndërrohen në robër të saj.

Burimi i të gjitha problemeve dhe telasheve jemi vete ne. Sepse jeta e atyre që nuk njohin qëllimin e krijimit, qëllimin e adhurimit, dashurinë profetike dhe takvanë, është e predispozuar të jetë e mbushur me telashe.

Dera e pendimit është e hapur deri në çastet e fundit të jetës dhe kijametit. Karshi kohës ne mund të dalim fitimtarë vetëm nëse e programojmë jetën sipas qëllimit të krijimit dhe përgatitemi sipas ajetit: **“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju! Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit** (ndaj Allahut).” (Hashr, 18-19.)

Njeriu nuk është krijuar pa qëllim, qëllimi i krijimit të njeriut është ibadeti dhe të gjitha mirësitë dhe fatkeqësitë e kësaj bote, si jeta, vdekja, pasuria, fëmijët, e mira, e keqia etj., janë mjete sprove për njeriun.

Qëllimi i krijimit është burimi i energjisë sonë. Nëse ne jemi të përgjegjshëm për qëllimin dhe i kryejmë me rigorizitet detyrat që na takojnë në funksion të qëllimit, atëherë e ardhmja, e cila është e panjohur bëhet e njohur për ne.

Është koha e duhur për t'i çuar më larg mësimet e fesë islame. Për një vit sa më produktiv, duhet që të gjitha veprimet tona t'i kalojmë në peshoren e besimit. Vetëm në këtë mënyrë nuk do ta ndjejmë nevojën për pendim dhe keqardhje.

Çdo ditë e re ofron një mundësi të re. T'i lutemi Allahut që mundësitë e ofruara t'i shfrytëzojmë në përputhje me mësimet e Tij. Vetëm në këtë mënyrë sigurojmë lumturinë në këtë botë dhe në botën tjetër.

Pritja e ahiretit për të bërë gjykimin dhe bilancin e jetës, nuk ka asnjë dobi për njeriun. Çdo moment duhet ta jetojmë në atë mënyrë që të jemi në gjendje t'ia bëjmë bilancin, vetëm në këtë mënyrë mund të dalim faqebardhë para Krijuesit të gjithësisë.

BOTA ISLAME:

Familja

është

NËN KËRCËNIM

A. JasIn DemIrxhl

Fakti i ashtuquajtur globalizëm, që sjell me vete shumë probleme bashkë me favoret e saj, është një realitet i pamohueshëm që i ka dhënë frymë perëndimore botës së sotme. Familja që përbën bërthamën e shoqërisë, vjen në krye të institucioneve më të prekura nga ky proces bashkëveprimi dhe transformimi.

Ndërsa trajtojmë çështjen “**edukimi i dashurisë në familje**”, deshëm të shikonim edhe gjendjen e familjes në botën islame. U përpoqëm të vëzhgonim shkatërrimin e globalizimit në institucionin e familjes në botën islame.

Cilat çështje vijnë në rend të ditës, të cilat lidhen me strukturën e familjes në Lindjen e Mesme, që përfshin shumicën dërrmuese të botës islame? Në cilat fusha janë më të fokusuara shqetësimet në këtë kontekst? Çfarë propozojnë ekspertët e fushës dhe akademikët në pikën e zgjidhjes së problemeve që hasen në fushën e familjes? Në mediat Arabe kemi kërkuar përgjigjet e këtyre pyetjeve.

Pamë se gjendja e shteteve në Lindjen e Mesme nuk

është shumë e ndryshme nga panorama që shikojmë në vendin tonë. Madje, disa shtete nën drejtimin e dikujt, janë ballë për ballë me një tablo më seroize se ne.

Pamë se bota islame ka disa probleme të përbashkëta në çështjet, si rritja e shpejtë e raportit të divorceve, rritja mesatare e moshës së martesës, dhuna ndaj grave dhe degjenerimi kulturor që po ndodh pothuajse në të gjitha shtetet e Lindjes së Mesme, duke filluar nga vendet e Gjirit deri në Egjipt, nga shtetet e Afrikës së Veriut deri në Iran.

RAPORTI I FRIKSHËM I DIVORCEVE NË BOTËN ISLAME

Pika që theksohet dhe nënvizohet më shumë në mediat e Lindjes së Mesme, që trajtojnë çështjet e familjes, është rritja e shpejtë e raportit të divorceve. Sidomos në vendet e Gjirit, rritja e raportit të divorceve është e frikshme. Bazuar në statistikat e ofruara nga autoritetet e Kuvajtit, 40 % e martesave zyrtare që u kryen në gjysmën e parë të vitit 2009 në Kuvajt, përfunduan në divorc. Me fjalë të tjera, pothuajse një në

dy martesë kishin rezultuar në divorc.

Ndërsa, përsëri sipas shifrave të dhëna për vitin 2009, në Arabinë Saudite, nga 60 mijë ceremoni martesore, 16 mijë prej tyre kanë përfunduar me divorc. Ky raport tregon se në Arabinë Saudite, që njihet si vend konservator, në çdo tri martesë një nuk funksionon, pra shfuqizohet. Raporti i divorceve në Emiratet e Bashkuara Arabe arrin në 44 %, në Katar 30 % dhe në Rabat, i cili është kryeqyteti i Marokut, arrin deri në 46 %.

Në aspektin ekonomik mund të shohësh një tablo të njëjtë edhe në vendet e tjera të Lindjes së mesme, të cilat janë më të prapambetura se vendet e Gjirit. Për shembull, raporti i divorceve në Egjipt, i cili njihet si vendi më i populluar dhe me popullsi më fetare në rajon, me të vërtetë është shtrirë deri në limite shqetësuese. Sipas të dhënave nga burimet zyrtare të Egjiptit për vitin 2009, 40% e martesave që ndodhën në Egjipt përfunduan me divorc.

Opinion i publik arab, po diskuton tashmë me këmbëngulje arsyet e kësaj rritjeje. Ai po heton shkaqet që shkaktojnë prishjen e martesës si dhe zgjidhjet e tyre. Në lidhje me shkaqet e kësaj rritjeje të shpejtë në raportin e divorceve, renditen disa arsye si, shkatërrimi (*erozioni*) ekonomik, psikologjik, social dhe kulturor.

Ish-anëtar i Fakultetit Juridik në Universitetin Amman të Jordanisë, **Mahmud Sartavi**, një prej juristëve më të shquar në botën arabe, e lidh arsyen e rritjes progresive të divorceve me zbatimin e gabuar dhe arbitrar të legjislatcionit islam.

Sipas të dhënave që na jep **Sartavi**, shumica e të divorcuarve në Arabinë Saudite janë maturantë të universiteteve ose gjimnazeve. Sipas studimit, raporti i divorceve është në rritje, në proporcion me rritjen e nivelit të mirëqenies dhe shembull për këtë janë treguar vendet e pasura të Gjirit.

Ndërsa në analizat e tjera theksohet shpesh se pasuria që vjen me zbulimin e naftës ka sjellë dukshëm ndryshimin e mënyrës së jetesës së popujve arabë, që shquhen për konservatorizëm; shkatërrimi kulturor po përhapet me një ritëm të përshpejtuar dhe bashkë me këto struktura, ka evoluar procesi i shpërbërjes së familjes.

Sipas **Abdullah el Hamoud**, kryetar i Organizatës së ndihmave të Arabisë Saudite "**Awasser**", 70 % e arabëve që jetojnë jashtë shtetit martohen në shtetet ku banojnë. Sipas **Hamoud**-it, kjo situatë sjell me vete shumë probleme.

Çdo vit dalin për udhëtime turistike mesatarisht

7 milion persona prej banorëve të shteteve Saudite dhe të vendeve të Gjirit, të cilët shquhen si turistët që harxhojnë më shumë para në botë. Bëhet e ditur se midis këtyre, numri i atyre që nënshkruajnë martesë të përkohshme, të cilat quhen martesë verore po rritet nga dita në ditë.

Në shtetet si Egjipti, Maroku, Jemeni, Siria dhe Libani, e veçanërisht arabët e pasur, nënshkruajnë këto lloj martesash. Bëhet e ditur se shumica e vajzave të reja në Egjipt martohen përkohësisht me arabë të pasur dhe më pas mbeten në mes të katër rrugëve.

PLAGA SOCIALE QË PËRQJAK LINDJEN E MESME

Kundrejt rritjes së shpejtë në raportin e divorceve, rreziku tjetër që shfaqet në popujt e Lindjes së Mesme është rritja progresive në mesataren e moshës së martesave, e cila zë vend shpesh në mediat arabe.

Sipas studimit të specialistit të Shkencave Shoqërore në Jordani, **Dr. Ismail Ez-Zejud**, me temë "**Problemi i qëndrimit në shtëpi në Botën Arabe**", raporti i të rinjve sirianë që janë beqarë është 50 %, ndërsa raporti i të rinjve Jordanezë, që sapo kanë hyrë në moshën e martesës e ka kaluar 55 %-in.

Bëhet e ditur se në Kuvajt dhe Bahrejn, raporti i vajzave që kanë mbushur 35 vjeç dhe nuk kanë mundësi të martohen, arrin deri në 30 %.

Hulumtimi i specialistit tregon se në Irak, raporti i të rinjve, të cilët kanë mbushur moshën e martesës dhe nuk kanë mundësi të martohen, ka arritur në një nivel të frikshëm, në 85 %...

Sipas të dhënave të Institutit të Statistikës së Egjiptit, numri i të rinjve në Egjipt me popullsi prej 77 milion banorë, të cilët kanë mbushur 35 vjeç dhe nuk janë martuar ende, arrin në 9 milionë; 6 milionë prej tyre janë meshkuj, ndërsa 3 milionë janë femra.

Ndërsa në Arabinë Saudite me një popullsi prej 28 milion banorësh, bëhet e ditur se numri i vajzave që ka mbushur 30 vjeç dhe që nuk ka mundësi të martohet e ka kaluar 1 milionëshin.

Shifrat zyrtare në Algjeri tregojnë se 51 % e popullsisë së përgjithshme femra nuk është martuar fare. Theksohet se pjesa më e madhe prej 4 milion e vajzave beqare e kanë kaluar moshën 30 vjeç.

Këshilltari psikologjik Tehani Abdulhamid, nxjerr një përfundim tjetër përkrah justifikimeve ekonomike dhe sociale në lidhje me arsyet e mbetjes në shtëpi, që është kthyer në një plagë të thellë sociale në botën Arabe. Sipas **Tehanit**, "**Bota arabe po përjeton skizofreninë**

kulturore." Tehani e shpjegon kështu këtë përcaktim: "Bota arabe, që prej shumë kohë më parë, është nën ndikimin e kulturës perëndimore dhe përpiqet t'i zgjidhë problemet sociale që has, me metodat e mjekimit të planifikuara nga perëndimi."

Tehani thotë se ky përcaktim mund të shpjegohet si vijon: "Familjet në botën arabe kanë filluar ta konsiderojnë të turpshme martesën e hershme, duhe u ndikuar nga retorika e botës perëndimore. Madje, fëmijët ndiejnë një lehtësim shpirtëror, për shkak të vonimit të martesës së tyre. Megjithatë, ata nuk janë të vetëdijshëm se kanë rënë në një rrugë qorre të pakapërcyeshme. Sepse perëndimi i prezanton fëmijët me seksualizëm që në moshë të re."

Tehani thekson se, për të zgjidhur problemet e pamundësisë për t'u martuar, duhet të hiqen shumë pengesa ekonomike, sociale dhe tradicionale që dalin para martesës dhe na bën të ditur se duhet të fillojmë nga rruga për të cilën Profeti ynë i Nderuar ka thënë:

"Kur të vijë dikush, prej të cilit jeni të kënaqur nga feja dhe karakteri i tij, jepini vajzën tuaj. Nëse nuk veproni kështu, në tokë shfaqet një kaos dhe trazirë e madhe."

"O i Dërguari i Allahut, - i thanë - po në qoftë se ai është i varfër dhe nuk është aristokrat?"

Ai urdhëroi kështu: "Kur t'ju vijë dikush (për t'ju kërkuar vajzën), nga feja dhe karakteri i të cilit jeni të kënaqur, martojeni atë." dhe e përsëriti këtë tre herë.

Nuk dihet se sa përgjigje do të marrin këshillat e **Tehan-it**, por kjo plagë sociale që ka përfshirë kryekëput botën arabe, është candidate për të hapur rrugën e problemeve shumë më të mëdha. Madje e ka hapur.

Problemi i shpikjes së disa llojeve të martesave me disa fetva, të cilat i kanë kundërshtuar shumica e autoriteteve fetare, sot e ka lënë popullin arab në mesin e problemeve shumë serioze.

Si përfundim, degjenerimi kulturor që konsulenti psikologjik **Tehani Abdulhamid** e ka përkufizuar "**skizofreni kulturore**", sot është një ngjarje që ndodh jo vetëm tek popujt arabë, por tek shumica e shteteve në botën islame.

Me zhvillimin e mundësive ekonomike e teknologjike dhe me përcjelljen e rregullave të mirësjelljes deri tek fshati më i largët në kulturën perëndimore, në popujt islamë po dëshmohej një transformim i jashtëzakonshëm, jo vetëm në sensin ekonomik, por edhe në atë social. Nga ky transformim merr pjesë dhe vazhdon të marrë shumë pjesë, madje edhe struktura e familjes konservatore... Për fat të keq...

Fjala

Në kohën moderne, pothuajse çdo gjë është e tregtueshme. Pothuajse nuk ka mbetur asgjë e pashitshme dhe e pakonvertueshme në njësi monetare. Çdo gjë ka një çmim. Në treg hidhen gjëra, vlera e të cilave është e paçmueshme. Shumë gjëra, vlera e të cilave nuk mund të konvertohet në çmim, po i zhvlerësojnë në mënyrë që t'i hedhin në treg, t'i shndërrojnë në mall konsumi.

Jemi në epokën e prodhimit dhe konsumit masiv, në epokën ku prodhimi dhe konsumi masiv konsiderohen të shenjtë. Vorbulla e prodhimit dhe konsumimit masiv i ka përfshirë të gjithë, duke u shndërruar në kulturë dhe vlerë. Ata që përpiqen të kundërshtojnë dhe shpëtojnë prej kësaj kulture paragjykohe, nënvlerësohen dhe konsiderohen të prapambetur. Por në të vërtetë, prodhimi dhe konsumi masiv e çojnë njeriun drejt rrënimt. Kultura masive nuk është e bazuar në plotësimin e nevojave të njeriut, por në plotësimin e dëshirave dhe kënaqësive të tij. Njeriu, duke vrapuar pas plotësimt të dëshirave dhe kënaqësive, harron nevojat e tij.

Në këtë mënyrë, njerëzimi hyn në krizë jo nga varfëria, por nga pasuria. Marrëdhënia me Zotin është bërë horizontale. Marrëdhënia horizontale çon në devijim të qëllimit dhe zhytjen në bollëk, kurse marrëdhënia vertikale me krijuesin çon në ngjijtjen e shkallëve të përsosmërisë dhe mjaftimin me pak.

Një nga gjërat që njeriu ka hedhur në treg, është edhe "fjala". Në ditët tona "fjala" është shndërruar në objekt tregtar. Fjala duhet të

Osman Sëkëxhë

Fjala mbeturina

shërbejë si mjet për përmirësimin e jetës së njeriut.

Por, po të vështrijmë fjalët e radios, televizionit, gazetave dhe rrjeteve sociale, do të na bjerë në sy ndotja kulturore dhe shoqërore që shkaktojnë këto fjalë. Pra fjala, në vend që të shërbejë për pastrimin e shoqërisë, është shndërruar në ndotësin e saj. Në ditët tona sundimi nuk i përket fjalës, por numrit. Jetojmë në kohën ku çdo gjë vlerësohet në bazë të të dhënave numerike, madje edhe suksesi vlerësohet me numra.

Kush flet shumë, kush tregon shumë është i destinuar të jetë i suksesshëm.

Çdo ditë e më shumë po shtohet numri i njerëzve që fitojnë dhe krijojnë pasuri përmes fjalimeve. Reklamati ftojnë njerëzit të flasim më shumë. Kjo ka sjellë vlerësimin sipas numrit të fjalive dhe jo sipas kuptimit të tyre. Vlerën e fjalës nuk e përcakton më domethënia, por sasia. Fjala e urtë "Kush ka gojë flet", përkufizon pikërisht njeriun e sotëm, kurse fjalët e urta "fjala është nder", "nëse fjala është argjend, atëherë heshtja është flori", me kohë kanë marrë vendin e tyre në "muzeun e gjuhës".

Marrëveshja që bëjnë myslimanët me bankën, është bërë më e besueshme se marrëveshjet që bëjnë myslimanët midis tyre.

Përhapja e kredive dhe pothuajse humbja krejtësisht e "borxhit të mirë", tregon se si fjala e ka ndryshuar pozitën e parasë, sepse në borxh thelbësore është besimi në fjalë.

Edhe fjala është bërë pjesë e kulturës "përdor-flak", fjala, pasi del nga goja, përfundon në koshin e plehrave. Por fjala nuk është mbeturinë.

Sot ne flasim shumë dhe dëgjojmë shumë pak.

Burri nuk dëgjon gruan, gruaja nuk dëgjon burrin, fë-

mija nuk dëgjon prindërit, prindërit nuk dëgjojnë fëmijët, nxënësi nuk dëgjon mësuesin, mësuesi nuk dëgjon nxënësin e kështu me radhë. Kjo sjell mosmarrëveshje dhe mungesën e komunikimit normal. Në këtë mënyrë, lodhim njëri-tjetrin.

Në traditën profetike thelbësore është fjala e dobishme dhe heshtja. Nëse prej fjalës nuk ka dobi, atëherë vendi i takon heshtjes.

Njeriu sa më shumë flet, aq më shumë humbet, sepse sa më shumë të flasë, aq më pak e dëgjon zërin dhe fjalën e së vërtetës. Sa më shumë të shtohet numri i fjalamanëve, aq më shumë largohemi prej së vërtetës. Fjalët e tepërta janë humbje kohe, kurse humbja e kohës është humbje e njeriut. Fjala e parë e shpalljes ishte lexo, jo fol. Ne i përkasim një qytetërimi që i jep përparësi dëgjimit.

Dijogjenin e kishin pyetur se përse njeriu ka një gjuhë dhe dy veshë, filozofi ishte përgjigjur: "Që të flasë pak dhe të dëgjojë shumë." Kurse një filozof tjetër e kishin pyetur se si e kupton që një njeri është i mençur? "Nga të folurit."- ishte përgjigjur. Po nëse nuk flet, si e kupton? "Nuk ka njeri aq të mençur."- ishte përgjigjur. Sipas traditës sonë, ekziston një lidhje e ngushtë midis urtësisë dhe heshtjes.

Fjalët e shumta sjellin zhvlerësim të vlerës së fjalës dhe për pasojë, zhvlerësim të njeriut, kurse vlera e fjalës rrit vlerën e njeriut.

Shkurtimisht, njerëzit që thonë "Ju e dini" janë pakësuar, kurse ata që thonë "e di unë" janë shtuar. Njerëzit flasim shumë, por fjalët e tyre nuk kanë asnjë impakt mbi zemrat e njerëzve. Sepse fjalët e tyre nuk janë produkt i zemrës, nuk burojnë nga zemra. Fjalët e zemrës kuptohen pa folur. Ne duhet t'u mësojmë fëmijëve së pari heshtjen, pastaj të folurit.

Pse janë shkatërruar MARTESAT?

Mehmet Dinç

Jemi në një nga periudhat më sfiduese, që po përballojnë familjet në ekzistencën e tyre. Përveç shifrave të divorcit që rriten çdo ditë, ngjarjet e divorceve që shikojmë dhe dëgjojmë të gjithë, tregojnë se kanë ndryshuar shumë gjëra që dimë në lidhje me familjen. Përveç kësaj, divorcet janë vetëm maja e ajsbergut. Ekziston edhe një përmasë shumë herë më e madhe, por e nëndheshme, që nga dhuna brenda familjes, deri në vrasje, nga grindjet deri në mosmarrëveshje të thella.

Shtëpitë tona, të cilat duhet të jenë çerdhet e lumturisë, tashmë kanë filluar të perceptohen si qeli hidhërimi dhe si pasojë e kësaj, dikush ka filluar të zgjasë afatin e qëndrimit në punë për të mos shkuar në shtëpi, dikush tjetër gjen punë të reja për veten, dikush tjetër ka filluar të takohet me shokët e tij përditë; ndërsa ata që detyrohen të shkojnë në shtëpi, e ndërtojnë gjithë programin e tyre të qëndrimit në të duke parë televizor, duke lënë pas dore bashkëbisedimin brenda familjes, përveç disa fjalëve të domosdoshme.

Ndryshojnë ditët e para të martesës, muajt e parë, madje edhe ata të fundit janë të ndryshme. Dashuria, mirëkuptimi, toleranca dhe sakrificica, që tregojnë bashkëshortët ndaj njëri-tjetrit në muajt e parë, me kalimin e kohës

humbet e zhduket.

Mirëpo, përse njerëzit vijnë deri në këtë pikë? Këtu të shkon mendja te fjala e Tolstoit, të cilën e ka shkruar si parathënie në librin Ana Karenina: "Të gjitha familjet e lumtura ngjajnë me njëra-tjetrën; por çdo familje e hidhëruar ka një hidhërim tipik-unik". Megjithatë, përsëri në këtë artikull do të përpiqemi të cekim ato veprime që zakonisht i largojnë njerëzit nga familja dhe të përcaktojmë shndërrimin e individëve që bëjnë pjesë në të njëjtën shtëpi.

1. TË MARTOHEM, POR TË HIQEM SIKUR JAM VETËM

Njerëzit kanë një sistem jete me të cilin janë mësuar. Kur martohen, dashur pa dashur ky stil i jetës do të ndryshojë. Ata do të duhet të ndërtojnë një stil jete dhe një sistem të ri bashkë me bashkëshortet e tyre. Por pas martesës, njerëzit që shikojmë zakonisht në jetën e përditshme nuk duan të ndryshojnë sistemin dhe huqet e tyre paramartesore. Veçanërisht burrat dhe pikërisht ata që martohen në moshë të re, sistemin me të cilin janë mësuar duan ta vazhdojnë edhe pas martesës. Ndërkohë që një pjesë e tyre është mësuar ta kalojë pjesën më të madhe të



mbrëmjes apo darkës jashtë me shokët e vet, një pjesë tjetër është mësuar të qëndrojë vetëm, para kompjuterit, pa shoqërimin e askujt. Megjithatë duan të kalojnë kohë bashkë me bashkëshortet e tyre pas martesës, përsëri duan të vazhdojnë huqet e vjetra, përveç disa sakrificave që i bëjnë me vështirësi, pa asnjë dëshirë. Ndërsa, kur bashkëshortet e tyre thonë ndonjë fjalë të çfarëdodshme, bezdisen, mërziçen shumë ose u duket sikur po u kërkojnë diçka të jashtëzakonshme dhe i fajësojnë ato. Në të vërtetë, martesja nuk është një jetë e vetmuar dhe njeriu nuk mund ta vazhdojë jetën e tij të vetmuar pas martesës.

2. E SHKUARA NUK KA KALUAR ENDE

Procesi martesor zakonisht kalon me vështirësi dhe mundime. Veçanërisht, proceset e detajuara dhe të lodhshme, si kërkesa, fjala, fejesa, martesja, formimi i shtëpisë së re etj., mund të bëhen shkak për konfliktin e dy familjeve, që kanë kulturën të ndryshme, të cilat ndoshta nuk e njohin njëra-tjetrën. Një fjalë që thuhet, një veprim që kryhet ose një gjest që braktiset gjatë atij procesi, mund të bëhet burim ftohës dhe zemërimesh që mbarten deri në vitet e mëvonshme. Kam takuar një grua që mendonte se në vitin e nëntë të martesës, pas fëmijës së dytë, bashkëshorti i saj vazhdonte të mbante qëndrim të rreptë duke e përçmuar atë, ngaqë në blerjen e pajës kjo kishte pasë marrë 1 metër fund, në vend që të merrte 1.5 metër. Po në të vërtetë, në çdo proces që zhvillohet me kaq detaje dhe me mundime, dashur pa dashur do të ketë dhe ka pengesa dhe mangësi. Të qenët dashamirës, tolerantë, lehtësues dhe falës nga ana e bashkëshortëve, me në krye të mëdhenjtë e familjes gjatë këtij procesi, është kusht për të zhvilluar për një kohë të gjatë një martesë të lumtur.

3. AMBICIET NIK DINË TË NDALEN

Nuk ka asgjë më të natyrshme dhe normale se sa ambiciet e qarta që kanë bashkëshortët ndaj njëri-tjetrit. Por është kusht i domosdoshëm që të dyja palët të jenë të logjikshëm dhe të mirëkuptueshëm gjatë zhvillimit dhe procesit të këtyre ambicieve. Martesa nuk është një bashkëjetesë, që jetohet dhe programohet për një afat të caktuar. Për rrjedhim, bashkëshortët mund të mos kenë mundësi t'ia përmbushin pretendimet njëri-tjetrit në çdo kohë.

Për shembull: është e padrejtë që një grua për shkak të ambicieve apo pretendimeve me tepri të presë që burri i saj, të jetë gjithmonë një njeri që mirëmban fizikun dhe veshjen e vet, i aftë të kujdeset për nevojat e shtëpisë dhe fitimin e ushqimit, të ketë preokupim maksimal në lidhje me të gjitha çështjet që lidhen me fëmijët e tij dhe të ketë gjithmonë performancë të shkëlqyer në zgjidhjen e problemeve të veta. Është normale që një bashkëshorte të presë që bashkëshorti i saj të jetë i mirëmbajtur, i aftë dhe i interesuar për të, por nuk është e mundur dhe e drejtë t'i presë këto në çdo moment në nivelin më të lartë, ngaqë ajo që pret është diçka e pamundur. Përsëri, mund të jetë e pamundur që një zotëri të jetë gjithnjë fytyrëqeshur, orator, të shpreh interes, të ndihmojë gjithnjë bashkëshorten e tij, të jetë tolerant dhe i mirëkuptueshëm në çdo situatë, të kujtojë dhe të kryejë çdo gjë që i thotë

bashkëshortja e tij. Në këtë drejtim është e rëndësishme për një martesë të lumtur që zonja të tregojë mirëkuptim, duke mos humbur dashurinë e bashkëshortit të vet.

4. FATI I MARTESËS NUK ËSHTË VETËM NË DORËN E DY NJERËZVE:

Në martesja, të dy palët duhet të forcojnë ekzistencën e familjes së tyre, ta lehtësojnë dhe ta pasurojnë atë. Por për fat të keq, kjo nuk ndodh në praktikë, përkundrazi ata ndër marrin një funksion shkatërrues, vështirësues dhe prodhues të problemeve. Në shumë aspekte, si p.sh. përcjellja e një problemi ose mosmarrëveshjeje midis bashkëshortëve të mëdhenjtë, ankesa e të mëdhenjve për një bashkëshort tek tjetri për shkaqe të ndryshme, reflektimi i mosmarrëveshjeve që kanë të mëdhenjtë midis tyre tek marrëdhëniet e tyre me çiftet, mospozicionimi i mirë i bashkëshortëve, i bashkëshorteve dhe i të mëdhenjve brenda familjes, e dëmtojnë shumë martesën. Ndërrhyrja e të mëdhenjve në marrëdhëniet midis bashkëshortëve, në situatat e ndryshme në shtëpi ose në qëndrimin e tyre në edukimin e fëmijëve, padrejtësia e qartë që bëjnë midis fëmijëve dhe sjelljet e dyzuara, etj., e rrënojnë martesën.

Situata që krijohet në fund, nuk i bën të lumtur as bashkëshortët e as familjen e gjerë. Për rrjedhim, është shumë e rëndësishme për mbarëvajtjen e martesës që të mëdhenjtë të ndërmarrin një veprimtari më kreative e riparuese dhe të preokupohen me punë më të



dobishme, në vend që të merren me nuset ose me dhëndurrët e tyre në kohën e lirë.

5. EKZISTOJNË LISTA TË ZEZA:

Asnjë martesë nuk kalon gjithnjë e lumtur dhe e gëzuar. Çdo marrëdhënie ka kohë të vështira dhe periudha të mërzitshme. Ato që përjetohen dhe thuhën gjatë këtyre periudhave, shkruhen në listat e zeza; dhe sa herë që gjendet mundësia për t'i hapur këto lista, pa asnjë dyshim, martesë ndikohet negativisht nga kjo gjendje. Megjithatë, dje ndodhi ajo që ngjau dje, sot po ndodh ajo që po ngjet sot. Nëse ia shtojmë asaj që ndodhi sot edhe atë që ndodhi dje, bëhet e pamundur zgjidhja e saj. Prandaj, për një martesë të lumtur lista e zezë duhet të griset e të flaket një orë e më parë.

6. ZAKONET E KËQJA I VRASIN MARRËDHËNIET:

Një zakon i keq (*huq, ves*), që ka njëri prej bashkëshortëve, si: duhani, alkooli, kumari, etj, mund të bëhet shkak për amortizimin dhe këputjen e lidhjes martesore. Ashtu si alkooli dhe kumari, edhe vartësia ndaj televizorit dhe kompjuterit mund t'i hap rrugë problemeve në çift. Një zotëri i martuar me një zonjë, e cila gjendet para televizorit kur ai hyn në shtëpi dhe e lë atë para televizorit kur shkon të flejë, ose një zonjë e martuar me një zotëri, i cili sa hyn në shtëpi ngulet para televizorit dhe që gjithashtu kalon të gjithë kohën para kompjuterit, nuk mund ta mbajnë të shëndoshë për një afat të gjatë martesën e tyre.

7. MARTESA KËRKON PËRGATITJE

Para martesës, një zonjë dhe një zotëri, patjetër dhe padyshim duhet të përgatiten për martesë. Kjo përgatitje duhet të ketë një gamë të gjerë përtej lavatriçes, lavastoviljes, pajës, tantellave, etj. Ajo fillon nga njohuritë seksuale deri tek njohuritë psikologjike, nga aftësia për të gatuar deri tek aftësia për të bërë pazarin e shtëpisë. Nuk është e drejtë dhe e logjikshme për njeriun, i cili studion dhe merr edukim për vite të tëra për të hyrë në punë, të mos lexojë diçka dhe të mos marrë aspak edukim para se të martohet.

8. DËSHTIMET E TË TJERËVE

Njerëzit që janë të shqetësuar për shkaqe të ndryshme në martesën e tyre, dëshirojnë në mënyrë të pavetëdijshme, të infektojnë të gjithë me një psikologji shqetësimi. Mendojnë se problemi nuk ekziston vetëm

tek ata ose vetëm tek martesë e tyre, por te çdo martesë dhe te çdo i martuar. Prandaj, japin këshilla, që lënë mbresa negative, veçanërisht tek ata që sapo janë martuar, rrëfejnë tregime dhe shkëmbejnë eksperiencat negative me njëri-tjetrin. Megjithatë, nuk ekziston asnjë rregull që ta përjetojnë të gjithë atë që kanë përjetuar ata në jetën e tyre dhe ato që kanë parë në jetën e të tjerëve. Ndoshta ka më shumë martesë të mira se sa martesë të këqija, megjithëse nuk është bërë asnjë trajtesë për martesat e këqija. Prandaj, nuk duhet t'ua vësh shumë veshin fjalëve të këtyre njerëzve; sado që të jenë pranë, sado që të duken të sinqertë, duhet të mos i lejoni të flasin shumë për këtë çështje.

9. DISTANCA NË SHOQËRI

Është e pashmangshme që njerëz të ndryshëm të marrin pjesë në jetën tonë. Por secili është i dobishëm kur është në vendin e duhur. Në këtë kontekst, njeriu ka bashkëshort, miq, shokë etj. Por bashkëshorti mbetet bashkëshort dhe shoku mbetet shok. Personi nuk



duhet t'ua tregojë shokëve tërë jetën, punën dhe sekretet e veta. Ai këtë gjë duhet ta bëjë me bashkëshortin e vet, përjetimet e bukura duhet t'i ndajë me bashkëshortin dhe jo me shokët. Personi që shkon me shokun e tij për shëtitje, që bashkëbisedon me të, që i njeh dhe i di më mirë shokët e vet se sa bashkëshortin e tij, që nuk ndan asgjë përtej çatisë dhe krevatit me bashkëshortin e vet, domethënë shokun e vet e ka kthyer në partner (*bashkëshort*). Një prej rreziqeve më të rëndësishme për martesën

është edhe shoqëria.

10. MOS LEJO QË I YTI TË BËHET I HUAJ

Megjithëse bashkëshortët nuk kanë njohje të plotë ndaj njëri-tjetrit para martesë, përpjekja e tyre për t'u njohur pas martesë, për të njohur botkuptimin e ndjenjave dhe mendimeve të njëri-tjetrit, ka rëndësi nga aspekti i solidarizimit me themele të shëndosha. Ai që nuk bën asnjë përpjekje për të njohur bashkëshortin e vet, që di më shumë gjëra për një këngëtar ose futbollist se sa për bashkëshortin e vet, rreth një filmi serial që transmetohet në televizor, pas një kohe të shkurtër do të fillojë të largohet nga bashkëshortja dhe pas një farë kohe do të fillojë të jetojë me një të huaj që nuk e ka njohur kurrë. Martesë nuk do të vazhdojë dot pas një kohe të shkurtër, sepse dy të huaj nuk mund të jetojnë gjatë me njëri-tjetrin, duke mos ditur se çfarë duan dhe çfarë presin prej njëri-tjetrit.



Sadik Dana

Shejhu i nderuar Hz. Mahmud Sami Ramazanogllu (k.s.), në lidhje me përforcimin e besimit dhe nënshtrimin ndaj Allahut Teala, shpeshherë përsëriste disa hadithe fisnike dhe pothuajse sugjeronte të mësoheshin përmendsh.

Abdullah ibn Abbasi, radijallahu anhuma, ka thënë:

Një ditë isha pranë të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem. Hazreti Pejgamberi më tha:

“Bir! Po të mësoj disa fjalë. Zbatoji urdhrat dhe ndalesat e Allahut, në mënyrë që ta kesh pranë Atë! Kur të kërkosh diçka, kërkohet nga Allahu! Kur të kërkosh ndihmë, kërkohet nga Allahu! Dije këtë: Nëse të gjitha krijesat bashkohen për të të bërë ndonjë dobi apo për të të dhënë ndonjë të mirë, nuk mund të të japin më shumë se ajo që të ka shkruar Allahu. Po ashtu, nëse të gjitha krijesat bashkohen për të të dëmtuar, nuk mund të të shkaktojnë ndonjë humbje më të madhe se ajo që të ka caktuar Allahu. Punët e lapsit kanë mbaruar dhe fletët janë tharë, pasi shkrimet mbi to janë plotësuar.” (Tirmidhi, Kijame, 2518; Musned, Vëll. 1, fq. 293-303.)

Ky hadith fisnik duhet të jetë si një pasqyrë në zemrën e çdo besimtari dhe çdo punë duhet të bëhet në përputhshmëri me të. Nëse besimtari vepron kështu deri në frymën e fundit të tij, në sajë të mëshirës dhe ndihmës së Allahut Teala, do të jetë i fortë përballë vështirësive në dynja dhe në ahiret.

Në këtë hadith fisnik tregohet qartë se çdo njeri duhet ta dijë që çdo gjë është në dorën e Kadirul-Mutllak, Vahidul-Kahhar dhe se çdo gjë bëhet me lejen hyjnore. Prandaj, të gjithë duhet të sillen dhe të veprojnë sipas kësaj.

Nëse njeriu e percepton se zotëruesi i çdo krijese është Allahu Teala, e kupton se njerëzit, çfarëdo pozite që të kenë, janë një grup të paaftësh, të shkretë dhe se në dorë nuk kanë asgjë tjetër përveç autoritetit të dhënë nga Zoti për të vepëruar. Atëherë, ai nuk mbështetet te të afërmit, madje, as te familja dhe te fëmijët. Nuk i beson pasurisë dhe famës së tij. E di se çdo gjë shfaqet me ndihmën e Allahut të Lartësuar, i shtohet dija, besnikëria, dashuria dhe nënshtrimi ndaj Zotit, nuk pret asgjë prej krijesave, e di se çdo vështirësi merr

fund me durim dhe se në fund të çdo vështirësie ka mirësi e lehtësim.

Shejhu i nderuar nuk i duronte dot njerëzit me fytyrë të varur, me vese të këqija dhe që ankoheshin gjithmonë nga jeta e tyre. Kjo pakënaqësi bëhej e qartë në fytyrën e tij.

Varja e fytyrës buron nga preokupimi i njeriut me gabimet e të tjerëve, duke mos e parë veten, ngaqë nuk beson apo nuk e percepton kaderin. Ata që kanë këtë moral, ankohen gjithmonë dhe për pesë minuta bëjnë gjithë ato thashetheme.

Me njerëz që kanë moral të tillë dhe që janë të shpërqëndruar, nuk duhet të lidhim miqësi dhe menjëherë duhet të largohemi prej tyre, sepse neglizhenca reflektohet nga zemra në zemër.

Hz. Ibrahim Dussuki, thotë:

“Unë dëshiroj t’i shoh të lumtur fëmijët e mi!”

Këtë duhet ta kuptojmë në formën: Të qeshur, miqësorë e të lumtur.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Fisnik:

“Atë ditë, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!” (Shuara, 88-89.)

Zemra është pesë llojesh:

Zemër e vdekur: Kjo është zemra e të pafeve dhe e qafirëve.

Zemër e sëmurë: Kjo është një zemër e mbushur me dashuri ndaj kësaj bote.

Zemër neglizhente: Kjo është një zemër e luhatshme që përpiqet ndërmjet dynjasë dhe ahiretit.

Zemër e zgjuar: Kjo është një zemër e preokupuar me dhikër.

Zemër e gjallë: Kjo është zemra e profetëve, e sahabëve dhe e evlijave.

Allahu, dhu’l-xhelali ve’l-ikram, na e mbrojt të zemrën, e cila është vendi ku shikon Ai, nga çdo dashuri ndaj gjërave të kësaj bote, nga dashuria ndaj dynjasë dhe nga e keqja e vetes dhe e djallit të mallkuar! Na bëftë prej robërve të Tij që e kanë zemrën e pastër, sado që bëjmë gabime apo shfaqim dobësi! Amin!

Hz. Ibrahim Dussuki, thotë:

“Qëndrimi me njerëz të përlyer nga papastërtia e mëkatit, e vret shikimin. Edhe syrin e zemrës, edhe syrin e kokës i lë pa shpirt në errësi. Kështu, të bën njeri që s’e ndan dot të mirën nga e keqja.”

Të mëdhenjtë kanë thënë:

“Ibadeti e shpie njeriun në xhenet. Ndërsa ibadeti i kryer me madhërim dhe frikë-respekt, e shpie njeriun te Allahu Teala.”



Trashëgimia që ka lënë IBRAHIMI alejhis-selam

Dr. Kerim Bulladë

Hazreti Ibrahim (a.s.), është njëri prej profetëve, për të cilin jepen shumë të dhëna në Kuranin Fisnik. Ibrahim (a.s.), lindi në një popull që adhuronte idhujt. Shumë profetë që përmenden në Kuran, e kanë prejardhjen prej tij. (Shih el-En'am, 6/84-86.)

Hz. Ibrahim (a.s.), që në moshë të vogël u largua nga ato që adhuronte babai dhe populli i tij. Ai shfaqti një rezistencë të madhe kundër tyre. Madje, në lidhje me këtë çështje, e qortoi babain e tij:

“A do t'i adhurosh idhujt si zota të tu? Unë vërtet po shoh se ti dhe populli yt jeni në humbje të madhe.”
(En'am, 74)

Ibrahim (a.s.), me mendjen e ndritur që i kishte dhuruar Allahu Teala, i besoi ekzistencës dhe njësimi të Tij. Nënshtrimin ndaj Zotit të botëve e shfaqti me fjalët: ***“Unë nuk jam politeist.”*** (En'am, 79) Ai i doli kundër popullit të tij politeist. (Shih Merjem, 42-49; el-Enbija, 52-67; es-Saffat, 85-99.)

Hz. Ibrahim (a.s.), me urdhrin e Allahut të Madhëruar, e mori fëmijën e parë të tij, Hz. Ismailin (a.s.) dhe nënën e fëmijës së parë, Hz. Haxheren nga Palestina, i çoi në Hixhaz dhe i la afër kodrës Safa.¹

Sipas transmetimit të Buhariut, Hz. Ibrahim, (a.s.), e

1. Bejdavi, Envaru't-Tenzil, Bejrut, III, 533; veçanërisht, për të dhëna më të detajuara mund të shik. Ismail Jigit, Pejgamberler Tarihi, Stamboll, 2005, fq. 236-237, 241.

mori Hz. Haxheren, të birin, Hz. Ismailin (a.s.), i dërgoi në Mekë dhe i la pranë Qabesë, në anën e sipërme të pusit të zemzemit. Atë kohë në Mekë nuk kishte frymë njeriu. Po ashtu, nuk kishte as ujë. U la një trastë me hurma dhe një enë plot me ujë. Më vonë, Hz. Ibrahim (a.s.), mori rrugën për t'u kthyer pas.

Nëna e Hz. Ismailit, (a.s.), Hazreti Haxherja, i shkoi pas Hz. Ibrahimit (a.s.) dhe i tha:

“O Ibrahim! Ku po shkon duke na lënë në këtë luginë, ku nuk ka as njerëz dhe asgjë?” Edhe pse i tha disa herë, Hz. Ibrahim (a.s.), nuk u kthye pas për ta parë. Më së fundi, kur Hz. Haxherja i tha:

“O Ibrahim! Allahu të ka urdhëruar të veprosh kë-shtu?” – Hz. Ibrahim (a.s.), iu përgjigj: “Po.” Hz. Haxherja i tha: “Atëherë, Allahu nuk do të na humbë ne.” Pastaj u kthye te fëmija që pati lënë pas.

Hz. Ibrahim (a.s.), vazhdoi rrugën.² Kur arriti në një kodër që ata nuk e shihnin, u drejtua nga Qabja, i ngriti duart dhe u lut me këto fjalë:

“O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndjejnë dashmirësi për ta dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë.” (Ibrahim, 37)

2. Shih Buhari, Musakat, Enbija, 9, Ahmed b. Hanbel, I, 347.



Siç e shohim edhe në ajetin fisnik, Hz. Ibrahim (a.s.), la disa prej pasardhësve të tij në një vend të shkretë e që nuk mbillet, u kthye nga vendi ku do ndërtohej Qabja dhe u lut. Pikën më themelore të lutjes e mbështeti te namazi. Së pari, ai u shpreh se këtë e bëri që ata të falin namazin, i cili është detyra kryesore e nënshtrimit ndaj Krijuesit. Së dyti, i kërkoi Allahu Teala që njerëzit të ndjejnë dashamirësi ndaj tyre.

Ata që i nënshtrohen Krijuesit të Madhëruar dhe i dorëzohen Atij, Allahu Teala i do dhe i bën t'i duan edhe të tjerët. Në një ajet fisnik thuhet se Allahu i Madhëruar i do ata që sillen mirë dhe i bën edhe të tjerët t'i duan. (Shih Merjem, 96.)

Ngaqë Hz. Ibrahim, (a.s.), e dinte këtë të vërtetë në sajë të pjekurisë mendore që i ishte dhënë, së pari iu lut Allahu të Lartësuar t'i bënte pasardhësit e tij prej atyre që e falin namazin, ndërsa dëshirat e tjera i la për më vonë. Allahu i Madhëruar ia pranoi këtë lutje dhe prej brezit të tij nxori njerëz që e falin namazin. Brezat që erdhën më vonë dhe që falnin namaz, gjithmonë e deshën Hz. Ibrahim, (a.s.), Hz. Ismailin, (a.s.), nënën e tij dhe besimtarët që erdhën prej sojit të tyre.

Kurani Fisnik na tregon edhe një dua tjetër të rëndësishme që ka bërë Hazreti Ibrahim (a.s.):

“O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano

lutjet!” (Ibrahim, 40)

Ne nuk duhet të harrojmë se me begatinë e kësaj lutjeje që ka bërë Hz. Ibrahim (a.s.), e falim namazin dhe e duam atë. Kur ai i hodhi themelet e Qabes bashkë me të birin, Ismailin (a.s.), kërkoi nga Allahu Teala një umet mysliman dhe adhurues. (Shik. el-Bakara, 2/128.) Allahu i Lartësuar ia pranoi këtë dëshirë, të fundmin e Pejgamberëve, Hz. Muhamedin (a.s.), e dërgoi nga soji i tij dhe ne na ka bërë umet të tij.

Ibrahim (a.s.), u lut:

“O Zoti im, më dhuro dituri dhe më radhit me të mirë! Bëj që të përmendem për të mirë te breznitë e ardhshme.” (Shuara, 83-84)

Si rezultat i kësaj, gjithmonë u përmend për mirë nga brezat e ardhshëm. Të gjithë myslimanët, në çdo namaz që falin, e kujtojnë Ibrahim (a.s.) dhe luten për të. Ngaqë është babai i pejgambereve që kanë ardhur pas tij, Hz. Ibrahim ka një vend të veçantë te myslimanët, jahudinjtë dhe të krishterët, të cilët janë pasues të tri feve qiellore. Allahu Teala e bëri atë mik të Tij. Në Kuranin Fisnik tregohet kështu vlera që i është dhënë Hz. Ibrahimit (a.s.), nga ana e Allahut të Madhëruar:

“Kush është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet sinqerisht Allahut, duke qenë bamirës dhe zbatues i fesë së pastër të Ibrahimit, të cilin Allahu e ka marrë për mik të ngushtë?” (Nisa, 125)

Kurani Fisnik flet shumë për trashëgiminë e Ibrahimit, (a.s.) dhe për faktin se ai u bë babai i teuhidit:

“Kujto kur Ibrahim i tha të atit dhe popullit të tij: ‘Në të vërtetë, Unë i urrej dhe s’kam të bëj fare me ato që adhuroni ju në vend të Atij, që më ka krijuar dhe i Cili do të më udhëzojë në rrugën e drejtë. Ai e la këtë fjalë të përhershme te pasardhësit e tij si trashëgimi, me qëllim që ata të kthehen (vazhdimisht te Allahu).” (Zuhruf, 26-28)

“Fjala” që përmendet në ajet dhe që është lënë si trashëgimi, komentohet se është fjala e teuhidit.³

Ibrahim (a.s.), tregoi se baballarët nuk mund të imitohen, duke e braktisur rrugën e babait dhe të popullit të tij dhe fjalën e teuhidit ua la si trashëgimi brezave që do të vinin pas tij. Prandaj, nga prejardhja e tij dolën shumë njerëz që i besonin Allahut Teala. Edhe në shoqërinë e Mekës, që cilësohej si populli i injorancës në kohën kur të Dërguarit të Allahut (a.s.), nuk i kishte ardhur akoma shpallja, kishte njerëz që ishin besnikë ndaj besimit të Hz. Ibrahimit (a.s.).

Zoti i forcoftë të gjithë besimtarët në këtë rrugë!

Amin!

3. Sheukani, Fet’hu’l-Kadir, Bejrut, 1994, IV, 690.



INTERVISTË E MASSIMO JEVOLELLA-S PËR LIBRIN “RRËNJËT ISLAMIKE TË EVROPËS”

Massimo Jevolella, islamist dhe shkrimtar, është një nga studiuesit më të kujdesshëm dhe inteligjentë të çështjeve islamike. Katër vjet pas 11 Shtatorit të parë, në kulmin e vrullit falaçian, ka hedhur në shtyp një ese me titull provokues, do të thuhej në gjuhën e gazetarisë, por që ne preferojmë ta quajmë thjesht të ekuilibruar dhe mjaft të informuar: *Rrënjët islamike të Evropës*. Dhe duam të nisim që këtu njohjen historike dhe fetare të lidhjeve mes Kontinentit të Vjetër dhe fesë së Kuranit.

Profesor Jevolella, ju jeni autor i punimeve të ndryshme mbi Islamin, qoftë në këndvështrimin politik, qoftë fetar. Rrënjët islamike të Evropës na duket një nga më stimulueset, duke filluar vetëm me titullin dhe mjaft e guximshme, duke qenë se ka dalë pikërisht kur librat e Oriana Falaçit shiteshin në miliona kopje në të gjithë botën dhe tezat e saj ishin përqafuar nga pjesa më e madhe e opinionit publik. Pse e shkruat këtë vepër? Çfarë donit të tregonit?

Po, e pranoj, ta shkruaje atë libër në atë moment ka qenë sikur të hipje në një kalë dhe me një shpatë në dorë të hidheshe kundër një divizioni të tërë tan-kesh. Megjithatë, nuk e kam bërë nga çmenduria apo zemërimi, por nga dashuria për drejtësinë. Qëllimi im nuk ishte të godisja me shpatë: tashmë e dija se në një rast të tillë do të shkatërrohesh në më pak se dhjetë minuta. Nuk doja të provokoja lexuesit e Falaçit. Dëshiroja t’u drejtohesha njerëzve që nuk ishin kapluar dhe verbuar akoma nga urrejtja dhe paragjykimet, për t’u kujtuar atyre se cili ka qenë kontributi i jashtë-

zakonshëm që qytetërimi islam i ka dhënë Evropës për më se pesë shekuj: të atij gjysmëmijëvjeçari të një historie mesjetare të tejmbarsur që nis aty nga fundi i shekullit VIII deri në fundin e shekullit XIII. Jam kufizuar të tregoj një sërë faktesh të bazuara në një masë të pafund dokumentash historikë të pakundërshtueshëm, që sot asnjë studiues serioz nuk do të kishte guxim t’i kontestonte. Dhe kanë qenë pikërisht historianët perëndimorë, duke filluar nga shekulli XIX, që i kanë zbuluar dhe vënë në dukje këto fakte. Ka qenë një vepër korale, e përbashkët. Është realizuar, e përsëris, natyrisht, jo nga fanatikët “islamofilë”, por nga studiues të kthjellët të kalibrit të Asin Palacios, Massignon, Gabrieli (baba e bir), Grūnebaun, Gilson, Levi-Provençal, Lewis, Garcia Gomez, Rodinson, Nallino, Levi della Vida, Renan, Nicholson, Pines dhe shumë të tjerë që do të shkonte tepër gjatë t’i numëronim.

Si është pritur nga publiku dhe mjetet e komunikimit libri juaj?

Në atë moment, tregu i botimeve ishte tërësisht i etur për “përplasje qytetërimesh”. Ideja mbisunduese ishte ajo e Islamit armik, të dhunshëm, të rrezikshëm. Dhe ekstremistët islamikë e përforconin këtë ide. Islamofobia kishte marrë dhenë (edhe tani është e përhapur, edhe pse rrota e historisë, veçanërisht pas zgjedhjes së Obamës në Shtetet e Bashkuara, ka nisur të rrotullohet me vështirësi në një drejtim të ndryshëm). Rezultati: libri im u mënjanua menjëherë, duke u identifikuar si vepër partizane e një “islamofili fyes” (për ta thënë me fjalëzat e sjellshme, aq të shtrenjta

Kam shtjelluar në ato faqe një arsyetim të ngjeshur, bazuar të gjithin në mënyrë rigoroze mbi tekstin arab të verseteve kuranore, për të treguar se origjina e termit **selam** (paqe, shëndet) dhe **islam** (lëshim i besuar në duart e Zotit) nga e njëjta rrënjë trishkronjëshe s-l-m duhet kuptuar absolutish si burimi i një ekuivalence efektive konceptesh dhe jo si një asonancë e pastër sipërfaqësore. Me fjalë më të thjeshta: **paqe dhe shëndet janë vetë zemra e Islamit...**

për të ndërën zonjën Falaçi), dhe si i tillë u bë objekt i mendimeve tërësisht të kundërta dhe ekstreme. Tek "Foglio", e Xhuliano Ferrarës, Xhulio Meoti (10.12.2009) më ka bashkuar me **"bandën" e armiqve të Magdi Alamit e të demokracisë**, kjo sa për të përmendur një prej tyre. Ndërsa nga krahu tjetër, personazhe shumë të njohur të njëfarë ultra të djathtë tradicianale dhe antisioniste, si Klaudio Muti, kanë shfaqur një vlerësim të qartë për tekstet e mia! Me pak fjalë: kam rrezikuar të kaloj si një përkrahës ekstravagant i ekstremistëve islamikë dhe si një rival i shumë të urryerit (apo shumë të dashurit, sipas këndvështrimit) të ish- nazistit Sigrid Hunke, që në 1960 me esenë e tij *Dielli i Allahut mbi Perëndimin* kishte ilustruar në formë akoma më të zgjeruar shumë prej koncepteve të shprehura në librin tim. Ndër të paktët që debatuan me mua **në mënyrë të ekuilibruar** mbi çështjen ka qenë profesor **Gregorio Piaia**, i cili në faqet e *Revista e historisë së filozofisë* (n.4, 2005, fq.767- 768), është kufizuar në mënyrë të hijshme vetëm në kritikën e konceptit "rrënjë" islamike të Evropës, duke propozuar zëvendësimin e tij me **"borxhi" historik i Perëndimit ndaj Lindjes islamike**.

Një nga tezat më të njohura historiografike të raportit Evropë- Islam është që nën Perandorinë Otomane popujt e Lindjes kanë pësuar angaritë më të këqija dhe se reformat borgjeze dhe perëndimore të gjysmës së Tetëqindës, për shembull në Rumani, u kanë sjellë një erë lirie atyre popujve. Cili është gjykimi juaj në lidhje me këtë?

Me gjithë sinqeritetin dhe nderimin, do t'ju propozoja t'ia drejtonit këtë pyetje profesor Franko Kardinit (mikut tim të shtrenjtë, që ndër të tjera, ndan plotësisht tezat e "rrënjëve edhe islamike" të Evropës). Shumë kohë më parë, Kardini është marrë me islamizimin ballkanik dhe me përplasjen e otomanëve me Evropën, që kulmon me rrethimin e Vjenës në 1529. Unë nuk jam mësuar të prononcohem mbi argumente që nuk i njoh thellë. E nëse mendoj për milicinë e Mlladiçit dhe gjenocidin e Srebrenicës, sidoqoftë më linden **dyshime** të

forta mbi rolin e viktimave të pafajshme që edhe në të kaluarën do të kenë pasur popujt e krishterë të Lindjes nën Perandorinë Otomane. Veç kësaj, a nuk është e vërtetë se masakruesi dhe ekzekutori më i egër (që i ngulte njerëzit në hu) i të burgosurve në luftërat ballkanike qe princi shumë i krishterë **Vlad Tepes, i quajtur Drakula**? Nuk mendoj aspak që prirja e egërsisë dhe e shtypjes të kenë qenë ndonjëherë një ekskluzivitet i **turqve**. E pastaj, a nuk do të ishte edhe ora të zh dramatozoheshin një çikë këto ngjarje të vjetra, makar me pak buzëqeshje? Për shembull, kush e di që ëmbëlsira më tipike dhe e shijshme e Tirolit, **strudel**, ishte një **shpikje turke**, e përhapur në Ballkan dhe e ardhur deri në Austri? Të ketë qenë edhe kjo një angari e pësuar nga popujt e Lindjes?

Në një libër tjetër tuajin "Mos e përmend kot emrin e Allahut. Kurani libri i paqes" (bot. Boroli) ju e ktheni mbrapsht edhe një herë rrotën e perceptimit publik të Islamit. Do të na flisni për këtë?

Me shumë dëshirë, sepse është pikërisht ai libër i 2004 (pastaj i thelluar idealisht nga *Rawa, tregimi që shuan etjen e shpirtit*, të 2008), që ka përballuar temën e esencës së vërtetë të Islamit. Urgjenca që kisha atëherë ishte ajo e **rrëzimit të tezave të ekstremistëve islamikë**, jo nga "jashtë", por duke u mbështetur mbi vetë fjalët e Kuranit. Bëhej fjalë të kryeja saktësisht të kundërtën e punës së atyre që, në emër të luftës kundër terrorizmit xhihadist, dënonin në bllok Islamin dhe digjnin (nganjëherë jo vetëm simbolikisht) **Kuranin**. Kam shtjelluar në ato faqe një arsyetim të ngjeshur, bazuar të gjithin në mënyrë rigoroze mbi tekstin arab të verseteve kuranore, për të treguar se origjina e termit **selam** (paqe, shëndet) dhe **islam** (lëshim i besuar në duart e Zotit) nga e njëjta rrënjë trishkronjëshe s-l-m duhet kuptuar absolutish si burimi i një ekuivalence efektive konceptesh dhe jo si një asonancë e pastër sipërfaqësore. Me fjalë më të thjeshta: **paqe dhe shëndet janë vetë zemra e Islamit**, saktësisht siç është dashuria për të afërmin esenca e besimit të krishterë. Përdorimi i

dhunshëm i Kuranit lind pra nga idhujtaria fanatike e Ligjit dhe nga një keqkuptim me dashje i konceptit të xhihadit. Duke kundërshtuar paturpësisht besimin në Zot "I mëshirshëm dhe i Dhembshur", përdoret emri i Zotit për të justifikuar tmerrin, urrejtjen njerëzore dhe tragjeditë e të pafajshmëve. **Ajeti 190 në suren e dytë**, duke iu referuar qartë luftës kundër të pabesëve, thotë se myslimanët kanë detyrimin të mbrohen nga agresionet, por këshillon "të mos tejkalohet", sepse "Zoti nuk i do teprimet (*al-mu'tadin*)". Termi *mu'tadin* mund të merret edhe si "agresorët", por koncepti nuk ndryshon: **kush sulmon, sidoqoftë është një tejkalim, një ekstremist, një terrorist.** E thotë vetë kurani.

Çfarë ju ka shtyrë të interesoheni për Islamin?

Në fillim vetëm tërheqja nga një **gramatikë arabe e botuar në Palermo në 1912.** Babai im që në rini, kishte tentuar ta studionte vetëm, por nuk ia kishte dalë. Unë, në vitin 1979 vendosa ta vë në vend. Fillova edhe unë **autodidakt** mbi atë libër të vjetër. Pastaj i besova një udhëheqësi të sigurt. Iu dedikova letërsisë së Kuranit dhe *Historisë së myslimanëve në Sicili* të Michele Amari dhe pasioni u ndez që aty. Jo pa ndikimin vendimtar të letërsisë guenoniane (René Guenon 1886-1951, autor mistik francez, njohës i Islamit, i kulturës orientale dhe i feve të Lindjes), që më hapnin shikimin mbi thesarin e pafund letrar dhe shpirtëror të mistikës islamike, **sufizmit.**

Ka shumë studiues, të panjohur për publikun e gjerë, që i kanë dalë në mbrojtje çështjes euroaziatike, duke përshkruar gjeopolitikën në termat e lidhjes mes Evropës dhe Azisë apo duke profetizuar një aleancë, nën profile të ndryshme mes Krishterimit perëndimor dhe Islamit. Këta studiues, mjaft larg propozimit të një teze ideologjike, janë mbështetur në të dhëna historike të përjashtuara nga versionet zyrtare, që tregojnë se sa këto dy fe janë në realitet motra. Ç'mendim keni në lidhje me këtë?

Bëhet fjalë për një argument shumë të gjerë dhe mjaft kompleks dhe është e vështirë të trajtohet me pak fjalë qoftë edhe në vija të trasha. Profeti Muhamed pati qartësinë t'i bashkohej linjës profetike që nga Ibrahim i Musai, deri te Jezui. Dhe në fakt, një numër shumë i madh **elementesh të pranishëm në Kuran** dhe në traditën më të vjetër islamike shfaqin qartë **origjinën e tyre judaike dhe kristiane.** Në përgjithësi, mund të thuhet qartë se Islami ka globalizuar shumë aspekte të traditave të mëparshme monoteiste, ndërsa në të kundërt, qoftë Judaizmi, qoftë Krishterimi e kanë hedhur poshtë përherë Islamin, si një devijim, si një herezi, si një trup të huaj. E unë nuk mendoj që kjo situatë historike të mund të transformohet me ca

përpjekje vullneti të mirë. **Dogmat e besimit**, për vetë natyrën e tyre, nuk janë të modifikueshme. Nëse një i krishterë duhet të besojë se Kurani është "Fjala e Zotit", nuk do të ishte më i krishterë. Nëse një mysliman duhet të besojë që Jezui është personi i tretë i trinisë hyjnore, nuk do të ishte më mysliman. Nëse një hebre duhet të besojë që Jezui i Naxaretit qe Mesia i shpallur në Shkrime, nuk do të ishte më hebre. E pra, tashmë është një fitim i madh dhe ngushëllim të shohësh përfaqësuesit **e besimeve abrahamike** të përqaftuar në një mendim të respektit reciprok dhe bashkëpunim në përballimin e problemeve më dramatike të kohës sonë: urinë, luftërat, padrejtësitë shoqërore në emër të një Zoti të vetëm të besimtarëve.

Sipas mendimit tuaj, pse prirja botërore është kundërshtimi i Islamit? Është e mjaftueshme të paraqitet shkaku i terrorizmit që të përgatitet një luftë e tillë, jo vetëm me fjalë, por edhe me armë?

Mendoj se revolucionet e mëparshme dhe ato që po ndodhin në botën arabe po e ndryshojnë pak perceptimin negativ të Islamit në përgjithësi. Po vihet re se edhe në botën islamike mund të zhvillohet një aspiratë e sinqertë për demokraci. Ekuivalenca "Islam baraz me obskuranizëm dhe shtypje" po fillon të thërrmohet. Globalizimi dhe interneti po thyjnë të gjitha barrierat. Natyrisht, Islami është një realitet shumë i gjerë dhe i larmishëm. Kur mendojmë talebanët, na rrëqethet trupi. Por, nëse mendojmë për frymën moderne të Erdoganit, mundësinë e hyrjes së Turqisë në Evropë dhe të miliona myslimanëve të brezave të rinj që jetojnë në Evropë, në Shtete të Bashkuara dhe në vende të tjera demokratike dhe që tashmë konsiderohen perëndimorë në të gjitha drejtimet, vërejmë që procesi i "**shkrirjes së qytetërimeve**" tashmë është shumë më i avancuar se ç'mund të imagjinohet. Pyesim një të ri mysliman të lindur në Itali se ç'mendon për lirinë e qytetërimeve dhe do të krijojmë një ide të qartë të asaj që po ndodh. E ardhmja tashmë ka filluar dhe të paktën në këtë aspekt mund të shpresohet.

Për shekuj në Evropën Lindore, për shembull mendojmë Shqipërinë apo ish Jugosllavinë, të krishterët katolikë, ortodoksë dhe myslimanët kanë bashkë-



Jetuar përherë në mënyrë paqësore, përveç ndonjë teprie fiziologjike. Pas 1989, përkundrazi, gjithçka është hedhur në erë. Si shpjegohet kjo përmbysje e prirjes?

Barbaria është bija e frikës. Ka pasur një dallgë paniku kolektiv. Çimentoja siguroese e komunizmit është shkrire befaz, pa lënë kohë që popujt të përfytyronin një realitet tjetër. Dhe në boshllëk i është hapur rrugë frikës. Problemet e pazgjidhura dhe mllefet pak a shumë atavike, kanë shpërthyer, si gryka e një krateri vullkani të flakur tutje nga presioni i magmës.

Mendoni se pas asaj që, me një shprehje të mjeshtrësme të huazuar nga Huntington, të quajtur "përplasje qytetërimesh" ka vetëm verbëri politike apo një projekt mjaft të saktë shpërbërjeje?

Besoj se kjo **ideologji e kobshme** është një nga produktet më të këqija kulturore të rënies historike të fuqisë amerikano-veriore dhe të supremacisë së Perëndimit në përgjithësi. Por nuk jam aq në brendësi të mistereve gjeopolitike për ta interpretuar si *Mein Kampf*-in e një strategjie të saktë politiko-militare planetare. Por edhe po të jetë, do të ishte një shenjë e mëtejshme dobësie dhe disfatë dhe natyrisht, jo rrezikimi. Jezui ka thënë: "Si mundet shejtani ta përzërrë shejtanin?" (Marku 3,23). Dhe si mundet benzina e Huntington-it të shuajë flakët e terrorizmit të al Qaeda-s?

Cilat janë, sipas mendimit tuaj, pikat e bashkimit mes Islamit dhe Krishterimit dhe cilat janë ato të ndarjes?

Paqja, drejtësia, solidariteti, dashuria për të afërmin dhe nënshtrimi ndaj vullnetit hyjnor: këto janë pikat e bashkimit që duhet me çdo kusht t'i vlerësojmë. Ndarjet lindin, siç e kam thënë tashmë, nga urrejtja teologjike dhe nga mllefet historike që duhet me çdo kusht t'i çrënjësim.

Prej shumë kohësh flitet vazhdimisht për dialog ekumenik dhe ndërfeetar. Ç'mendoni për këtë? Mendoni se nga njëra anë është një mënyrë për të eliminuar dallimet dhe nga ana tjetër, për paradoks, për t'i nxjerrë në pah?

E përsëris: dallimet themelore do të ekzistojnë, sidomos edhe kur urrejtja dhe mllefet të heshtin përgjithmonë. Prandaj dialogu mund dhe duhet të ketë si qëllim të vetëm përrurimin e një epoke **të mirëkuptimit dhe të vlerësimit reciprok**. E pastaj, nëse Zoti është kudo, pse një i krishterë të mos mund të lutet në një xhami apo sinagogë dhe një mysliman në një kishë? Armiku është formalizmi, idhujtaria e Ligjit, ngjitja e verbër pas një identiteti të jashtëm. Zoti lexon në zemrat tona dhe aty, në brendësi, Ai dallon besimtarin e vërtetë nga besimtari i rremë.

Kujt i vlen ky tip dialogu?

Të gjithëve, sepse paqja është më e madhja nga të mirat e përbashkëta.

Çfarë mendoni për proklamimin qytetërim "superior" perëndimor ndaj atij islamik?

Është një **barcaletë**. Një argument joserioz, i denjë për ata që kuvendojnë nëpër kafene. Ekziston vetëm një qytetërim: ai njerëzor dhe botëror, që po formohet prej mijëra vjetësh me pjesëmarrjen e të gjitha kulturave të të gjithë popujve të botës. Dhe mjafton të studiojmë pak antropologji, për ta vënë re një gjë të tillë. Në formë serioze por edhe me humor, unë jam marrë më parë me këtë temë, duke shkruar një libër të vogël mbi historinë e dhimbjes së dhëmbëve (dhe Emilio Xhaneli, i zoti, më ka ndihmuar duke më vënë aty nga dhjetë nga vizatimet e tij të këndshme). Mjafton ta ngulim vështrimin mbi një argument universal si ky, për të kuptuar se si që nga muzgu i kohëve transmetimi i miteve dhe njohjeve, teknikave, supersticionet e zakonet kanë ndodhur në një shtjellë qerthullore shkëmbimesh mes gjithë popujve të planetit.

Ju ftoj të komentoni një shprehje mjaft të njohur: të eksportosh demokracinë.

Ta lëmë ta bëjnë interneti dhe tv-të satelitore. Janë shumë më të efektshme dhe shumë më pak katastrofike. Nuk është në sajë të ndonjë bombe inteligjente, nëse gratë saudite sfidojnë pushtetin duke ngarë automobilat.

Turqia në Evropë: një rrezik, një pasuri apo çfarë?

Një **progres absolut**, një bekim. Gadishulli Anatolik bën pjesën integruese të historisë sonë. A nuk qe Enea një trojan? Roma e lashtë ishte më universaliste se ne. Po Shën Pali, a nuk kishte lindur në Tarso? Ja edhe aty, rrënjët tona të thella.

Përgatiti: Zija Vukaj

MORALI APO PAMJA

është thelbësore për lumturinë?

All Riza Temel

Njeriu vjen në këtë botë me tipare fizike të përcaktuara, sepse është Allahu që i jep njeriut formën që dëshiron. Një nga emrat e bukur të Tij është Formëdhënësi. Ngjyrat dhe format e ndryshme janë shenja të fuqisë së Allahut.

Përderisa këto veçori janë të paracaktuara, njeriu nuk mund t'i ndryshojë. Duke qenë veçori jo të fituara, ato nuk mund të shërbejnë si mjet për të siguruar epërsi mbi të tjerët, sepse epërsia fitohet përmes veçorive të fituara me përpjekje dhe punë. Siç urdhëron edhe Allahu në Kuran: **“Çdo njeri është peng i veprave të veta.”** (Tur, 21.) Kurse Pejgamberi (a.s.), thotë: *“Allahu nuk ju vlerëson sipas pamjes dhe pasurisë, por sipas zemrës dhe veprave.”* (Ibn Maxhe, 4143.) Pra, thelbësore është zemra e pastër, besimi i patundur dhe veprat e mira.

Sigurisht që bukuria dhe pamja tërheqëse janë të dëshiruara nga njerëzit, por bukuria nuk mund të jetë kriter bazë, për më tepër kur ajo është relative, ndryshon nga individi në individ. Ajo që për dikë është e bukur, për një tjetër është e shëmtuar.

Pamja fizike është kalimtare. Bukuria e rinisë nuk mund të ruhet në pleqëri. Mund të fitosh një lloj bukurie ose mund ta zgjasësh bukurinë përmes makijazhit dhe operacioneve plastike, por kjo nuk është as e vazhdueshme dhe as zëvendësuese e bukurisë natyrale. Atëherë duhet të interesohemi më shumë për bukurinë e vazhdueshme. Pejgamberi (a.s.), na ka porositur që ndër katër cilësitë për të cilat preferohet martesë me një grua, të zgjedhim besimin dhe moralin e bukur. Sa fytyra të bukura ka, që zemrën e kanë katran dhe anasjelltas. Bilali (r.a.), ishte i zi si nata, por shpirti i tij rrezatonte dritë si diell, kurse fytyra e Ebu Lehebit ishte e bukur, por shpirtin e kishte katran të zi. Trupi, sa do të zbukurohet, një ditë në dhé do të përfundojë. Kurse shpirti do të udhëtojë në përjetësi.

Megjithëse thelbësore është bukuria shpirtërore dhe morale, njerëzit janë të dhënë më shumë pas bukurisë fizike, duke e neglizhuar krejtësisht bukurinë shpirtërore. Në lidhje me vlerësimin sipas bukurisë së jashtme dhe shpirtërore, dua të jap një shembull të spikatur:

Sa'd es-Sulejmi (r.a.), ishte një skllav me ngjyrë, por një mysliman i mirë. Një ditë erdhi në xhami, fali namazin dhe u afrua pranë Pejgamberit (a.s.). Njerëzit pyesnin Pejgamberin (a.s.), për çështje të ndryshme të kësaj bote dhe botës tjetër. Sa'di u çua dhe i tha Pejgamberit (a.s.): “O i Dërguari i Allahut! A është pengesë ngjyra e zezë



dhe mungesa ime e paraqitjes për të hyrë në Xhenet?" Pejgamberi (a.s.), tha: "Betohem para Allahut se, nëse respekton Allahun dhe beson në mesazhin që ka sjellë i Dërguari i Tij, do të hysh në Xhenet."

Mbi këtë, Sa'di deklaroi se nuk besonte zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Allahut dhe dha fjalën që do të luftonte në rrugën e Allahut, pastaj shtoi: "Çfarë përfitimi kam unë nga gjithë kjo?" Pejgamberi (a.s.), iu përgjigj: "Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e besimtarëve janë të vlefshme edhe për ty, sepse tashmë ti je vëllai i tyre." Atëherë Sa'di tha: "Unë kam kërkuar vajzë për t'u martuar dhe për shkak të mungesës së paraqitjes dhe ngjyrës jam refuzuar në të gjitha rastet, megjithëse unë jam një njeri me soj të mirë në fisin tim."

Përballë shqetësimit të Sa'dit, Pejgamberi tha: "Shko te shtëpia e Amr ibn Vehbit dhe thuaj që Pejgamberi (a.s.), e kërkon vajzën tuaj për mua. Sipas porosisë së Pejgamberit (a.s.), Sa'di shkoi te shtëpia e Amr ibn Vehbit, i ra derës, i përshëndeti dhe tha: "Unë vij nga Pejgamberi (a.s.), me porosinë që vajzën tuaj të ma jepni mua." Amr ibn Vehbe e priti shumë ftohtë propozimin. Kur Sa'di po bëhej gati të refuzonte, vajza që e kishte dëgjuar bisedën, i tha babait: "Nxito tek Pejgamberi (a.s.) dhe pranoje propozimin para se të zbresë ndonjë ajet, i cili do të të turpëronte midis gjithë arabëve, sepse Allahu në Kuran thotë: **"Nuk i takon asnjë besimtar apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyre. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur."** (Ahzab, 36.) Mbas kësaj, Amri e kuptoi gabimin dhe me nxitim u nis për tek Pejgamberi (a.s.), për të kërkuar ndjesë dhe zbatuar porosinë e Pejgamberit (a.s.). Por Sa'di kishte arritur tek Pejgamberi (a.s.), para se të mbërrinte Amri dhe e kishte informuar për gjithçka. Kur e pyeti Pejgamberi (a.s.), se përse nuk ia dha vajzën Sa'dit, tha: "O i Dërguari i Allahut! Mendova se Sa'di nuk thoshte të drejtën, prandaj erdha këtu për të mësuar të vërtetën, tani që e mësova po e shpall këtu para të gjithëve që vajzën ia kam dhënë Sa'dit. Pejgamberi (a.s.), pasi përgëzoi Amrin për gjestin fisnik, urdhëroi martesën e Sa'dit me vajzën. Sa'di gjithë gëzim shkoi në treg për të blerë diçka për vete dhe nusen e re.

Në treg u dëgjua një zë: "O kalorësit e Allahut, shaloni kuajt dhe fitoni Xhenetin." Kjo ishte një thirrje për xhihad. Sa'di hoqi dorë nga gjërat që kishte vendosur të blinte dhe me vrap shkoi te tregu i kuajve dhe armëve. Bleu një kalë dhe një shpatë dhe menjëherë mori pjesë në luftë. Luftoi derisa ra dëshmor. Pejgamberi i shkoi pranë, e përqafoi dhe i përkëdheli kokën. Kalin dhe shpatën ia ktheu bashkëshortes së tij dhe i urdhëroi t'u thoshin të afërmve të bashkëshortes se Allahu e martoi Sa'din me një grua më të mirë se vajza juaj,

pastaj lexoi ajetin: **"Punëdrejtët, me të vërtetë, do të jenë në vend të sigurt, midis kopshteve dhe burimeve, të veshur në petka mëndafshi të hollë dhe armaç, të ulur përballë njëri-tjetrit. Po, kështu do të jetë, dhe Ne do t'i martojmë ata me hyri sybukura."** (Duhan, 51-54.)

Kjo ngjarje e spikatur, na tregon që e rëndësishme nuk është pamja e jashtme, por zemra e pastër dhe e sinqertë. Zemra e pastër dhe e sinqertë është e fituar tek Allahu në Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!" (Shuara, 88-89.)

Vlera e vërtetë e njeriut çmohet përmes vlerave shpirtërore. Çdo gjë është e bukur, kur njeriu është i mirë, gjërat e bukura shëmtohen kur njeriu është i keq.

Një tjetër ngjarje shumë domethënëse, e cila shpalos vlerën e vërtetë të njeriut është edhe kjo:

Një ditë, pranë Pejgamberit (a.s.), kaloi një burrë. Pejgamberi (a.s.), pyeti personin që kishte pranë: "Si e njuh këtë burrë?" Ai tha: "Është familje fisnike, nëse kërkon vajzë nuk i refuzohet, nëse hyn ndërmjetës, i dëgjohet fjala."

Pak më vonë, kaloi një burrë tjetër:

Pejgamberi (a.s.), përsëri e pyeti personin pranë: "Po për këtë, çfarë mendimi ke?"

Kësaj radhe tha: "Ky është një mysliman i varfër, nëse kërkon një vajzë refuzohet, nëse ndërhyr si ndërmjetës, nuk i dëgjohet fjala, nëse flet nuk e dëgjon kush."

Pas kësaj, Pejgamberi (a.s.), tha: "Ky i fundit është më i mirë se ai i pasuri aristokrat." (Buhari, Nikah, 15.)

Ngjarjet e lartpërmendura nuk tregojnë që i varfëri është më i mirë se i pasuri apo i dobëti është më i mirë se i forti, por që njeriu nuk duhet të diskriminohet për shkak të varfërisë dhe dobësisë. Sepse njeriu nuk vlerësohet sipas prejardhjes dhe pasurisë, por sipas devotshmërisë dhe moralit.

Në vlerësimin e njerëzve shpesh gabohet, sepse pasuria, pozita, fama dhe pamja të mashtrojnë. Për të vlerësuar saktë dhe drejt duhen përdorur kritere hyjnore.

Pejgamberi (a.s.), thotë: "Në Ditën e Gjykimit do të dalë një person, që në botë ka qenë i njohur për madhësinë, por tek Allahu nuk do të ketë vlerë as sa krahët e një mize." (Rriyadus Salihin, 257.)

Në lidhje me ata që në pamje duken madhështorë dhe mahnitës, por në thelb janë bosh, Allahu thotë: **"Kur i shihni ata, pamja e tyre e bukur ju mahnit e, nëse flasni, ju i dëgjoni fjalët e tyre. E megjithatë, ata janë si trungje të mbështetura."** (Munafikun, 4.)

Thelbësore është të jesh njeri me moral të bukur dhe jo njeri me pamje të bukur. Njëra është origjinale, kurse tjetra imitim. Allahu na bëftë prej njerëzve të vërtetë. Amin...

Bilanci i jetës

Xhafer Durmush

Sapo e lamë pas edhe një vit të jetës sonë. Koha, e cila rrjedh si ujë, çdo ditë e më shumë na afron drejt vdekjes. Koha e udhëtimit tonë drejt botës tjetër po afrohet. Jeta jonë e përkohshme në këtë botë çdo ditë shkurtohet. Edhe pak ka mbetur nga koha kur do të ndjejmë mallëngjim për të kaluarën. Të gjitha këto të vërteta duhet të na shtyjnë të bëjmë bilancin e jetës sonë.

Intervali kohor nga lindja deri në vdekje në arabisht shprehet me fjalën "Umur". Kjo fjalë në Kuran me gjithë derivatet e saj, përmendet 14 herë.

"Atje, ata do të thërrasin: 'O Zoti ynë, nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë.' (A tyre do t'u thuhet): 'Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)? Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi! Andaj, shijoni (dënimin)! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!'" (Fatir, 37.)

"...Jeta e askujt nuk zgjatet e as nuk shkurtohet pa qenë e shënuar në Libër. (Fatir, 11.)

"...Secili nga ata dëshiron të jetojë një mijë vjet; por edhe nëse jeton aq, nuk do të mund t'i ikë dënimin! Allahu i sheh punët e tyre të këqija. (Bekare, 96.)

"Kujtdo, që i japim jetë të gjatë, Ne e bëjmë sërish

krijesë të dobët. Vallë, a nuk kuptojnë ata?" (Jasin, 68.)

"Faraoni tha: 'Vallë, a nuk të kemi rritur në gjirin tonë si fëmijë? A nuk ke qëndruar midis nesh shumë vjet të jetës sate?" (Shu'ara, 18.)

Siç vihet re, në ajetet e lartpërmendura theksohet përcaktimi i jetëgjatësisë, vlerësimi i jetës dhe dërgimi i profetëve për të ndërgjegjësuar njerëzit për përgjegjësinë ndaj Allahut të Lartmadhëruar. Gjithashtu theksohet përkohshmëria e kësaj jete, ruajtja e jetës së çdokujt dhe fitimi i Ahiretit përmes kësaj jete të përkohshme, pa harruar faktin se gjithçka është në dorë të Allahut. Ai është krijuesi, udhëzuesi, furnizuesi, Ai jep jetë, merr jetë dhe ringjall, Ai është Gjyqtari Suprem në Ditën e Gjykimit, Ai është Mëshirëploti në Ditën e Gjyqit.

Përveç Allahut, gjithçka tjetër është e përkohshme. Në Lidhje me këtë fakt, Kurani thotë: **"Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket, e do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim."** (Rahman, 26-27.)

Siç e përcakton ajeti Kuranor: **"Para teje, Ne nuk e kemi bërë asnjë të pavdekshëm. Nëse ti vdes, a do të mbesin ata të përjetshëm?"** (Enbija, 34.) Jeta e çdo

në fillim të vitit

njeriu në këtë botë është e kufizuar. **“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen dhe pastaj të gjithë do të ktheheni tek Ne.”** (Ankebut, 57.)

Qëllimi i zbritjes së njeriut në tokë dhe i përcaktimit të jetës së tij është prova. Ajeti kuranor: **“Çdo njeri do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë dhe te Ne do të ktheheni.”** (Enbija, 35.) thekson fort pikërisht këtë fakt. Allahu ka krijuar jetën dhe vdekjen, për të provuar se cili nga ne është vepërmirë. Edhe natyra tërheqëse dhe joshëse e jetës në tokë është për të sprovuar njeriun.

Në Ahiret njeriu do të vlerësohet përmes një procesi gjyqësor serioz dhe të drejtë. Ky fakt duhet të shërbejë si shtysë e fortë për të vlerësuar siç duhet jetën, për të pasur kujdes ndaj urdhëresave dhe ndalesave hyjnore dhe për të jetuar sipas mësimeve islame. Ditët, javët, muajt dhe vitet duhet t'i kalojmë në përputhje të plotë me qëllimin e krijimit. Nga ky këndvështrim, ne nuk duhet të preokupohemi me kalimin e një viti, por duhet të përgatitemi për udhëtimin e fundit. Në këto ditë të para të vitit të ri duhet të ndjejmë më tepër nevojën për vetëllogari dhe vetëgjykim, sepse çdo ditë që kalon na afron më shumë me Ditën e Gjyqit të madh. Sipas ajetit Kuranor: **“Çdo popull ka afatin e vet. Kur t'i vijë koha e fundit, ata nuk mund ta shtyjnë, qoftë edhe për**

një çast dhe as nuk mund ta shpejtojnë.” (Araf, 37.) jo vetëm individi por çdo shoqëri, çdo shtet, çdo gjallesë ka një jetëgjatësi të përcaktuar.

Çdo shoqëri, çdo komb dhe çdo shtet ka një jetëgjatësi të përcaktuar nga Krijuesi i gjithësisë. Afati i përcaktuar nga Allahu, as nuk mund të shkurtohet, as nuk mund të zgjatet. Shtetet dhe kombet pors i individët lindin, zhvillohen, plaken dhe në fund vdesin. Jetëgjatësia e një shoqërie është e lidhur ngushtë me strukturën e shëndoshë materiale dhe shpirtërore të saj. Kjo nuk është në kundërshtim me përcaktimin e Allahut, sepse Ai e përcakton jetëgjatësinë e një shoqërie sipas gjendjes së shoqërisë.

Ata që e programojnë jetën sipas parimeve hyjnor, shfrytëzojnë mirësitë e Allahut si duhet dhe që vazhdimisht veprimet e tyre i peshojnë sipas standardeve të peshores hyjnore, do të jenë të lumtur në këtë botë dhe botën tjetër. Ata që e programojnë jetën sipas dëshirave të egos dhe programit të shejtanit, nuk do të gjejnë qetësi në këtë botë, kurse në botën tjetër i pret një dënim i tmerrshëm. Prandaj për besimtarin, çdo vit i ri nënkupton një interval kohor shumë të rëndësishëm të jetës së tij. Koha për besimtarin është kapitali më i rëndësishëm për të fituar dashurinë dhe mëshirën e Allahut.

EDUKIMI I TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.), BAZUAR TE MËSHIRA

Semih Jollaçan

Allahu i Lartësuar, e krijoi njeriun nga asgjëja me mëshirën e Tij të pafundme, dhe përsëri me mëshirën e Tij të pafundme nuk e lë këtë krijesë të dobët pa ndonjë qëllim. Njerëzve u ka treguar sirat'u'l-mustekimin, që është e vetmja rrugë e cila mund t'i shpjerë ata te lumturia në këtë botë dhe në botën tjetër. U ka dërguar edhe profetë, të cilët do t'i udhëzojnë, do të jenë shembull dhe do t'u prijnë për kah e vërteta.

Megjithatë, menjëherë sapo njeriu doli në skenën e ekzistencës, i harroi urdhrat e Krijuesit të Lartë, iu drejtua devijimeve në vend të rrugës së drejtë që iu tregua dhe preferoi errësirën kundrejt dritës e injorancën kundrejt dijes. Sa më shumë që njeriu devijonte nga natyrshmëria e tij, Krijuesi i Madhëruar e largoi atë nga shtigjet e errëta e të turbullta të injorancës, duke i dërguar profetë në mënyrë të vazhdueshme. Hallka e fundit e këtij zinxhiri është i Dërguari i Allahut, alejhi's-salatu ve's-selam, i cili kishte arritur kulmin në mëshirë dhe kishte

fituar lavdërimin hyjnor: **“Ne të kemi dërguar (ty o Muhamed) si mëshirë për botët.”** (el-Enbija, 21/107.)

Zemrat që përfituan nga mësimet plot mëshirë të Pejgamberit (a.s.), edhe pse dikur jetonin në dallgën e injorancës, u shndërruan në Ebu Bekr, simbolin e të vërtetës, në Umer, i cili u bë emri tjetër i drejtësisë, në Osman, kulminacionin e edukatës dhe në Ali, në derën e dijes.

Edukimi i të Dërguarit të Allahut (a.s.), ishte i formuar plotësisht mbi mëshirën dhe faljen. Kurrë nuk kishte zemërim dhe intolerancë. Në Kuranin Fisnik thuhet në lidhje me këtë çështje:

“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ta dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.” (Ali Imran, 3/159.)

Një bedevi urinoi në Xhaminë e Profetit. Sahabët filluan ta qortonin. I Dërguari i Allahut (a.s.), u tha:

“Lëreni të qetë atë! Hidhni një kovë ujë aty ku urinoi! Ju jeni dërguar për të shfaqur lehtësi, jo vështirësi.” (Buhari, Vudu 58; Edeb, 80.) Ky burrë bedevi, që me kalimin e kohës arriti shkallën e moralit të lartë të sahabëve, më vonë tha kështu për këtë ngjarje që i pati ndodhur:

“Babai dhe nëna ime i qofshin falë! I Dërguari i Allahut, alejhi’s-salatu ve’s-selam, as nuk më qortoi dhe as nuk më tha ndonjë fjalë të keqe. Vetëm më dha këtë këshillë:

“Në xhami nuk urinohet. Këto janë vende të ndërtuara për të përmendur Allahun dhe për të falë namazin.” (Ibn Maxhe, Taharet, 78.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili ishte Rrauf (shumë i butë) dhe Rrahim (shumë i mëshirshëm) kundrejt besimtarëve (et-Teube, 128.), në sajë të kësaj mëshire të pafundme që kishte, nuk ua thoshte njerëzve gabimet e tyre në fytyrë, sepse një diçka e tillë më shumë e lëndon njeriun se sa e edukon.

Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), kur rregullonte ndonjë gabim, në vend që ta fajësonte atë që e kishte bërë, shprehej në mënyrë të nënkuptuar duke thënë se kjo sjellje ishte e gabuar.

Hz. Aishja (r.a.), thotë:

“Kur i dërguari i Allahut (a.s.), dëgjonte se dikush ka thënë për Të ndonjë gjë të gabuar apo të padrejtë, nuk thoshte: “Çfarë i ka ndodhur filanit që thotë të tilla gjëra?” por thoshte: “Çfarë po u ndodh disa njerëzve që thonë të tilla gjëra?” (Ebu Davud, Edeb, 6.)

Oqeani i faljes dhe mëshirës, i Dërguari i Allahut (a.s.), kurrë nuk dëshironte që dikush prej besimtarëve të

ngelte në gjendje të vështirë dhe të binte në situatë të turpshme në shoqëri.

Një ditë, kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), po priste kohën e namazit në xhami bashkë me disa sahabë, që patën ngrënë mish deveje, befaz rreth e rrotull u përhap një erë shqetësuese. Të gjithë ishin kureshtarë për sahabin që e bëri këtë. Sahabi u gjend në një pozitë shumë të vështirë. Rruga e vetme për të gjetur atë, ishte pritja e kohës së namazit, sepse, kushdo që ngrihej për të marrë abdest, me shumë mundësi, do të ishte ai që e kishte shkaktuar këtë erë shqetësuese. I Dërguari i Allahut (a.s.), e zgjidhi kështu këtë problem:

“Le të marrë abdest kushdo që ka ngrënë mish deveje!” Ata që gjendeshin aty thanë: *“Të gjithë kemi ngrënë.”* Atëherë, Hz. Pejgamberi (a.s.), tha:

“Atëherë, merrni abdest të gjithë!” Në këtë mënyrë, u parandalua lëndimi i atij që kishte nxjerrë këtë erë ndërmjet shokëve të tij. (Haflimi, err-Rrasulu'l-Arabi ve'l-Murabbi, botimi i parë, 1981, fq. 160.)

Nganjëherë njeriu bie në gabim, ngaqë nuk di ndonjë alternativë tjetër më të mirë. Një dorë mëshire që mund t'i zgjatet këtij njeriu, i cili shfaq një sjellje të gabuar, do ta nxjerrë atë nga humnera e gabimit duke i treguar rrugë më të mira.

Rafi bin Amri (r.a.), tregon një kujtim të fëmijërisë:

Kur isha fëmijë, gjuaja me gurë hurmat e ensarëve. Për këtë arsye, më kapën dhe më çuan tek i Dërguari i Allahut (a.s.).

I Dërguari i Allahut (a.s.), më pyeti:

“Biri im! Përse gjuan me gurë hurmat?”

Unë i thashë:

“O i Dërguari i Allahut! I gjuaj me gurë për t'i ngrënë.”

Hazreti Pejgamberi, alejhi’s-salatu ve’s-selam, më ledhatoi kokën dhe më tha:

“Mos i gjuaj më, por ha nga ato që kanë rënë poshtë!” Pastaj u lut: *“O Zot! Ngope atë!”* (Ibn Maxhe, Tixharat, 67.)

Së fundmi, në sajë të edukimit të të Dërguarit të Allahut (a.s.), të bazuar në mëshirën e Tij të pashoqe, nga një shoqëri gjysmë e egër, e shturur dhe injorante, doli një shoqëri e mrekullueshme, që do ta ndriçojë dhe udhëzojë njerëzimin deri në kiamet. Kjo shoqëri që formoi i Dërguari i Allahut (a.s.), i gjallëronte zemrat e vyshkura me fladët e pranverës së Islamit duke e çuar në çdo vend që shkonte frymëzimin dhe begatinë që morën nga Ai. Njerëzisë i mësuat edhe një herë vlerat e vërteta njerëzore.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin për të Dërguarin e Allahut, për familjen dhe për gjithë shokët e Tij!

Fetaria e vetëdijshme

Nuredin Jëlldëz

Fetaria mbështetet në bindje. Kushti bazë i besimit është vërtetimi me zemër. Ata që e shprehin besimin vetëm me gjuhë, ndërkohë që nuk besojnë me zemër, janë hipokritë.

Hipokrizia është krimi më i madh. Ata që thonë se nuk besojnë për shkak të presionit, edhe pse besojnë, janë të arsyetuar te Allahu Teala. E gjithë çështja është që besimi të hedhë rrënjë në zemër, të përvetësohet dhe të bëhet burim gëzimi dhe qetësie. Nefsi që ka arritur qetësinë në besim, quhet “mutmainneh-i qetë” dhe “radijeh-i kënaqur”. Nefsit që e ka arritur këtë pjekuri, Allahu Teala i thotë:

“O ti nefsi i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty!” (Fexhr, 27-28.)

Fetaria e pashijuar është një barrë e rëndë. Njerëz të tillë janë si aktorët, që luajnë role të detyruara. Një punë e bërë me detyrim kryhet për shkak të interesit ose të frikës. Kur mbaron interesi apo ikën frika, merr fund edhe puna. Në jetën fetare, vazhdimësia është bazë. Robi nuk është një shërbëtor, që Allahu i Madhëruar i jep punë me pagesë. Ai që mendon pagesën, nuk mendon për pronarin e punës. Në Ungjillin e Barnabasë, Isai (a.s.), thotë:

“Ju doni t’ju tregoj se çfarë do na japë Zoti ne dhe ju në parajsë. Shikoni, po ju them, sepse ata që mendojnë pagesën, nuk e duan pronarin. Kur një çoban shikon një ujk duke ardhur te kopeja, përgatitet për ta mbrojtur atë. Ndërsa punëtori me pagesë, largohet dhe e lë kopenë sapo të shohë ujkun. Zoti, në audiencën e të Cilit qëndroni, është i Gjallë. Sikur Zoti i baballarëve tuaj të ishte Zoti juaj, nuk do ta çonit në mendje se çfarë do t’u jepte Zoti. Përkundrazi, do të thoshit:

“Çfarë do t’i japim Zotit si kundërvlerë ndaj gjithë kë-

tyre mirësive që na ka dhënë?” (Barnaba, verseti 68.)

Hz. Isai (a.s.), u tha apostujve të tij:

“Allahu është ai që jua ka dhuruar çdo gjë që keni. Atëherë, kush është më i vlefshëm, dhurata apo ai që jep dhuratën? Nëse prindërit dhe gjëra të tjera të pengojnë për të shërbyer për Allahun, lëri ata armiq.” (Barnaba, verseti 26.)

Edhe në ajetin 24 të sures et-Teube, theksohet i njëjti kuptim.

Shijimi i besimit është lumturia më e madhe. Arritja e këtij shijimi ka disa kushte dhe tregues. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, i ka përmbledhur në këtë formë:

“Ka tri cilësi. Kushdo që i zotëron ato, e arrin ëmbël-sinë e besimit: Të duash Allahun dhe të Dërguarin e Tij më shumë se çdo gjë, të duash një rob vetëm për hir të Allahut dhe ta pranosh të tmerrshme si hedhja në zjarr rikthimin në kufër pasi të shpëtosh prej tij.” (Buhari, Iman, 9; Muslim, Iman, 67.)

Dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), është prej treguesve të besimit, sepse Ai na ka njoftuar për të Dashurin e vërtetë. “Askush prej jush nuk mund të jetë besimtar i vërtetë përderisa të mos më dojë mua më shumë se babain e tij, fëmijën e tij dhe të gjithë njerëzit.” (Buhari, Iman, 8; Muslim, Iman, 70.)

Në një fetari që nuk ka vetëdije, nuk ka dobi. Një fetari e tillë është si një barrë apo si një punë pa pagesë, që pret ta lësh në çdo moment. Namazi, që pothuajse do të thotë takim dhe bisedim i robit me Allahun Teala, është burim lumturie dhe gëzimi për besimtarët, ndërsa për hipokritët është torturë. Kjo shprehet kështu në Kuranin Fisnik:

“Ndhimesat e tyre nuk do të pranohen, ngase ata janë njerëz që nuk besojnë në Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Namazit i afrohen vetëm në mënyrë të ngathët dhe nuk shpenzojnë (nga pasuria), veçse në mënyrë përbuzëse.” (Teube, 54.)

“Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtrojnë Allahun, por Allahu mbizotëron dinakëritë e tyre. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t’u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak.” (Nisa, 142.)

Allahu e përshkruan kështu gjendjen e atyre që janë fetarë vetëm për interesa:

“Disa njerëz të tjerë e adhurojnë Allahun me kusht: Nëse u ecën mbarë, janë të kënaqur, por, nëse i godet fatkeqësia, ata kthehen në mohim e kështu humbasin këtë botë dhe tjetrën. Pikërisht kjo është humbja e qartë.” (Haxh, 11.)

Për hipokritët namazi është torturë, por për besimtarët është miraxh, strehim dhe ndriçim. Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), binte në ndonjë vështirësi, menjëherë përgatitej për namaz dhe thoshte:

“O Bilal! Thirrre ezanin dhe na qetëso!”

H. Sulejman Darani, i cili ishte prej të mëdhenjve të sufive, ka thënë: “Nëse namazi do të ishte në një anë dhe xheneti në anën tjetër, unë do të zgjidhja namazin, sepse te xheneti është interesi im, ndërsa te namazi është kënaqësia e Allahut.”

Një fetari, e cila përjetohet duke e shijuar, rritet dhe zhvillohet veçanërisht në një ambient mistik. Sulltanët shpirtërorë, si Hallaxhi, Ibrahim Et’hemi, Mevlana dhe Junus Emreja, jetuan të lumtur në klimën e dashurisë, arritën pavdekshmërinë me të dhe u forcuan me ngjyrën hyjnore. Gjetën mjaltin më të mirë dhe arritën sulltanatin shpirtëror.

A do ta linte Ibrahim Et’hemi kurorën mbretërore dhe fronin, sikur sulltanati shpirtëror të mos ishte më i vlefshëm se sulltanati i kësaj bote? A do të ishte e mundur ndarja nga jeta, pasuria, vendi dhe miqtë, sikur ëmbëlsia e besimit të mos ishte më e lartë se çdo ëmbëlsi tjetër materiale dhe sikur dashuria hyjnore të mos i ëmbëlsonte të gjitha dhimbjet? A do ishte bërë hixhreti në Etiopi dhe Medine? A do të preferohej varfëria ndaj pasurisë dhe torturat ndaj rehatisë?

Suksesi në një punë është i lidhur me kryerjen e asaj pune në mënyrë të përzemërt. Ne kemi një fjalë të urtë: “Nëse çobani e bën punën me zemër, nxjerr qumësht edhe nga cjapi.” E gjithë çështja është te dëshira dhe vullneti. Edhe te praktikimi i fesë përzemërsia është bazë si në çdo gjë tjetër. Parimi: **“Nuk ka dhunë në fe.”** (Bakara, 256.) – është prej parimeve themelore të Islamit. Allahu Teala thotë:

“Sikur të donte Zoti yt, do të besonin të gjithë ata

që gjenden në tokë. Vallë, ti do t’i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?” (Junus, 99.)

“Me të vërtetë, Ne i treguam njeriut rrugën e drejtë. Tashmë, në dashtë, le të bëhet besimtar falënderues dhe në dashtë le të bëhet qafir mosmirënjohës.” (Insan, 3.)

“Prandaj këshilloji (njerëzit o Muhamed), se ti je vetëm këshillues. Ti nuk je ngarkuar t’i detyrosh ata me forcë!” (Gashije, 21-22.)

Diçka që bëhet pa dëshirë, kthehet në urrejtje. Edhe gjërat e bukura, që bëhen me imponim, fillojnë të duken të shëmtuara për atë që i bën. Ndërsa gjërat e këqija, që bëhen me dëshirë, pëlqehen nga ai që i bën. Edhe punët më të vështira bëhen të lehta, nëse ka vullnet të mirë. Ndërsa punët që bëhen pa dëshirë e vullnet, duken si male.

Pas namazit të mëngjesit, Ibn Tejmije qëndronte në vendin e tij derisa dielli ngrihej lart. Përgjatë kësaj kohe, preokupohej me dhikër dhe tespihe. Ai thoshte:

“Ky është mëngjesi im. Nëse nuk e bëj këtë, më bie fuqia.”

Zemra e besimtarit është bahçe e xhenetit. Besimtari është një njeri që jeton në xhenet me ëmbëlsinë e besimit, edhe pse është në këtë botë. Ibn Tejmijen e futën në burg dhe e torturuan, por ai thoshte:

“Çfarë mund të më bëjnë mua armiqtë e mi? Unë e kam xhenetin në zemër. Kudo që të shkoj, nuk ndahet prej meje.”

Fetaria e vetëdijshme është fuqi, ndërsa fetaria pa dëshirë është një hiç. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

“Mos u ligështoni dhe mos u pikëlloni, sepse ju, gjithsesi jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë.” (Al ‘Imran, 139.)

Punët e vështira i kanë kryer me sukses vetëm besimtarët. Kurrë nuk është njëllor muxhahidi dhe ushtari me pagesë. Ai që lufton për para, e ka të gjithë llogarinë e tij në këtë jetë, sepse, nëse vdes, paraja nuk ka për t’i bërë më dobi. Por ai që përpiqet për Allahun, duke kërkuar kënaqësinë e Tij, do të ketë përfitim të përhershëm.

Fetaria është vetëdije e lartë dhe jo thjesht institucion. Vetëdija përfaqëson esencën, ndërsa institucioni formën. Allahu Teala nuk shikon format, por zemrat, sepse zemra është froni i Zotit. Në këtë fron nuk mund të ketë mbret tjetër përveç Allahut. Qoftë në shërbimet fetare apo qoftë në shërbimet zyrtare, produktiviteti është i lidhur me kryerjen e punës me dëshirë, dashuri dhe besim. Ta shndërrosh qenien nga forma në zemër, të mbjellësh dëshirën e shërbimit në zemrat joproduktive dhe të zhvillosh dëshirën e humanizmit në vend të lakmisë, është shumë e rëndësishme në këtë botë, ku çdo gjë matet me anën materiale të saj.



Varfëria e zemrës

Mesut Kaja

Niveli i mirëqenies dhe standardi i jetës po rritet çdo ditë e më shumë dhe, si pasojë, shpenzimet, harxhimet dhe prirjet për të bërë një jetë luksoze po rriten. Makinat luksoze, vilat dhe veshjet e shtrejta po njohin një përhapje marramendëse. Mjafton të shikosh pak me vëmendje nëpër qendra tregtare, nëpër rrugë dhe në ndërtime të bëra, për të arritur në përfundim se shoqëria po pasurohet gjithnjë e më shumë.

Përballë kamjes materiale por përjetojmë një skamje shpirtërore, që sa vjen e theksohet më shumë. Shpirti, zemra dhe ndjenjat tona gjithnjë e më shumë po varfërohen. Teksa dëshira dhe ambicia për t'u pasuruar materialisht rritet vazhdimisht, besimi në zemrat tona pëson rënie. Sinqeriteti është afër nivelit kritik.

Njerëzit e zemrës po pakësohen, po ashtu edhe ush-

tarët e kauzës islame, të cilët mbajnë gjallë shoqërinë. Ndërsa ata që janë emigrojnë në botën tjetër, në vend të tyre vijnë gjithnjë e më pak ose ndoshta nuk vjen askush. Dikur qëllimi i dijetarëve ishte shërbimi dhe jo fitimi i pasurisë përmes diturisë.

Marrja e një kauze përsipër pa asnjë interes material është shenjë e pasurisë shpirtërore. Ata kishin vlera, të cilat përpiqeshin me gjithë qenien e tyre t'i lartësonin sa më lart. Qëllimi kryesor i tyre ishte përhapja e virtyteve dhe sjelljeve të bukura në mbarë shoqërinë. Ata e kishin vënë veten e tyre në shërbim të prodhimit të vlerave për kombin dhe gjithë njerëzimin.

Gjykata e Athinës, pas vendimit për dënimin me vdekje të Sokratit, e pyeti nëse kishte diçka të fundit për të thënë. Sokrati tha po dhe shtoi: "Nëse një ditë

rinia e këtij vendi braktis urtësinë dhe virtytin për pasurinë materiale, kërkoj t'i dënoni kështu siç po më dënoni mua”.

Siç kuptohet qartë nga kjo ndodhi, njerëzit e mëdhenj dhe idealistë, përpara pasurisë materiale kërkojnë përhapjen e vlerave dhe virtyteve në shoqëri dhe për të arritur këtë sakrifkuan edhe jetën e tyre, sepse ata e dinë shumë mirë se pasuria e vërtetë është jeta me dituri, urtësi, kulturë moral dhe virtyt.

Fatkeqësisht, rinia e sotme më tepër se nga dituria, urtësia dhe shërbimi po orientohet drejt pasurisë materiale, profesioneve fitimprurëse dhe sigurimit të mirëqenies materiale. Për hir të sigurimit të të mirave dhe mirëqenies materiale po sakrifkohet morali, feja dhe virtyti.

Pejgamberi (a.s.), në një hadith thotë: *“Pasuria e vërtetë nuk është pasuria materiale, por pasuria e zemrës.”* (Buhari, Rikak, 15; Muslim, Zekat, 40.)

Pasuria e zemrës përfshin pasurinë morale, shpirtërore dhe mjaftueshmërinë. Pasuria e zemrës është ndriçimi dhe zbukurimi i zemrës me dritën e Allahut dhe pastrimi i saj nga çdo gjë që nuk ka lidhje me Allahun. Gjendjen e këtyre, Allahu në Kuran e përshkruan kështu:

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten.” (Enfal, 2.)

Pasuria e shpirtërore konsiston në zotërimin e diturisë, urtësisë dhe veprimit sipas tyre. Në të vërtetë, dijetarët përbëjnë vlerën e vërtetë të shoqërisë. Sepse shoqërinë e mbajnë gjallë dijetarët e vërtetë. Rrënimimi i një shoqërie, që nuk i jep rëndësi diturisë dhe urtësisë është i pashmangshëm. Lënia pas dore e diturisë, e cila përbën shtyllën kurrizore të shoqërisë islame, është një tradhti e madhe që i bëhet kësaj feje.

Pejgamberi (a.s.), përmes haditheve na informon se dituria do të zhduket me vdekjen e dijetarëve, se njerëzit për dituri do të pyesin injorantët, kurse ata do të japin gjykime dhe vendime sipas egos së tyre. (Buhari, l'tisam,7.)

Pasuria shpirtërore është sinqeritet ndaj Allahut, Kuranit, Pejgamberit (a.s.) dhe gjithë myslimanëve. Qëndrimi në rrugë të drejtë, duke respektuar me përpikmëri urdhëresat dhe ndalesat hyjnore, si në mirëqenie dhe skamje, është pasuria më e madhe që mund të zotërojë një njeri. Pejgamberi (a.s.), një pasuri shpirtërore të tillë ka kërkuar prej Allahut në lutjet e tij. “O

Zot, kërkoj prej Teje udhëzim, devotshmëri, ndershmëri dhe një zemër të pasur.” (Muslim, Dhikër, 18.)

Zotërimi i të gjithë këtyre është pasuria më e shtrenjtë, kurse privimi nga këto është skamja më e madhe. Enes Ibn Maliku tregon se e ka parë Omerin (r.a.), me rroba të arnuara, ndërsa ishte udhëheqës i shtetit. (Muvatta, Libas, 8.) Kjo që tregon Enes ibn Maliku ka ndodhur në një kohë kur shteti islam sundonte mbi gjithë lindjen e mesme. Por Omeri (r.a.), me gjithë mundësinë e madhe për pasuri, preferoi të bënte një jetë krejtësisht askete. Kush mund ta quajë Omerin (r.a.), të varfër? Si mund të quhet i varfër një njeri që ka gjetur pasurinë e vërtetë?

Sa bukur e shpreh këtë kjo fjalë e Rumiut: *“Sa njerëz pa rroba dhe sa rroba pa njerëz kam parë.”* Në të kaluarën ndoshta njerëzit nuk kishin rroba të mjaftueshme për të veshur, por ishin shumë më të pasur se ne përse i përket moralit, diturisë, urtësisë dhe njerzillëkut. Në ditët tona mund të gjesh shumë rroba klasi, por nuk mund të gjesh njeri brenda tyre. Gjendja jonë i ngjason personit që del ditën për diell me kandil në dorë për të kërkuar një “njeri”.

*“O Zot,
kërkoj prej Teje
udhëzim,
devotshmëri,
ndershmëri dhe një
zemër të pasur.”*

Poeti dhe filozofi i famshëm Muhamed Ikbali, në një poezi të tij e shpreh kështu rënien cilësore të besimit dhe varfërinë shpirtërore: *“Turp për ne, ka humbur ekzaltimi dashuror, në dejet e myslimanëve nuk rrjedh më gjak, shikon namazin e tyre: rreshtat të çrregullt, sexhdet të paqeta, zemrat pa siguri, e gjitha kjo sepse në brendësinë e njeriut është shuar drita hyjnore.”*

Rritja ekonomike ka sjellë një dobësim të ndjenjave fetare. Historikisht, ngritja ekonomike është shoqëruar me rënie të besimit. Madje, pasuria solli tronditje të mëdha shpirtërore qysh në periudhën e hershme të Islamit, dhe shumë myslimanë u përfshinë nga kjo vorbull, por fatmirësisht atëherë cilësia totale e diturisë, urtësisë dhe moralit ishte e lartë. Zhytja e një pjese në vorbullën e pasurisë nuk e dëmtoi cilësinë e përgjithshme morale të shoqërisë.

Por sot përballë shekullarizmit dhe materializmit shumë të egër dhe të fuqishëm nuk po gjejmë forcë për ta luftuar. Në momentin që kjo frymë hyn në zemrat tona, rreziku për të përmbysur besimin tonë është shumë i madh. Thënë ndryshe, dhënia pas kësaj bote është një virus, që shkatron me shpejtësi të madhe sinqeritetin tonë. Kjo varfëron zemrat dhe dëmton personalitetin tonë. Ndërsa vrapojmë për të fituar dhe shpenzuar më shumë, në të vërtetë ne shpenzojmë vetveten.

*Dhe i Dërguari do të thotë:
"O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kuranin,
si (diçka) të urryer."*

(Furkan, 30)

Në fund të shekullit të 19-të kryeministri i Britanisë së madhe, Gladstone, me Kuran në dorë deklaroi në parlamentin britanik: "Përderisa ky libër është në zemrat e myslimanëve, ne nuk mund t'i sundojmë ata. Ose do të zhdukim Kuranin, ose do të largojmë myslimanët nga Kurani."

Fatkeqësisht, ky qëllim i armiqve të Islamit, deri diku është arritur. Ata nuk mundën ta zhduknin Kuranin, por realiteti i sotëm i myslimanëve tregon që janë shumë larg mësimëve dhe porosive kuranore. Kurani ka mbetur i braktisur nëpër rafte dhe prejaty sikur u thërret myslimanëve: "O myslimanë! Kur do ta ndani për mua një pjesë të vogël nga koha që ndani për televizionin?"

Një pjesë e myslimanëve përpiqen për shkak të traditës, të zbatojnë disa urdhëresa dhe ndalesa të Kuranit. Një pjesë e madhe e myslimanëve e përdorin Kuranin vetëm për qëllime adhurimi, si faljen e namazeve. Këndimi i Kuranit realizohet vetëm në ditë të posaçme. Dhe një pjesë shumë e vogël përpiket seriozisht për të kuptuar mesazhin e Kuranit.

Pjesa më e madhe e myslimanëve nuk ka arritur të krijojë një marrëdhënie të ngrohtë, dinamike dhe frytdhënëse me Kuranin. Për këtë arsye, nuk munde të përfitojmë prej thesareve dhe bukurive të Kuranit. Sot në botë realizohen me qindra konkurse për bukurlëxim të Kuranit dhe nuk bëhet asnjë përpjekje për të nxitur njerëzit në kuptimin e Tij. Në këtë mënyrë, ne e ndryshuam rolin

dhe misionin e Kuranit. E lexojmë vetëm për sevap, kurse kuptimi i tij u bë monopol vetëm i dijetarëve. Të lexosh Kuranin për sevap, natyrisht është bukur, por qëllimi i Kuranit nuk është ky. Nëse e lexojmë Kuranin vetëm për ibadet, privohemi nga kuptimi i përmbajtjes së Tij. Gjithësecili prej nesh mund ta ketë lexuar Kuranin me dhjetëra herë pa bërë përpjekjen më të vogël për të kuptuar mesazhin e asaj që lexon. Pejgamberi (a.s.), në Ditën e Gjykimit do të ankohet tek Allahu për ata që kanë braktisur Kuranin. Myslimanët nuk e kanë braktisur kurrë Kuranin në kuptimin fizik. Ai gjithmonë ka zënë vendin më të rëndësishëm në botën e vlerave të tyre. Por myslimanët janë larg përfitimit shpirtëror, udhëzimit dhe gjallërisë së Tij. Myslimanët janë të privuar nga drita dhe shkëlqimi i Tij.

Kurani ka qenë burimi i qytetërimit të famshëm islam. Ai ka qenë burim frymëzimi për shekuj me radhë për myslimanët. Myslimanëve u bie detyra t'i rikthejnë Kuranit rolin e vet në shoqëri, si burim jete dhe qytetërimi. Detyra jonë ndaj Kuranit asnjëherë nuk mbaron me një hatme. Përgjegjësia jonë është kuptimi dhe jetësimi i Tij. Vetëm në këtë mënyrë myslimanët do të pësojnë ndryshimin dhe transformimin në botën shpirtërore dhe morale dhe vetëm në këtë mënyrë ata mund të bëhen përsëri udhëheqës, shembull, shpresë dhe burim drite për gjithë njerëzimin.

Pejgamberi -(a.s.)-, ka thënë:

"Allahu ka urdhëruar ihsanin në çdo gjë..."

(Muslim, Sajd dhe Dhebah, 57)

Ihsani përfshin kuptimet dashamirësi, përfeksion, përsosmëri, mirësjellje, bamirësi dhe bujari. Ihsani është një term moral shumë i rëndësishëm i mësimëve islame, i cili përfshin të gjitha aspektet e jetës së besimtarit. Allahu kërkon prej njeriut që çdo sjellje e tij të jetë në nivelin më të lartë të mundshëm. Personat që i kryejnë punët në nivelin e ihsanit, i pret një shpërblim i madh dhe ata nuk do të kenë as frikë, as brengë në Ditën e Gjykimit. Në shumë ajete kuranore, Allahu i informon besimtarët se Ai do të jetë më afër bamirësve.

Përkufizimin më të saktë të ihsanit e ka bërë Pejgamberi (a.s.), në hadithin e famshën të Xhebrailit. Kur Xhebraili, i mishëruar në formën e njeriut, e pyeti Pejgamberin (a.s.), për imanin, Islamin dhe ihsanin, Pejgamberi (a.s.), në lidhje me ihsanin i tha: *"Ihsani është t'i bësh ibadet Allahut sikur e shikon. Edhe nëse ti nuk e shikon atë, Ai të shikon ty."* Nga ky hadith kuptojmë se ihsani përfshin edhe vetëdijen për mbikëqyrjen e vazhdueshme të Allahut mbi krijesat e Tij. Prandaj ihsani është një element bazik i fesë islame, i cili plotëson besimin dhe veprën. Pejgamberi (a.s.), e ka theksuar më tepër këtë veçori të ihsanit, duke e urdhëruar për besimtarët në të gjitha mendimet dhe aktet e tyre. Sepse ihsani nuk përfshin vetëm marrëdhënien tonë

me Allahun, por të gjitha marrëdhëniet e njeriut me mjedisin. **"Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë** (në adhurim); **silluni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët, të varfrit, fqinjët e afërt dhe të largët, me atë që keni pranë, me udhëtarin** (që ka mbetur ngushtë) **dhe me ata që janë robër nën pushtetin tuaj."** (Nisa, 36.) Allahu i përshkruan kështu veçoritë e besimtarëve që janë mbujtur me virtytin e ihsanit: **"Të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit. Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre - e kush i fal gjynahet përveç Allahut? - dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë."** (Ali Imran, 34-35)

Siç kuptohet lehtë, ihsani shpreh pikën kulmore të besimtarit në lidhje me Zotin dhe krijesat e Tij. Përmes këtij virtyti, besimtari bëhet pjesë e sihariqit: "Ata që bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër! Fytyrat e tyre nuk do t'i mbulojë as errësira, as poshtërimi. Ata do të jenë banorë të Xhenetit, në të cilin do të banojnë përherë." (Junus, 26)

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Vetëdijësimi për mbikëqyrjen hyjnore në çdo veprim dhe mendim të njeriut.
2. Rritja e përgjegjësisë për veprimet dhe sjelljet tona.
3. Përpjekja maksimale për punë cilësore.
4. Shpërblimi i madh që i pret besimtarët, që e kanë ihsanin mënyrë jetese.

Mje: Hadith



SHËRBIMI PËR HIR TË ALLAHUT NË JETËN E PEJGAMBERIT (A.S.)

Pejgamberi (a.s.), është i vetmi burim mëshire dhe dashurie që të çon në detin e dashurisë ndaj Allahut (xh. sh.). Për këtë arsye, mund të themi se dashuria për të është dashuri për Allahun, bindja ndaj tij është bindje ndaj Allahut dhe kundërshtimi ndaj tij është kundërshtim ndaj Allahut. Pejgamberi (a.s.), është një strehë mëshire për të gjithë njerëzit.

Nuk duhet të harrojmë, se u nderuam me Kuran dhe u bëmë umeti/populli i Pejgamberit (a.s.), pa paguar asnjë lloj çmimi. Prandaj, jeta jonë duhet të jetë e atillë, që të meritojë ndërmjetësimin e Kuranit dhe Pejgamberit (a.s.), në të dyja botët. Dashuria për Pejgamberin (a.s.), duhet të jetë mbi çdo gjë, madje edhe më e shenjtë se vetë jeta jonë, sepse duke dashur atë, fitojmë dashurinë dhe kënaqësinë e Allahut. Ai është parimi i besimit, është kushti i dytë i Formulës së Dëshmisë (shehadetit).

Jeta e tij është një thesar të fshehtash dhe urtësish hyjnore, është burim i paqes dhe i lumturisë së përjetshme. Është e pamundur ta njohësh atë ashtu siç duhet, vetëm duke mbetur brenda kufijve të ngushtë të rreshtave të librave. Për ta kuptuar atë, kërkohet një zemër e dashuruar dhe një shpirt i përmalluar. Vetëm në sajë të një dashurie të vërtetë, mund të kemi nderin të jemi së bashku me të. Siç shprehet edhe vetë:

"Njeriu është bashkë me atë që do." (Buhari, Edeb, 96.)

Treguesi më i rëndësishëm i këtij bashkimi, është ngjashmëria e personit me atë që do, në gjendje, në fjalë dhe në sjellje.

Mëshira e besimtarit është edhe dëshmitarja e besimit. Kurse treguesi i mëshirës, është shërbimi në rrugën e Allahut. Shembujt më të virtytshëm, më të lartë e më të mahnitshëm të shërbimit, mund t'i shohim në jetën e Pejgamberit (a.s.):

Për shembull, me gjithë këmbënguljen dhe përpjekjen e sahabëve për ta penguar, Pejgamberi (a.s.), ka punuar së bashku me ta në rindërtimin e Qabes, në ndërtimin e xhamisë Kuba, xhamisë së tij në Medinë dhe në hapjen e hendekut në betejën e Hendekut.

Gjithashtu, Pejgamberi (a.s.), është marrë vetë personalisht me përfaqësuesit e fiseve që vinin tek ai, madje edhe u ka shërbyer atyre. Kur i vinte ndonjë mysafir, nëse ishte në shtëpi, menjëherë i ofronte atij një shilte për t'u ulur; nëse ishte jashtë, hiqte shallin e tij dhe ia vinte si shtrojë mysafirit.

Kjo modesti dhe frymë shërbimi kaq e lartë e Pejgamberit tonë të nderuar, është një model i pashoq dhe ideal për të gjithë umetin islam. E gjithë jeta e tij, nga fillimi deri në fund, kaloi me shërbime plotë mëshirë për njerëzit dhe gjithë krijesat. Ja disa shembuj nga jeta e tij e bekuar:

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka qenë në ballë të çdo pune që bëhej për hir të Allahut. Edhe pse ishte kryetar shteti, ai barti qerpiçë, së bashku me shokët e tij në ndërtimin e xhamisë së tij në Medinë. Ndërkohë që mbarnte qerpiçët, thoshte:

"Kjo barrë, nuk është si barra e Hajberit. O Zoti ynë! Kjo është një punë akoma më e mirë dhe më e pastër që mbetet tek Ti." (Buhariu, Menakibu'l-Ensar, 45.)



Me këto fjalë, Pejgamberi (a.s.), ka dashur të thotë, se ngarkesa që po bartnin, nuk ishte për ndonjë interes të kësaj bote. Kjo përpjekje në rrugën e Allahut, është më e mirë dhe më me vlerë se mallrat që bartin njerëzit nga Hajberi për qëllim tregtie, si hurmat dhe rrushi i thatë.

Gjatë ndërtimit të xhamisë, kur një person, i cili po mbarnte dhë, ndeshi Pejgamberin (a.s.), i tha:

“O Pejgamber i Allahut! Më lejoni ta mbaj unë qerpiçin që keni në duar!” Kurse Pejgamberi (a.s.), iu përgjigj:

“Ti shko dhe merr një tjetër! Në të vërtetë, ti nuk ia ke nevojën Allahut më shumë se unë!” (Semhudi, Vefau'l-Vefa, Bejrut, 1997, I, 333.)

Kur Pejgamberi (a.s.), u nis së bashku me shokët e tij për në Bedër, për shkak se numri i deveve ishte i pamjaftueshëm për të gjithë, ata hipnin tre veta me radhë në një deve. Pejgamberi ynë i nderuar, e ndante devenë e tij bashkë me **Aliun** (r.a.), dhe **Ebu Lubaben** (r.a.). Kur i erdhi rradha Pejgamberit (a.s.), të ecte më këmbë, shokët i thanë:

“O Pejgamber i Allahut, ju lutemi, hipni ju! Ecim ne në vendin tuaj”. Ndërsa Pejgamberi (a.s.), u përgjigj:



Mëshira e besimtarit është edhe dëshmitar i besimit. Kurse treguesi i mëshirës, është shërbimi në rrugën e Allahut. Shembujt më të virtytshëm, më të lartë e më të mahnitshëm të shërbimit, mund t'i shohim në jetën e Pejgamberit (a.s.).

“Ju nuk jeni më durimtarë se unë në ecje. Përveç kësaj, unë nuk jam më pak nevojtar se ju për të fituar shpërblime.” (Ibn Sa’d, II 21; Ahmed, I, 422.)

Bera bin Azib (r.a.), tregon:

“Në ditën e Ahzabit¹, e pashë Pejgamberin (a.s.), të barte dhë bashkë me ne. Barku i tij i bardhë ishte bërë gjithë dhë e pluhur. Ndërsa ai po recitonte këtë poezi të **Abdullah bin Revahës**:

“Zoti im! Nëse nuk do të na kishte udhëzuar në rrugën e drejtë, ne as nuk do të jepnim lëmoshë e as nuk do të falnim namaz! O Zot! Zbrit qetësi mbi ne kur të përballlemi me armikun! Mos lejo të na rrëshqasin këmbët! Ata na sulmuan. Nëse ata duan të na fusin në ngatërresa e trazira, ne nuk ia mbathim, por qëndrojmë.

Kur lexonte fjalën “Ebejna” në vargun, “ne nuk ia mbathim, por qëndrojmë”, në fund të poezisë, e ngrinte zërin. (Shiko Buhariu, Megazi 29, Xhihad, 34.)

Njëherë, Pejgamberi ynë i nderuar kërkoi prej sahabëve të thernin një dash e ta piqnin. Njëri nga shokët i tha:

- O Pejgamber i Allahut, do ta ther unë dashin.

1. Në luftën e Hendekut, myslimanët u përballën me shumë fise të ndryshme njëherësh. Prandaj, këtë luftë e kanë quajtur edhe Ahzab.

Tjetri i tha:

- O Pejgamber i Allahut, ma ngarko mua detyrën e rrjepjes.

- O Pejgamber i Allahut, pjekjen ma lër mua! - i tha një tjetër.

Dhe Pejgamberi ynë i nderuar u përgjigj:

- *Atëherë, mbledhja e drurëve më takon mua.*

- O Pejgamber i Allahut, i thanë shokët, - i mbledhim ne drutë, ju mos u lodhni!

Pejgamberi (a.s.), u tha:

- *Unë e di që ju mund ta bëni edhe punën time, por mua nuk më pëlqen të jem më i privilegjuar se ju, sepse Allahu i Lartësuar nuk e do robin që privilegjohet mes shokësh.* (Kastallani, El-Mevahibul-Ledunniyye, Egjipt, 1281, I, 385.)

Kur e pyetën **Aishen** (r.a), se çfarë bënte Pejgamberi (a.s.), në shtëpi, ajo u përgjigj:

"I shërbente familjes së tij. Kur vinte koha e namazit, shkonte të falej." (Buhariu, Ezan 44.)

Ebu Musa (r.a.), tregon:

"Pejgamberi (a.s.), hipte në gomar, vishte rroba prej leshi të ashpër, ulej në gjunjë dhe milte delet, kujdesej për mysafirët, u shërbente dhe i qeraste ata." (Hakim, I, 129/205.)

Njëherë, kur përfaqësuesit e sundimtarit të Habeshistanit (Etiopisë) erdhën tek Pejgamberi ynë i nderuar, ai u kujdes vetë për ta, madje edhe u shërbeu atyre.

Kur sahabët i thanë se mund t'u shërbenin ata mysafirëve, Pejgamberi i nderuar (a.s.), u dha këtë përgjigje madhështore, e cila tregon dashurinë e madhe dhe dhembshurinë që ndjente ai për umetin e tij:

"*Këta i pritën dhe u shërbyen shokëve të mi që emigruan në Habeshistan. Në këmbim të kësaj, dëshiroj që tani t'u shërbej unë këtyre.*" (Bejhaki, Shuab, VI 518, VII 436.)

Xhabiri (r.a.), ka thënë:

"Kur udhëtonte, Pejgamberi (a.s.), ecte gjithmonë mbrapa, u ndihmonte të pafuqishmëve, i hipte ata mbi samarin e kafshës së tij dhe lutej për ta." (Ebu Daud, Xhihad, 94/2639.)

Xhaxhai i nderuar i Pejgamberit tonë (a.s.), **Abasi** (r.a.), kishte vreshta me rrush në Taif, prej të cilave prodhonte rrush të thatë dhe furnizonte vendet përreth, si para, ashtu edhe pas Islamit. Rrushin e thatë e përziente me ujën e zemzemit dhe ua shërbente haxhinjve. Më pas edhe fëmijët e nipërit e tij vazhduan të njëjtën gjë. (Ibn Hisham, IV, 32; Ibn Sa'd, II 137, Vakidi, II, 838.)

Njëherë, Pejgamberi (a.s.), kishte shkuar në Haremin Sherif (Qabe), tek vendi ku shërbej ujë dhe sherbet



"Unë e di që ju mund ta bëni edhe punën time, por mua nuk më pëlqen të jem më i privilegjuar se ju, sepse Allahu i Lartësuar nuk e do robin që privilegjohet mes shokësh."

dhe kishte kërkuar për të pirë. Abasi (r.a.), i thotë të birit:

- O Fadil, shko te nëna dhe silli Pejgamberit (a.s.), nga pijet e veçanta!

Pejgamberi ynë i nderuar i tha:

- *Jo, më jep nga këto pijet që pinë të gjithë!*

Hazreti Abasi (r.a.), i thotë:

- O Pejgamber i Allahut, ndonjëherë këtu njerëzit e prekin ujën me dorë.

- *S'ka gjë, më jep nga pija ku pinë të gjithë njerëzit!*

- i tha Pejgamberi ynë i nderuar dhe piu atë që i dha Hazreti Abasi (r.a.).

Më pas, Pejgamberi (a.s.), shkoi tek burimi i zemzemit. Pjesëtarët e familjes së Abasit (r.a.), nxirrnin ujë prej aty dhe u jepnin të pinin haxhilerëve. Pejgamberi (a.s.), i përgëzoi ata duke u thënë:

"*O bijtë e Abdul Mutalibit, vazhdoni të nxirrni ujë! Ju po bëni një punë të mirë!*" Pastaj vazhdoi:

"*Sikur ta dija që njerëzit nuk do të dynden këtu e t'ju shqetësojnë (vetëm sepse e bëra unë një gjë të tillë), do të kisha zbritur nga deveja, do ta vendosja këtu litarin e pusit (dhe bëri me shenjë nga supi i tij i bekuar) dhe do të nxirrja ujë tamam si ju.*" (Buhariu, Haxh, 75.)



Allahu

më i miri i krijuesve

Selman Ibn Fehd el Aude

Njëri prej emrave të Allahut Lavdiplotë dhe të Lartmadhëruar është emri i Tij “El Khalik-Krijuesi”, “El Khalak-Krijuesi i Fuqishëm” dhe “më i Miri i krijuesve”.

Emri i Allahut “El Khalik-Krijuesi” është përmendur në Kuranin Fisnik në njëmbëdhjetë vende. Disa prej tyre janë ajetet: “**Ai është Allahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi...**” (Hashr, 24) dhe fjala e Lavdiplotit: “**Allahu është krijues i çdo gjëje...**” (Zumer, 62)

Në trajtën “më i Miri i krijuesve” ka ardhur në fjalën e Allahut Lavdiplotë: “**...I Lavdishëm është Allahu, më i Miri i krijuesve!**” (Muminun, 14) dhe në fjalën e Lavdiplotit: “**A e adhuron i (idhullin) Ba'lën, e braktisni adhurimin e më të Miri të krijuesve [Allahut]?**” (Safat, 125).

Ndërsa emri i Tij “El Khalak-Krijuesi i Fuqishëm” ka ardhur në dy raste, në fjalën e Allahut Lavdiplotë: “**Vërtet, Zoti yt është Krijuesi i Fuqishëm, më i Dijshmi**” (Hixhër, 86) dhe në fjalën e Lavdiplotit: “**...Po, Ai (Allahu) është Krijuesi i Fuqishëm, i Dijshmi**” (Ja Sin, 81).

Çdo gjë që gjendet në univers është krijesa e Tij që dëshmon, njeh dhe pohon hyjninë dhe zotësinë e Tij. Gjithë sa shikon rreth teje është argument pro Allahut, gjë mbi vërtetësinë e së cilës vjen fjala e Allahut Lavdiplotë dhe të Lartmadhërueshëm: “**Kjo është vepër e krijimit të Allahut, më tregoni pra mua se ç’krijuan të tjerët veç Tij?...**” (Lukman, 11); pra ata që i lusin padrejtësisht veç apo krahas Allahut, çfarë kanë krijuar?; “**Thuaj: ‘Më**

thoni për ata që pos Allahut po i adhuron, më tregoni çfarë krijuan ata në tokë dhe a kanë pjesëmarrje në qiej (në krijimin e tyre)? Nëse jeni të sinqertë, më sillni ndonjë libër para këtij (Kuranit) ose ndonjë gjurmë të mbetur prej diturisë (ku të hidhet dritë mbi saktësinë e pretendimit tuaj të pabazë se ata që ju i keni shoqëruar Allahut, afrojnë tek Allahu)” (Ahkaf, 4).

Je i ftuar të meditosh mbi shembujt në vijim:

Së pari: rreth 500-600 milion spermatozoidë kalojnë në rrugën e tyre nëpër mitër dhe unë e ti nuk jemi veçse një prej këtyre spermatozoidëve, teksa çdo spermatozoid prej këtyre disponon mundësinë të jetë njeri me lejen e Allahut Lavdiplotë dhe të Lartmadhërueshëm.. Porse Allahu Lavdiplotë dhe i Lartmadhërueshëm, falë urtësisë dhe gjithmundshmërisë së Tij, zgjodhi që vetëm një prej këtyre miliona spermatozoidëve të arrijë ta fekondojë vezoren, që ky njeri të jetë uniku i përzgjedhur, të zotërojë aftësinë e të folurit, të arsyetuarit, të veprojë dhe reagojë me vullnet të lirë në çështjet e tij, brenda lejes së Zotit të vet.

Kështu u krijuam. Le të tregojmë modesti karshi madhësisë dhe krenarisë sublime të Allahut Lavdiplotë dhe të Lartmadhërueshëm! Ta nëpërmendim pra, fillimin tonë se ku gjendeshim, që të perceptojmë dallimin kolosal midis këtij spermatozoidi dhe këtij njeriu unik, të fuqishëm dhe solid.

Kjo e obligon njeriun të shprehë lavdërim për Allahun Lavdiplotë dhe të Lartmadhërueshëm, ta përmendë shumë, ta falënderojë dhe lëvdojë Atë.

Së dyti: në trupin e njeriut ka më se njëqind trilion qeliza, dhe brenda çdo qelize ka aparatura, mekanizma, procese, programe, hartime dhe informacione, që të gjitha së bashku i thurin lavdi Zotit të tyre të Lartmadhërueshëm, duke e kryer rolin e tyre në formën më të mirë dhe më të përsosur të mundshme.

Në çdo qelizë gjenden tridhjetë e një (31) miliard germa të ADN-së, që përbëhet nga një kombinim prej katër germash, që konsiston në një lëndë gjenetike të pranishme në bërthamat e qelizës, të cilat janë përgjegjëse për të gjithë proceset e ndryshme jetike trupore. Këto numra gjigandë germash të bërthamave acide, këto masive kolosale grimcash dhe qelizash të pranishme në trupin tënd, që të gjitha shprehin dhe afirmojnë Madhësitinë e Allahut Lavdiplotë dhe të Lartmadhërueshëm, faktin se Ai është Krijuesi i Fuqishëm.

Së treti: ngrije kokën lart, shikoje qiellin! Sipër kokës tënde ke miliarda galaktika, teksa një galaktikë konsiston në një plejadë yjesh të larmishëm, të paanë, të shumtë dhe gjigandë, prej të cilëve është ylli foshnje, që ende është në periudhën e “foshnjërisë”, prej të cilëve është ylli i ri, që është në periudhën e “adoleshencës” së tij dhe prej tyre është i moshuari i përthyer në moshën më të dobët, që po jeton ditët e tij të fundit; që të gjithë shprehin Madhësitinë e Allahut Lavdiplotë në kozmosin e paanë, ku ndajnë midis tyre distanca gjigande kozmike, të cilat vetëm Allahu Lavdiplotë dhe i Lartmadhërueshëm mund t’i katërcipërojë, saqë, nëse do përfytyronim një anije kozmike të ecë me shpejtësinë e dritës, që kapton 186 milje në sekond, ajo do merrte disa mijëra vite drite, vetëm që të kaptonte një galaktikë të vetme prej këtyre galaktikave.

Lëre më pastaj sa çoroditet mendja kur bën të përfytyrojë dimensionet gjigande hapësinore të lartësive përtej galaktikave. Pikërisht mbi këtë fakt, Allahu Lavdiplotë dhe i Lartmadhërueshëm ka thënë: **“Pra Unë (Allahu) betohem në atë që e shihni! E edhe në atë që nuk e shihni!”** (Hakka, 38-39) dhe ka thënë: **“Betohem në pozicionet (orbitat ndërhapësinore) e yjeve. E ai është betim i madh, sikur ta dinit!”** (Vakia, 75-76).

Njeriut, ka raste që i duket vetja i madh, madje ka raste që i duket dhe kolos! Vështron nga vetja dhe aty për aty nxiton të ngrejë kryet lart... Por nëse shikimin e tij do ta hidhte nga këto krijesa gjigande dhe madhështore, do të bëhej natyrshëm modest, i përlurur dhe do të përkulej para Madhësisë së Zotit të tij Lavdiplotë. Një prej

këtyre galaktikave mbi të cilat po flasim, ka në gjirin e saj një sasi ndërmjet dy bilion dhe njëmijë bilion yjesh dhe për çdo ditë shkenca zbulon risi në këtë kozmos, edhe pse metodat e zbulimeve ende konsiderohen të paafta dhe të limituara të kapin thelbin e fshehur të përbërësve të kozmosit. Prandaj, lypet që robi të perceptojë sa të mundet aspektet e madhësisë së Allahut të Lartmadhërueshëm të shpalosura te krijesa e Tij, duke e vendosur njeriu edhe veten e tij në këtë kuadër.

Natyra përbën librin e shpalosur të Allahut, që shpreh lavde, lëvdim dhe falënderimin për Zotin e saj. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka e edhe çfarë ka në to e nuk ka asnjë send që nuk i bën tesbih (madhërim) Atij, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni tesbihun (madhërimin) e tyre (pasi ai nuk është i kapshëm për perceptimin tuaj)...”** (Isra, 44).

Po kështu, Allahu Lavdiplotë dhe i Lartmadhërueshëm ka thënë: **“A nuk e di për Allahun se Atij i bën sexhde (nënshtrohet dhe përulet) kush është në qiej dhe kush është në tokë, edhe dielli, edhe hëna, edhe kodrat, edhe bimët, edhe shtazët e edhe shumë njerëz, teksa shumë meritojnë dënimin. Atë që e poshtëron Allahu nuk ka kush që mund ta bëjë të ndershëm. Allahu bën atë që dëshiron”** (Haxh, 18).

Mrekullia e këtij universi, bukuria dhe madhështia e tij, është vetëm një rreze e vogël e autorësisë, kreativitetit dhe novacionit të Krijuesit të Lartmadhërishëm.

Kur njeriu hahet ta zbresë në aktualitetin ku jeton idenë e krijimit spontan, ndihet shumë keq dhe e kupton se ky nuk është veçse një gabim dhe paturpësi! Shkencëtarët e profilizuar thonë se njeriu, nëse do këqyrte lidhur vetëm me probabilitetin e krijimit të rastësishëm, thjesht të një segmenti të vetëm prej segmenteve të vogla të proteines, një probabiliteti të tillë do t’i duhej jo më pak se tre bilion vite për të pasur gjasa. E çfarë mund të thuhej pastaj për krijimin e rastësishëm të tërë universit gjigand dhe totalit të përbërësve të tij? Jo jo, e tillë rastësi as që mund të vijë në caqet e imagjinatës, por e thëna e vetme, njëkohësisht edhe e vërteta e vetme, është që pas këtij krijimi perfekt qëndron vullneti i Allahut Lavdiplotë, të Lartmadhërueshmit, të Gjithëditurit, të Urtit!

Si do të reagoje, po të vinte dikush dhe të të informonte se një faqe e plotë letre me një citat letrar në të ose me një vjershë të mirësishtuar, nuk është shkruar nga askush, nga asnjë shkrimtar dhe asnjë poet, por germa e fjalëve të saj janë tubuar vetë në këtë radhitje, rastësisht; pa dyshim se kjo nuk do gjente vend për t’u pranuar në



arsyen tënde dhe arsyeja jote do ta hidhte tej atë. E lëre më pastaj, nëse do vinte të të thoshte të njëjtën gjë për një enciklopedi me qindra volume dhe dhjetëra mijëra faqe, ku do gjendeshin edhe imazhe, foto, definicione dhe informacione të përputhura krejtësisht me realitetin dhe me atë që thotë shkencë moderne. A mundet një njeri i arsyeshëm apo edhe i paarsyeshëm, të thotë: "Kjo enciklopedi gjigande nuk ka për autor të saj veçse rastësinë apo spontaneitetin?"

Përkundrazi, ajo që duhet të thuhet është se pas kësaj enciklopedie profesionale qëndrojnë punë, redaktime, korrektive, hulumtime, shkrime, printime, të cilat kanë kaluar nëpër një sërë periudhash derisa është arritur në këtë nivel... Kjo gjë përbën një nga aksiomat apo të vërtetat më të lehtëpranueshme.

Ateisti është një njeri i pashpresë, të cilit i janë mbyllur dyert dhe i janë vënë barrierat. Ai shkon qorrazi, i paudhëzuar, ecën pa ditur se ku, jeton pa qëllim në errësirën e tij totale shpirtërore. Nuk ka ide dhe dijeni as për fillimin nga ku erdhi, as për fundin ku po shkon dhe nuk ka ndonjë objektiv drejt të cilit rend.

Erdha, nuk e di se nga, por di që erdha, pashë para meje rrugë dhe mbi ta eca...

Dhe do vazhdoj në ecje desha apo nuk desha. Si erdha? Si e pashë rrugën time? Nuk e di!...

Ndërsa besimtari ndihet i qetë, i prehur, në maksimum. Ai, teksa mediton në mbretëritë e Allahut Lavdiplotë dhe të Lartmadhërueshëm, arrin të shikojë Madhështinë e Allahut të shpalosur në krijimin e Tij, në urtësinë e Tij të arrirë, në planifikimin e Tij perfekt, Allahu Lavdiplotë ka thënë: **"Ai që ecën me fytyrë përmbysur në tokë është më i udhëzuar apo ai që ecën në pozicion të balancuar, rrugës së drejtë?"** (Mulk, 22).

Meditimi në krijimin e Allahut e Lartmadhërueshëm, e orienton njeriun drejt përsosjes dhe fuqizimit të besimit në Allahun e Lartmadhërueshëm, ndaj dhe Allahu Lavdiplotë ka thënë: **"Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës** (duke thënë: **"O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh** (nga çdo e metë)! **Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit."** (Ali Imran, 190-191).

Medito!

Dëlirësoje, madhëroje dhe adhuroje Atë që të krijoj, të solli në këtë ekzistencë dhe tek Ai çdo gjë do të përfundojë.

Krijuesi, është emër i Allahut, që ka të bëjë me kuptimet e zotësisë së Tij.

Krijuesi është: Sundimtari, i Plotpushtetshmi për të planifikuar dhe vepruar, pra çështja nuk bën të qëndrojë thjesht tek aprovimi dhe njohja e Allahut të Lartmadhërueshëm. Në gazetën *News Week* kam lexuar një artikull të një shkencëtari amerikan të astronomisë, të bërë pas shtatëdhjetë viteve të tij të shkuara në laborator, duke përdorur aparataturat, teleskopët dhe teknologjinë më moderne në dispozicion, i cili shprehet: "Tani e njoha Zotin dhe u binda se duhet medoemos që pas këtij universi të qëndrojë një fuqi që njeriu s'e disponon!"

Pra, pas shtatëdhjetë vjetësh, besoi në ekzistencën e Allahut, por kur do të arrijë tek adhurimi i Tij, kur do t'ia japë Zotit të tij të drejtat e Tij, kur do ta përmendë, falënderojë dhe lëvdojë?

Kuptimet që përcollmë e orientojnë njeriun tek Allahu Lavdiplotë, që të bëhet personazh i podiumit të besimit në Të, përgjërimit për Të, mbështetjes tek Ai, zbatimit të urdhrit të Tij, moskapërcimit të kufijve të vendosur prej Tij, gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartmadhërueshëm ka thënë: **"Krijimi është i Tij dhe Atij i takon të urdhërojë, i Lartmadhëruar është Allahu, Zoti i botëve."** (Araf, 54).

Ai që krijon ka të drejtë të urdhërojë dhe udhëzojë, thënë ndryshe, të vendosë ligjin, të ketë të drejtën legjitime të urdhërojë dhe t'i tregohet bindje, të ndalojë dhe t'i tregohet bindje, të vendosë kufijtë dhe caqet e çështjeve, të ligjërojë dispozitat ligjore, Krijues dhe Ligjëvënës, të Cilit krijesave u duhet t'i binden dhe përgjigjen, pasi kanë njohur faktin se Ai nuk i krijoi ata vetëm se për këtë gjë!

Ateizmi është një ide injorante, që bie në kundërshtim me arsyen dhe ndërgjegjen, sidomos në kohën tonë të shkencës, planifikimit dhe zbulimeve kolosale. Por ekziston edhe e vërteta se ateizmi në të shumtën e rasteve ka qenë një vendim politik, sikurse në epokën e komunizmit, por është edhe rezultat i krizës shpirtërore të njerëzve dhe kombeve, që mungesa e qetësisë nuk i ka ndihmuar të arrijnë tek stabiliteti dhe prehja që do të lejonte për ta arritjen e freskisë së besimit, por ateizmi është edhe pasojë e një arsytimi të gabuar, të ardhur si pasojë e mosinteresimit, gjë të cilën e sqaron Kurani fisnik përmes fjalës së Krijuesit Lavdiplotë: **"...ata që nuk besuan, nuk ia vunë veshin vërejtjes që u tërhiqet..."** (Ahkaf, 3); por që ateizmi të jetë një gjykim i arsyeshëm, kjo nuk qëndron kurrsesi.

Shqipëroi: Altin Torba

Mënyra më e mirë për leximin, kuptimin dhe mësimin e Kuranit është mësimi i gjuhës arabe dhe thellimi në një marrëdhënie të mrekullueshme me Fjalën e Zotit, gjatë së cilës ndjen madhështinë dhe ëmbëlsinë e çdo ajeti.

Besimi në Librat e Shpallur dhe pak fjalë mbi Kuranin

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Çdo mysliman, pas besimit në Njësinë e Allahut dhe ekzistencën e melekëve, beson pa dyshim në shpalljen hyjnore të Librave të Shenjtë, në momente të ndryshme të historisë njerëzore. Këta Libra, Zoti i gjithësisë ua shpalli profetëve të ndryshëm, për të përforcuar thirrjen e tyre drejt vlerave të besimit, për të qenë një argument i patjetërsueshëm për njerëzinë drejt udhëzimit në jetë.

Libra qiellorë, do të thotë shpallje hyjnore me të cilën Allahu i Madhëruar i drejtohet të dërguarve të Tij nëpërmjet melekëve.¹ Në Kuran thuhet: **“Ne të shpallëm ty sikurse i patëm shpallur edhe Nuhut dhe pejgamberëve pas tij: Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve të tij, Isait, Ejubit, Junusit, Harunit, Sulejmanit, e Davudit i patëm dhënë Zeburin”.** (Nisa, 163)

Në disa shkrime të tij, dijetari shkodran Hafiz Jusuf Këlmendi (1876-1943), në lidhje me Librat e shpallur shkruan: (*The- ... qitabet jân/Pejgamberve ju ka çû - Dinin me na bâ bejân/Zoti njikshtu ka urdhnu*).² Nga këto vargje kuptohet qartë përpjekja e autorit të nderuar për të mësuar masën e gjerë se Librat e shpallur kanë

për qëllim të sqarojnë dispozitat e fesë dhe të udhëzojnë njerëzinë drejt thellimit të mëtejshëm në botën e besimit dhe shtrirjes së tij në çdo hallkë të jetës.

“**(Katër) Librat përmbajnë ligjet më të mëdha dhe më voluminoze. Ato u janë zbritur katër pejgamberëve më të mëdhenj: Teurati i zbriti Musasë (a.s.), Zeburi i ka zbritur Davudit (a.s.), Ingjilli i zbriti Isasë (a.s.). Të gjithë këta pejgamberë dhe librat e tyre kishin zbritur te populli i Izraelit. Kur ata e thyen besën me Zotin në bartjen e mësimëve të Tij, duke i lënë ato në harresë dhe nuk i komunikuan te populli i tyre, Allahu e largoi misionin e pejgamberisë nga mesi i tyre. Tani, pejgamberllëku kaloi te një popull tjetër nga pasardhësit e Ismailit (a.s.), duke mos vazhduar më te beni israilët, si pasardhës të Is'hakut (a.s.)”³**

Në lidhje me këtë, në Kuranin Famëlartë, urdhërohet: **“Ne u sollëm atyre (mekasve) një libër (Kuranin), që ua shkoqitëm në baza të diturisë e që është udhërrëfyes e mëshirë për ata që besojnë”.** (Araf, 52) Njëkohësisht, ia sqaroi profetit Muhamed (a.s.), natyrën e shpalljes me të cilën po forconte thirrjen e tij drejt besimit dhe udhëzimit hyjnor: **“Ai ta zbret ty (Muhamed) Librin me argument që është vërtetues i librave të mëparshëm. Ai e zbriti më parë Tevratin**

1. Ali Sherbexhi, “Akidetul-muslim”, botimi I, Damask, 1994, fq. 39

2. “Ilahina shqip” - Rreshtue prej Haxhi Hafiz Jusuf Këlmendit, Im - mi xhamis Perashit poshtëm, n' Shkodër, pa vit botimi, ilahija e parë, vargjet 7-8

3. Vehbi S. Gavoçi, “Degët e besimit”, Prishtinë, 2005, fq. 20

dhe Inxhilin". (Ali Imran, 3)

Besimi në këta katër libra të shpallur, pa dallim në mes tyre, është detyrim fetar për myslimanin dhe shtyllë prej shtyllave të akides islame! **Kushdo që mohon njërin prej tyre ose tallet me të, ose e nëpërkëmb atë, ka merituar zemërimin e Allahut!**⁴

PAK FJALË MBI KURANIN, LIBRIN E FUNDIT TË SHPALLUR

Duke hedhur dritë mbi mrekullinë e mrekullive, me të cilat është përkrahur Hz. Muhamedi (a.s.), Kuranin Famëlartë, dijetari i shquar islam, hoxha ynë Vehbi Sulejman Gavoçi, në një prej librave të tij thekson: "Disa shkrimtarë të huaj thonë se libri (Kurani) është i Muhamedit (a.s.), d.m.th i shpikur prej tij ose i shkruar prej tij... Ata nuk zotërojnë as gjuhën arabe, sa të shohin me sy e me ndjenja dhe të dinë të dallojnë diferencën e madhe ndërmjet stilit të haditheve, pra fjalëve të pejgamberit (a.s.), dhe atij të ajeteve të Kuranit!"⁵

Në lidhje me këtë, debati rreth "originës së Kuranit", ka bërë që gjatë historisë të ketë mendime të ndryshme dhe hipoteza teologjike që pretendojnë se Kurani është i krijuar.

Ndërkohë, ne si myslimanë, pasues të akides së "Ehli Sunneti vel-Xhemaas", e kemi për detyrë të besojmë se "**Kurani është i pastër nga "krijimi", ndryshe nga mu'tezilitët që pretendojnë krijimin e tij...**"⁶

Në lidhje me këtë, Imam Tahaviu ka pohuar: "Ai që pretendon se Kurani është fjalë e njerëzve, bën **kufër** (femohim) dhe do të ketë ndëshkimin e Allahut: "**E Unë atë do ta hedh në Sakar**". (Mudethir, 26) Pra, kur Allahu u premtoi "Sakar" atyre që thanë për Kuranin: "**Ky nuk është tjetër, përveç fjalë njerëzish!**" (Mudethir, 26), bindemi se ai (Kurani) është Fjala e Krijuesit të njerëzve, të cilit nuk i përngjet asnjë nga fjalët e njerëzve."⁷

Ndërsa Imam Bejhëkiu ka transmetuar se kur Ebu Bekri (r.a.), priti një prej delegacioneve në kohën e tij, u lexoi suren "Rrum", ndërsa ata e pyetën: "Këto janë fjalët e tua apo të shokut tënd?" Ai u tha: "Nuk është fjala ime, as e shokut tim (dmth, Resulull-llahut), por Fjala e Allahut të Madhëruar!"⁸

Shumë kohë para Tahaviut edhe Imami Ebu Hanife, së bashku me dy nxënësit e tij më të spikatur, kanë

pasur të njëjtin mendim, të përforcuar me argumente bindëse. "Është vërtetuar nga Ebu Jusufi që ka thënë: "Kam debatuar me Ebu Hanifen në çështjen e "krijimit të Kuranit". Mendimi im dhe mendimi i tij ishin njësoj, se: "**kushdo që thotë se Kurani është i krijuar, është kafir (femohues)**". Kjo fjalë është transmetuar edhe nga Muhamedi (dmth, Imam Muhamed Ibnul-Hasan Esh-Shejbani)"...⁹

Dhe realisht, stili i ajeteve të Kuranit Famëlartë dallon në mënyrë të tërësishme nga ajo e fjalëve profetike dhe e çdo fjale tjetër pos tyre. Kushdo që e njeh mirë gjuhën arabe dhe e lexon si duhet Librin e Allahut, e kupton këtë pohim të patjetërsueshëm.

Në këtë kontekst, transmetohet se një beduin dëgjoji një burrë duke lexuar ajetin 94 të sures "El-Hixhr", në të cilën thuhet: "**Ti prediko haptazi atë që të është urdhëruar dhe largohu nga idhujtarët**" dhe ra në sexhde. Kur e pyetën për veprimin e tij, tha: "Rashë në sexhde për stilin e tij të pastër gjuhësor!"¹⁰

Mënyra më e mirë për leximin, kuptimin dhe mësimin e Kuranit është mësimi i gjuhës arabe dhe thellimi në një marrëdhënie të mrekullueshme me Fjalën e Zotit, gjatë së cilës ndjen madhëstinë dhe ëmbëlsinë e çdo ajeti. Mirëpo, jo kushdo e ka mundësinë e mësimin të gjuhës së Kuranit dhe për këtë ka lindur nevoja e përkthimit të kuptimeve të Kuranit në gjuhë të ndryshme, edhe në gjuhën shqipe, ku janë realizuar mbi katër përkthime të plota të kuptimeve të ajeteve të Kuranit.

Edhe në gjuhën shqipe janë realizuar përkthime të ndryshme të kuptimeve të ajeteve të Kuranit. Në këtë kontekst, lexuesi duhet të jetë i vëmendshëm dhe të konsultohet me njerëzit e ditur të fushës, për të evituar çfarëdolloj keqinterpretimi të ajeteve dhe kuptimeve të tyre në përkthimet përkatëse. Kjo edhe për faktin se: "nëse këtyre përkthimeve të Kuranit në gjuhën shqipe ua bëjmë një vështrim dhe një kritikë të mirëfilltë shkencore edhe nga prizmi i përfilljeve shkencore, si dhe nga këndi i përgjegjësive fetare, atëherë do të gjejmë se disa prej tyre totalisht janë zhveshur nga përgjegjësia fetare islame..."¹¹

Nga kjo sitë nuk ka shpëtuar as shpëton asnjë nga përkthimet e deritanishme në gjuhën shqipe të Kuranit, megjithë redaktimet e ndryshme a ribotimet e bëra.

4. Ali Sherbexhi, "Akidetul-myslim", botimi I, Damask, 1994, fq. 41

5. Me përshtatje nga Vehbi Sulejman Gavoçi, "Pejgamberi Muhamed (a.s.)- Jeta dhe vepra", Shkup, 1994, fq. 58

6. Abdulkerim Tetan, Muhammed Edib El-Kejlani, "Sherhu xheheretit-teuhid", botimi I, Damask 1994, vëllimi I, fq. 491


7. Abdulkerim Tetan, Muhammed Edib El-Kejlani, vep. e cit., vëllimi I, fq. 491

8. Po aty, fq. 492.

9. Shih shpjegimin e Molla Ali El-Karit të "El-Fikhul-Ekber" të Imam Ebu Hanifes, botimi I, Bejrut 1995, fq. 48-49

10. Kadi Ijad, "Esh-Shifa bita'rifil hukukil-Mustafa", botimi I, Damask, 2000, fq. 322

11. Emin Behrami, "Qasje studimore rreth katër përkthimeve të Kuranit në gjuhën shqipe", Prishtinë 1997, fq. 7

A rustic wooden cabin with a gabled roof and a chimney, situated in a field of tall grass. The sky is a mix of teal and blue with scattered white clouds. The cabin has a window with a yellow object inside and a door that is slightly ajar. The overall mood is serene and contemplative.

O zemër! Je mysafire në këtë botë. Nga ke ardhur?
Ku do të shkosh? A nuk të trondit kjo pyetje ty?
Le të pyesim edhe një herë: Ku do të shkosh?

Sallh Zeki Meriç

JE MYSAFIRE NË KËTË HAN, O ZEMËR!

Ejani ta fillojmë fjalën tonë të zemrës me fjalët e një sulltani shpirtëror. Le të digjemi me një hall shpirtëror me ndjenjat më të dëlira prej brendësisë sonë pa ardhur gjë në zemër. Le t'i ndajmë ankesat që na vijnë nga zemra... Me gjithë zemër...

Hazreti Mevlana u thërret zemrave joproductive me këto fjalë zemre:

Je mysafire në këtë han, o zemër,

Gëzohu me atë që gjen, jo me atë që shpreson,

Këtu bëhet vetëm ajo që thotë i zoti i hanit,

Mos qorto asnjë, as mos u brengos...

O zemër! Je mysafire në këtë botë. Nga ke ardhur? Ku do të shkosh? A nuk të trondit kjo pyetje ty? Le të pyesim edhe një herë: Ku do të shkosh?

Nëse e di nga ke ardhur, e di edhe se ku do shkosh. Çdo njeri ka një rrugë dhe ndjek një gjurmë. Vrapon pa synim dhe pa rrugëzgjdhje. Ti je mysafire në këtë botë. Shiko rreth e rrotull si një mysafire. Shijoji si një mysafire gjërat që të dhurohen. Bëhu gati për udhëtim si një udhëtare. Udhëtimi është i gjatë dhe destinacioni është larg. Ata që ke lënë pas, nuk e ndjejnë mungesën tënde. Prandaj, mos shiko pas në këtë udhëtim. Çfarë do të çosh në destinacionin që do të shkosh? Shiko se çfarë ke në torbë. Shkatërroji muret që ke brenda, hiqi perdet dhe lidhu pas kësaj bote aq sa lidhet një udhëtar. Dije se kjo botë është e mbushur plot me kënaqësi provizore të sara-jeve prej letre. Plotësoje takimin tënd si një mysafire!

Ah sa mysafirë ka parë ky han! Të gjithë erdhën dhe shkuan. Të gjithë ishin të përkohshëm. Edhe ti je e përkohshme, o zemër! Edhe ti i ke ditët e numëruara. Do të shkosh, ku do pish sherbetin e përhershmerisë dhe do të takohesh me të Përhershmin e vërtetë. Kjo botë nuk është vendi yt. Ktheji sytë nga horizonti. Shiko, dielli i përhershmerisë është në lindje e sipër. Fillo të fluturosh nga kjo botë në botën tjetër, o zemër.

O zemër! Çfarë pret nga të tjerët? Çfarë mund të të japin të tjerët përveç vuajtjes dhe dhimbjes? Ti je e obliguar të heqësh vuajtjen që të është caktuar. A do arrish dot të japësh llogarinë e mirësive që të janë dhënë, që e mban shpresën te të tjerët? Mos shpresojë prej askujt, përveç Zotit, i cili u përgjigjet lutjeve të tua!

Kush mund të t'i lehtësojë dhimbjet? Kush mund të të japë lumturinë e shpëtimit në botën e përhershme përveç Atij? Çfarëdo që të presësh, prite nga Ai! Drejtoju Atij, kërko strehim tek Ai dhe lutju Atij, sepse dynjaja me ato që ka brenda, nuk është gjë tjetër përveçse një kupë e stolisur me diamante, por plot helm.

Falënderimi ndaj Zotit le të jetë kapitali yt më i madh, ndërsa lavdërimi i Tij, le të jetë limani yt ku strehohesh. Ndërkohë që të tjerët merren me lloj-lloj dëfrimesh ekzagjeruese të kësaj bote, në torbën tënde le të jenë hallet dhe vuajtjet me të cilat pretendon të fitosh Ahi-retin.

O zemër! Shqetësohu sa të duash! Përpëlitu sa të duash! A mund të ndryshosh ndonjë shkronjë të asaj që është caktuar për ty? Mos harro se je mysafire! Çfarëdo që të ketë caktuar i zoti i hanit, ajo do të bëhet. Merr masa dhe nënshtroju Atij! Marrja e masave le të mos e kalojë nënshttrimin tënd! Merre çdo masë, por caktimin lërja Zotit dhe mbështetu tek Ai! Thuaj si Hazreti Ibrahim (a.s.): **"Unë i jam dorëzuar Zotit të Botëve."** – dhe shpëto! Thuaj: "Çdo gjë që vjen nga Ti, është e mirë për mua. Çdo gjë që vjen, le të vijë nga Ti! Ardhhtë vuajtje apo ardhhtë gëzim, mirë se të vijë!" Lutju që të të lëshojë shiun e mëshirës dhe të të gjelbërojë nënshttrimin tënd ndaj Tij.

O zemër! Gjetshin lumturi në zemrat e tyre ata që të shikojnë! Ji pasqyrë e zemrave të pastra. Ata që vijnë tek ti, le të ndihen sikur janë në një oqean të pafund. Askujt mos ia rrudh fytyrën! Mos u prek nga askush! Mos i bëj padrejtësi askujt! Kush je ti, që mund të bësh padrejtësi? A të ka bërë qoftë edhe një herë padrejtësi Ai që të ka dhënë gjithë këto mirësi kundrejt gjithë këtyre mëkateve që ke bërë ti? A t'i ka mbyllur dyert e mëshirës kundrejt gjithë kësaj shkujdesjeje që ke shfaqur ti? A nuk i ka mbajtur gjithmonë hapur dyert e pendimit?

O zemër! Ti nuk ke të drejtë të bësh padrejtësi dhe të mërzitesh. Padrejtësia është punë e atyre që e kanë zemrën e ngurtë. Zemra besimtare duhet ta falënderojë gjithmonë Zotin (xh.xh.). Zemra gjithmonë duhet të jetë e mbushur me falënderim. Eliksiri i zemrave është djegia e tyre për shpëtimin e zemrave të tjera.

Digju o zemër, digju! Digju dhe zgjohu nga gjumi! Sigurisht se është dikush që të dëgjon dhe të kupton.

O zemër! Digju aq shumë, saqë fryma jote t'i shkrijë zemrat e ngurta! Mos u pikëllo duke e parë si hall ndarjen dhe mos u zemëro duke kundërshtuar pa pasur shkak. Pikëllimi është ilaç për zemrën. Zemra ka nevojë për vuajtje në rrugën që të shpieni te dashuria. Shpëto nga egoizmi tashmë!

O zemër! Mos u prek, mos u brengos, mos lëndo dhe mos u lëndo! Bëhu oqeani i pafund i atyre që vijnë tek ti! Bëhu ujëvarë me dashurinë që ke! Ti mund të rritesh aq sa bota që mund të fusësh brenda teje. Nëse shkon pas imagjinatave të vogla dhe dëshirave boshe, ato do të të poshtërojnë dhe nuk do të të lartësojnë.

Ah sa mysafirë ka parë ky han!
Të gjithë erdhën dhe shkuan. Të gjithë ishin të përkohshëm. Edhe ti je e përkohshme, o zemër!



Reflektim në vija të trasha shoqëruar me një rrëfim të hollë

Lëvizjet e shpejta që endin rrjetën

Edlson Çeraj

Pra, sa më e shpejtë lëvizja, aq më e sigurt bëhet rrjeta, porse vjen duke u ngushtuar deri në pamundësi për ta përballuar. Ndoshta edhe mund të përballohet, por një gjë është e sigurt: jo si njeri, jo brenda domenit të njerëzores. Askush nuk do të ecë më me hapin e jetës, madje shumë janë mërzhitur me ritmin e saj. Nuk shtyhet fare! – si nevojë për ndryshime të shpejta.

Na intereson në veçanti shpejtësia e lëvizjes, pra transporti dhe informacioni, i cili i ka dhënë dërrmën raportit tonë me dijen, pa folur për urtësinë që është bërë më e rrallë se një gur i çmuar i cili gjendet vetëm në një zonë të caktuar të planetit zakonisht një herë në shekull. Së këndejmi dhe prirja për të marrë vesh për të tjerët (ç'bëhet?, çfarë po ndodh?, si është puna? etj.) duke u kursyer sa më s'ka me veten.

Perioda e shpejtësisë, si në transport ashtu edhe në informacion, fillon me një nga esetë më të bukura të letërsisë angleze, *The English Mail-Coach* – “Karroca

postare angleze” – e Thomas De Quincey-t, i cili në vitin 1849 kishte kuptuar gjithçka dimë sot për botën e motorizuar dhe autostradat, përfshirë këtu edhe përplasjet vdekjeprurëse në shpejtësi të madhe. De Quincey përshkruan një udhëtim nate në karrocërinë e një *mail-coach*-i shumë të shpejtë përkrah një karrocieri në gjumë të thellë. Perfeksionimi teknik i mjetit dhe transformimi i drejtuesit në një objekt të verbër pa shpirt e lënë udhëtarin në mëshirën e saktësisë së pashtershme të një makine. Në mprehtësinë e ndjesive që ia ysht nga një dozë laudanumi, De Quincey arrin të kuptojë se kuajt po vrapojnë me një shpejtësi prej trembëdhjetë miljesh në orë dhe në krahun e djathtë të rrugës. Kjo do të thotë një katastrofë e sigurt, jo për *mail-coach*-in shumë të shpejtë dhe shumë të fortë, por për karrocën e parë fatkeqe që do të jetë duke përshkuar atë rrugë në drejtimin e kundërt! Në fakt, në fund të rrugës së drejtë e me pemë, që duket si korridor i një katedraleje, ai vë re një karrocë të brish-

të prej shelgu me një çift të rinjsh që po vjen me një shpejtësi prej një miljeje në orë. "Between them and eternity, to all human calculation, there is but a minute and a half" (Ata dhe përjetësinë, sipas çdo llogaritjeje njerëzore, i ndan pak a shumë një minutë e gjysmë). De Quincey lëshon një klithmë: "Mine had been the first step; the second was for the young man; the third was for God" (Unë kisha bërë hapin e parë, i dyti i takonte të riut dhe i treti Zotit).

Tregimi i këtyre pak sekondave ka mbetur i pashoq, edhe në epokën në të cilin përjetimi i shpejtësive të mëdha ka hyrë në themel të jetës njerëzore.

Glance of eye, thought of man, wing of angel, which of these had speed enough to sweep between the question and the answer, and divide the one from the other? Light does not tread upon the steps of light more indivisibly than did our all-conquering arrival upon the escaping efforts of the gig. (Një vështrim vetëtimë, një mendim, një krah engjëlli: cili do të ishte aq i shpejtë sa të futej në hapësirën midis pyetjes dhe përgjigjes, duke i ndarë njërin nga tjetra? Mbërritja jonë zap-tuese mbi karrocën që tentonte të shpëtonte ishte shumë më e shpejtë se shpejtësia me të cilën drita ndjek gjurmët e dritës.)

De Quincey arrin të japë kuptimin e një intervali kohor jashtëzakonisht të shkurtër, i cili edhe pse i shkurtër mund të përmbajë së bashku për llogaritjen e pashmangshmërisë teknike të për-plasjes dhe të së paparashikueshmes, pjesën që i takon Zotit, për të cilën të dy mjetet nuk takohen. (Calvino, 2000)

Tani le të merremi paksa me pjesën që i takon njeriut, se a po bëjmë apo jo atë që duhet për të merituar ndërhyrjen e Zotit.

Njerëzit, gjërat e gjësendet që na rrethojnë, ato që quhen ide qar-kulluese, lëvizin aq shpejt (domethënë, ndryshojnë), sa që përfundon aq beftë në bindjen se çdo gjë qëndron pezull, a më saktë, në një amulli që shpërfaqet plot larushi. Pra, të gjitha këto lëvizje/ndryshime i shkakton gjendja pezull, amullia, prej së cilës synohet dalja/arratisja.

E gjithë kjo nuk është gjë tjetër veçse pasqyrimi i botës së brendshme të qenies në kërkim të Qenësisë së humbur.

Gjendja pezull është pikërisht ajo gjendje ku qenia pëson përherë e më shumë pamundësi, që përjetohet – mbi të gjitha – së brendshmi në intervale të caktuara. Zhgënjimi i vazhdueshëm nga të ashtuquajturat lëviz-

je, ndryshime, përvoja etj., që ia behin nga hiçgjë e të çojnë (flakin?) ndër asgjëkunde të "ndryshme", e bën gjendjen pezull të bëmehet drejt trajtash të panjohura të cilat sistemojnë tëhuajësimin qenësor për të qenë sa më i qëndrueshëm. Ruajtja e kësaj qëndrueshmërie, ose e kësaj *status quo*-je, se kështu ngjan më ndjellëse, kërkon një devotshmëri sublime – domethënë, në këtë rast, të verbër – e cila manifestohet me aq sakrificë nga mëngjesi e gjer në darkë, në veçanti tek ata që kanë kaluar hallkat konvencionale të arsimimit. Janë pikërisht këta të fundit që punojnë ditë e natë (sepse *arbeit macht frei* – "puna të bën të lirë", siç shënohej në hyrje të kampit të përqendrimit në Aushvic) për të siguruar karburantin për motorin e kësaj *status quo*-je. Madje, për këtë *status quo* po punojnë në mënyrën e tyre edhe institucionet e të gjitha feve, në veçanti ato që njihen si shoqata kulturore, qytetërimore e të tjera kësodore.

Qarkullojnë ide; vijnë e shkojnë njerëz në zë e të pazëshëm; ndryshojnë e përshtaten ligje; liberalizohet e kontrollohet tregu; ushqehet sistematikisht toleranca ndërmjet feve; aplikohet shajnia e kombinimit midis traditës dhe modernes; blihen të drejtat e njeriut për të mbrojtur të drejtat e njeriut; luftohen monopolet përmes investimeve që merren nga monopolet; lehtësohet komunikimi, por nuk ka mbetur asgjë e vërtetë për t'u komunikuar; liberalizohen lëvizjet, por mungon motivi për të lëvizur; të mrekullon shija e ushqimeve dhe sidomos larmia e tyre, por sa vjen e na shtohet uria; investohet për kulturën, por ajo sa vjen e shpërfytyrohet; kemi të drejtën e informimit për çdo gjë, por nuk jemi në dijeni si duhet për asgjë; hapen dyert për t'u arsimuar të gjithë, por diplomat e marra vlejnë për t'u shënuar diku dhe për t'u prezantuar pa siklete për formimin formal; derdhen rrëke djersët për lirinë e shprehjes, nga ana tjetër rritet vetëcensura tek ata që kanë vërtet për të thënë diçka për të qenë; luftohet racizmi nga pasardhësit e atyre që i kushtuan jetën dhe veprën (shkencore) dallimeve racore e kështu me radhë e pa radhë në këso ujërash të turbullta të kohës së kafesë pa kafeinë, të fjalës pa Fjalën dhe të fesë pa fetari. Pavarësisht pra të gjitha këtyre heroizmave e veprave të mëdha revolucionare, përsëri jemi në gjendjen pezull, ose duke kërcyer me bujë nga njëra amulli te tjetra.

Një kohë kaq e prirë e kaq e përkushtuar drejt vetasgjësimimit metafizik; domethënë, qenësor.

liberalizohen
lëvizjet, por mungon
motivi për të lëvizur;
të mrekullon shija e ushqimeve
dhe sidomos larmia e tyre,
por sa vjen e na shtohet uria;
investohet për kulturën,
por ajo sa vjen e
shpërfytyrohet;



Sidubet *respektuar.* **Kurani**

Idris Arpat

Një ditë isha i ulur në pjesën e Babul-Mesxhidit, në Xhaminë e Profetit. Pak më tutje, një njeri me ngjyrë po lexonte Kuran. Nga fytyra e tij rrezatonte një nur, që padyshim i buronte nga imani, një nur që është e pamundur të përshkruhet.

Heraherës shfletonte Kuranin me një prehje dhe ngazëllim shpirtëror. Kishte kaluar thuajse një orë që po bënte këtë gjë. Iu afrova me kureshtje, për të parë se cilën sure po lexonte. Dhe ç'të shihja? Pashë që Kurani ishte mbrapsht. U habita. Ai vetëm shikonte faqet në tërësi. Pastaj mendova dhe arrita në përfundimin se Zoti i Madhëruar paska vlerësuar më shumë këtë njeri analfabet, sesa një njeri të ditur. Allahu e di, ndoshta ky njeri me ngjyrë, i mbushur me besim, ndërkohë që mbante Kuranin mbrapsht, mendonte mbi emrat e lavdishëm të Zotit të Madhëruar, mbi fuqinë e Tij, mbi mëshirën dhe dhembshurinë e Tij, ndaj dhe lexohej një nur në fytyrën e tij.

Aty gjendej edhe një personalitet i verbër, me emrin Abdullah nga Shami (emri shpirtëror i të cilit ishte Mehmed). Tetë muajt e vitit i kalonte në Medine dhe katër të tjerët në Sham. Kur qëndronte në Sham, rrinte në xhaminë pranë tyrbes së Shejhul-Ekberit Muhjiddin Arabi (kuddise sirruhu). Nuk dinte shkrim as këndim. Kur kishte qenë i ri, një natë kishte rënë të flinte dhe në mëngjes (me lejen e Allahut) ishte zgjuar hafiz i Kuranit

Famëlartë. Me siguri është nga njerëzit e përndritur. Ai mbyllte një hatme në dy ditë, në shenjë mirënjohjeje ndaj Allahut për këtë dhunti të pashoqe që i kishte dhënë. Sigurisht që ishte nga njerëzit e zgjedhur të Allahut.

Një haxhi merrte në Xhaminë e Profetit Kuranët Famëlartë, i fshinte me një leckë të pastër, i puthte dhe i vendoste duke i renditur në raftet nga i merrte. Për sa kohë qëndroi aty, bënte vetëm këtë punë. E bënte me aq sinqeritet, qetësi dhe dashuri këtë punë, sa që nuk arrita t'ia ndaja sytë.

Këtë ia tregova Ustadhit tonë të dashur. E kuptova nga gëzimi që i vezullonte në fytyrë, që e kishin gëzuar ato që i thashë, pasi ai njeri, me këtë shërbim që bënte, vetëm për arsye të respektit që i bënte Fjalës së Zotit fitonte pëlqimin e Tij.

Këta personalitete që përmenda, ishin prej atyre që kishin fituar pëlqimin e Zotit të Madhëruar, vetëm pse kishin respektuar dhe nderuar Kuranin Famëlartë.

Resulullahu, (a.s.), ka thënë:

“Më i nderuari në mesin tuaj është ai që mëson Kuran dhe që ua mëson të tjerëve atë.”

Gavsul-Adham Abdulkadir Gejlaniu, në një nga këshillat e shenjta, ka thënë:

“O njerëz! Dashurinë që keni ndaj Kuranit, tregojeni duke vepruar sipas rregullave të tij. Këshillat që merrni aty, merrini duke u bazuar në parimet e tij. Përndryshe, mos u përpiqni të hyni në diskutime mbi të (Kuranin) dhe njëkohësisht të bëni sikur keni treguar lidhjen tuaj me të apo sikur merrni këshilla prej tij. Parimet e besimit përmbajnë pak fjali. Kurse veprat përmbajnë peshën kryesore. Juve ju duhet të besoni në Kuran dhe të respektoni ligjet e tij. Miratojeni me zemër Fjalën e Allahut. Bëni vepra edhe përmes gjymtyrëve tuaja. Angazhohuni me punë, që të keni dobi në këtë botë dhe në tjetrën. Kurrë mos përgëzoni mendjet e cinguar, që janë të paafta të perceptojnë të vërtetat. Kurrë mos i dëgjoni ato.” (Fethur-Rabbani, Biseda 11)

Ebul - Mevahibi, kuddise sirruhu, ka thënë:

“Pashë në ëndërr Resulullahun, (a.s.), tek më thoshte:


- Ç’të ka ndodhur që je mbushur plot galfet? Ç’përgjumje të ka kapluar! Përse i ke kthyer shpinën Kuranit? Ç’të ndodhi, që le leximin e Fjalës së Zotit? Vallë, mendon se mund të kesh justifikim, që të lësh Kuranin pa lexuar? Mos bëj më kështu. Lexo Kuran çdo ditë, qoftë edhe vetëm dy pjesëza të vogla. Vetëm mos e ul ritmin e të lexuarit!”

Për t’u lexuar siç e meriton ky Libër i Shenjtë, pikë-sëpari duhet treguar shumë respekt, nderim dhe duhet lexuar me një qetësi dhe devotshmëri shembullore, duke i artikuluar një nga një shkronjat dhe duke e për-vetësuar gjithçka lexohet.

Në vend që të lexosh shumë Kuran pa respekt dhe me gaflet, është më mirë të lexosh pak, por i zgjuar dhe me qetësi dhe në mënyrë të vazhdueshme.

Allahu i Lartmadhërishtëm u ka dhënë disa njerëzve kohë brenda kohës, ka prej atyre që i kanë bërë hatme Kuranit në një rekat dhe ka prej atyre që kanë bërë hatme në dy rekatë. Megjithatë, këta njerëz kaq të veçantë, gjatë këndimit të Kuranit, asnjëherë s’kanë shprehur as gaflet e as hutim. E ndjejnë se zemrat i kanë pranë Zotit. Te ata kurrë nuk mungon përkushtimi ndaj fesë.

Përderisa në çdo shtëpi të myslimanëve gjendet Kurani Famëlartë, gjithmonë duhet ta respektojmë këtë libër të lartë. Duhet ta ruajmë, duke e vendosur në vendin më të lartë të bibliotekës dhe ta mbështjellim me një copë të pastër. Kur duam ta lexojmë, duhet ta hapim me një respekt të madh dhe pastaj duhet të fillojmë leximin.



DIJETARË TË ROBËRUAR PAS DYNJASË

Prof. dr. Sulejman Derin

Imam Rabbani në kryevepërn e tij të famshme “Mektubat”, nuk prek vetëm temat e mistikës, por në të njëjtën kohë prek dhe përpiqet të gjejë zgjidhje për shumë çështje që i interesojnë shoqërisë islame. Kjo vepër nuk u drejtohet vetëm njerëzve të ditur, por edhe popullit.

Siç dihet, feja islame i jep një rëndësi të madhe diturisë dhe shkencës. Nga hadithet e Pejgamberit (a.s.), informohemi se boja e penës së dijetarit është më e shtrejtë se gjaku i martirit dhe humbja nga vdekja e një dijetari është si humbja e tërë njerëzimit. Dijetarët janë elementi më i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për përhapjen e fjalës së Allahut, por në të njëjtën kohë ndonjëherë janë përgjegjësit kryesorë për dëmet që mund t’i vinë fesë. Sidomos dijetarët që nuk e kanë pastruar zemrën nga dashuria e kësaj bote dhe vazhdimisht punojnë për përfitimet e kësaj bote, janë duke i shkaktuar dëme të mëdha kësaj feje.

Dashuria dhe dhënia e dijetarëve pas botës qëndron si një njollë e zezë në fytyrat e tyre të bukura.

Dituria e dijetarëve të tillë mund të jetë e dobishme për njerëzit, por ajo nuk i jep asnjë dobi zotëruesit të saj. Ata mund të kontribuojnë për forcimin dhe përhapjen e Islamit, mirëpo ndonjëherë këtë gjë e bëjnë edhe të shthururit dhe jobesimtarët. Ashtu siç na informon vetë Pejgamberi (a.s.), në një hadith: *“Allahu do ta lartësojë këtë fe, qoftë edhe përmes njerëzve të shthurur.”* (33. Mektub)

Sipas Imam Rabbanit, dijetarët që e përdorin diturinë për përfitime materiale janë në një humbje të madhe, sepse dijetarë të tillë, për të siguruar përfitime, e interpretojnë fenë sipas egos së tyre. Kështu, në vend që t’i shërbejnë fesë, u shërbejnë interesave të veta. Imam Rabbani në formë kritike për ta thotë:

“Ata janë si guri i çakmakut. Në gurin e çakmakut ka energji. Njerëzit përfitojnë nga kjo energji duke ndezur zjarr, kurse guri nuk përfiton asgjë nga zjarri që ndez. E njëjta gjë ndodh edhe me dijetarët e pasinqertë, të cilët nuk përfitojnë asgjë nga dituria që zotërojnë. Madje kjo dituri, shpesh është e dëmshme

dhe kundër tyre. Sepse në Ditën e Gjykimit, nëse i padituri do të mund të justifikohet duke thënë se nuk e dinte, dijetarët nuk kanë asnjë mundësi për një alibi të tillë." Hadithi profetik në lidhje me këtë thotë: "Në Ditën e Gjykimit, dënimin më të ashpër do ta ketë dijetari që nuk ka përfituar nga dituria e vet."

Kurse shkakun se përse është mëkat i madh përdorimi i diturisë për përfitime materiale, Imam Rabbani e tregon kështu: "Si mund të mos jetë mëkat i madh përdorimi i diturisë për përfitime materiale? Dituria ka një vlerë të paçmuar tek Allahu. Si mundet atëherë një dijetar i fesë ta përdorë diturinë për pasuri, famë dhe interesa të ulëta materiale? Dhënia pas kësaj bote është diçka e urryer nga Allahu. Atëherë, të shpenzosh diçka që Allahu e ka vlerësuar për të përfituar diçka që Ai e ka urryer, është një veprim shumë i ulët. Është nënçmim për atë që ka vlerësuar Allahu dhe vlerësim për atë që ka nënvlerësuar Allahu. Thënë shkurt, kjo është të marrësh qëndrim kundër Zotit tënd. Dituria, mësimi, ligjërata, shkrimi janë të mira kur bëhen për hir të Allahut. Nëse dituria nuk përdoret për përfitime dhe interesa të kësaj bote, dobia e saj është e pallogaritshme për zotëruesin. Shenjë e dijetarit të sinqertë është mosdhënia pas kësaj bote."

Sipas Imam Rabbanit, dijetari që ka në zemër këtë botë, në fakt nuk është dijetar i fesë. Sipas tij, ata janë vjedhës të thesarit fetar. "Dijetarët që janë dhënë pas kësaj bote, në të vërtetë nuk janë dijetarë të fesë, por dijetarë të pasurisë. Dijetarë të tillë janë vjedhës të paskrupullit të imanit." Ajeti Kuranor: "**Ditën, kur Allahu t'i ringjallë të gjithë, ata do t'i betohen Atij, ashtu siç të betohen ty tani, duke menduar se kjo do t'u sjellë dobi. Në të vërtetë, pikërisht ata janë gënjeshtarët! Ata i ka vënë poshtë djalli dhe i ka bërë që të harrojnë përmendjen e Allahut. Ata janë pala e djallit; në të vërtetë, pala e djallit janë humbësit.**" (Muxhadele, 18-19.), bën përkufizimin më të mirë të këtij lloji dijetari.

Detyra kryesore e dijetarëve të fesë është zbatimi i fesë dhe udhëzimi i njerëzve në çështjet fetare. Mirëpo, dijetarët e këqinj përpiqen të gjejnë mënyra për t'i larguar njerëzit nga feja. Në realitet, largimi dhe

ftohja e njerëzve prej fesë është për shkak të fjalëve, shkrimeve dhe qëllimeve të këqija të dijetarëve.

Dijetarët që duhet t'u qëndrojnë përballë këtyre, janë dijetarët e vërtetë të fesë. Dijetarët e vërtetë të fesë janë ata që e kanë pastruar zemrën nga ndotjet e kësaj bote, si: pasuria, pozita dhe fama. Këta janë dijetarët që Pejgamberi (a.s.), i ka shpallur si trashëgimtarët e pejgamberëve. Këta janë dijetarët, boja e penës e të cilëve është më e rëndë në peshoren hyjnore se gjaku i martirëve të rënë në rrugën e Allahut. Këta janë dijetarët, gjumi i të cilëve është adhurim. Janë pikërisht këta dijetarë, që në zemrat e tyre kanë vetëm Ahiretin. Këta kanë arritur ta kuptojnë natyrën mashtruese të kësaj bote. Prandaj nuk jepen pas gjërave të përkohshme dhe kalimtare, por fokusohen vetëm tek e përhershëmja dhe e amëshueshmja.

Por, nëse dijetarët interesohen për pasuritë e kësaj bote, jo për vete, por për të mirën e umetit, atëherë kjo është e lejueshme. Siç thotë edhe Rumi: "Pasuria e dijetarit që nuk pengon zemrën nga ibadeti ndaj Allahut, është një mirësi e madhe në shërbim të Islamit." Por fatkeqësisht numri i këtyre dijetarëve është shumë i vogël.

Disa dijetarë, të cilët duket sikur janë dhënë pas pasurisë së kësaj bote, i kanë zemrat e tyre të zbrazura nga çdo shenjë dashurie për të, qëllimi i tyre është harxhimi i saj në rrugë të Allahut. Ajeti Kuranor: "**Ata shitblerja nuk i pengon nga përmendja e Allahut**" (Nur, 37.), bën fjalë pikërisht për këtë lloj dijetarësh.

Sot njerëzimi ka më shumë se kurrë nevojë për dijetarë altruistë dhe sakrifikues. Duke qenë se ngritja dhe rënia e Islamit është në dorë të dijetarëve, besimtarët që arsimohen në fushën e fesë duhet t'i shërbejnë kësaj feje me gjithë qenien e tyre, ashtu si sahabët, pa e prekuar aspak zemrën për pasuritë e kësaj bote. Nëse dijetarët islamë nuk sakrifikojnë dot as sa dijetarët e feve të devijuara, atëherë në mënyrë emergjente duhet kërkuar rruga për të shpëtuar nga kjo amulli dhe neglizhencë. Allahu i jep rrizk dijetarit të vërtetë të fesë andej nga ai nuk e imagjnon dot. Prandaj është shumë gabim të luash me urdhëresat fetare nga frika e varfërisë.

Ata janë si guri i çakmakut.
Në gurin e çakmakut ka energji.
Njerëzit përfitojnë nga kjo energji
duke ndezur zjarr,
kurse guri nuk përfiton asgjë
nga zjarri që ndez.
E njëjta gjë ndodh edhe me
dijetarët e pasinqertë, të cilët nuk
përfitojnë asgjë nga dituria
që zotërojnë.

MERITOKRACIA


Dimensioni i reformave apo kamuflim?

Nuredin Nazarko

Rotacionet qeverisëse shoqërohen gjithmonë me pritshmëri të lartë në korrigjimin dhe përmirësimin e funksionimit të sistemit të qeverisjes. Kjo pritshmëri është rezultat i situatave të vështira ekonomiko-sociale nëpër të cilat kalon një vend i caktuar, si rezultat i kursit të ndjekur nga grupimi politik që ka në dorë qeverisjen apo dhe si rrjedhojë e influencës së vështirësive që përjetojnë ekonomitë e shteteve me të cilat është e lidhur ekonomia e këtij vendi. Situatat e vështira politiko-ekonomiko-sociale kanë qenë, janë dhe do të mbeten terren i favorshëm për pritshmëri të larta në rastin e rotacionit të qeverisjes. Çdo qeverisje, ka mangësitë e saj, të cilat janë prezente për shkak të mangësive që vetë natyra njerëzore ka në vetvete. Mangësitë që shfaqin grupimet politike, qofshin në pushtet ose jo, shërbejnë si opsion favorizues për grupimin politik që synon të mbajë apo të arrijë qeverisjen e vendit. Kjo për arsye, sepse përgjegjësitë për mirëecurinë apo keqecurinë e qeverisjes bien drejtpërsëdrejti mbi grupimin politik që drejton shtetin. Kësisoj grupimi politik që kërkon të marrë pushtetin mbetet të jetë më i favorizuar në situatat e vështira politiko-ekonomiko-sociale, në rast se grupimi politik që ka pushtetin nuk arrin të sigurojë një përmirësim të prekshëm të situatës politiko-ekonomiko-sociale nga shumica e shoqërisë. Grupimi politik që kërkon të marrë pushtetin, i favorizuar nga situatat e vështira dhe dëshira e masave për ndryshime në mënyrën e të qeverisurit, do të jetë në pushtet të nesërmen. Grupimi politik që do të ngjitet në pushtet do të përballet me përgjegjësinë e realizimit të pritshmërive të masës së njerëzve. Një ndër shumë pritshmëritë, në mos më e rëndësishmja, që masa e njerëzve pret të realizohet është, pa as më të vogël diskutim, meritokracia, në të cilën njerëzit kanë fuqi apo dhe pushtet, si rezultat i aftësive dhe mundësive të tyre

profesioniste dhe jo si rezultat i parave apo pozitës së tyre shoqërore. Kësisoj, meritokracia do të thotë që njeriu të vlerësohet për shkak të vlerave që mbart njeriu-personalitet dhe ky vlerësim të përkthehet në rekrutim si nëpunës administrate që nga nivelet më të ulëta e deri në ato më të larta, qoftë në sektorin publik apo privat. Bashkë me rotacionin qeverisës njerëzit presin se çfarë do të ndodhë, çfarë do të bëhet? A do të realizohen premtimet e bëra për ndryshime pozitive apo gjërat do të vazhdojnë të rrjedhin në të njëjtën hulli, në mos edhe më tatëpjetë? Në këtë gjendje pezullie nënshtetasit presin reformat që do të kryhen, madje për të qenë më të saktë, mënyrën sesi do të kryhen reformat. Dëshira e çdo qeverie rishtarë ose jo për të realizuar reforma është relevante. Por realizmi i mirëqenë i reformave nuk varet as nga dëshira e mirë dhe as nga artikulumet zbukuronjëse gjuhësore mbi atë që pritet të ndodhë me realizmin e reformave. Thuhet se fillpërshkuesi i gjithë reformave që do të kryhen, do të jetë meritokracia. Një pjesë janë skeptikë e një pjesë janë të prirur të besojnë pa kushte që kjo do të

n d o -



dhë. Etja për të parë një grintë ndryshe në qeverisjen e vendit, i lëshon pe arsyetimit dhe analitikës. E megjithatë, të gjithë e dëshirojnë meritokracinë, si një element bazik, pa të cilin reformat e kryera do të shkojnë në pritshmërinë e masës, për ndryshime pozitive në mënyrën e të qeverisurit dhe për rrjedhojë zbulimin ashiqare të mashtrimit kolektiv nga demagogjia e radhës. Natyrisht që nuk është aspak e lehtë, por jo dhe e pamundur, të përpiqesh që reformat e ndërmarra t'i vendosësh në binarët e meritokracisë në një shtet, i

cili ka një historik të hidhur për sa i takon raportit midis meritokracisë dhe nomenklaturës. Qysh nga qershori i vitit 1924 e këndej, çdoherë që në Shqipëri kanë ndodhur ndryshime në grupimet politike që kanë marrë në dorë pushtetin, po aq herë është përdorur meritokracia si kamuflim i kriterit politik për nëpunësit administrativë. Përzgjedhja dhe katapultimi i nëpunësve administrativë, duke përdorur kriterin politik si dhe nepotizmin e patronazhin, ka rrjedhur me keqfunksionimin apo me një funksionim të çalë dhe tërësisht të nënshtruar ndaj grupimit politik që ka pasur

pushtetin, të administratës shtetërore. Aftësitë dhe profesionaliteti i njeriut – personaliteti në të tilla administrata u nënshtrohet tekave dhe dëshirave të të emëruarve politikisht, mbi të cilët kriteri i vetëm që aplikohet është devotshmëria ndaj grupimit politik në të cilin bën pjesë. A do të mund të shkëputen vallë reformat nga "meritokraci" të tipit, ke dalë i pari, por shefi i dikasterit ka të drejtë eskluzive të zgjedhë një nga tre të parët? A do të mund të kthehen institucionet e punësimit të nëpunësve në institucione serioze dhe profesionale apo premtimet për meritokraci do të kthehen në profka dhe shashka tymuese? A do të mund të shkëputemi nga dirigjimi i institucioneve me formula të tipit "është urdhër nga lart", "e vendos i pari"? A do të mund të respektohet plotësisht aftësia dhe profesionalizmi i njeriut- personalitet për të përfunduar aty ku e meriton, pavarësisht përkatësisë politike, sociale, etnike, religjioze, racore apo meritokracia do të vazhdojë të përdoret si element kamuflimi i reformave, ku të punësuarit do të jenë sërishmi të përzgjedhur sipas devotshmërisë politike? Koha është gjykatësi i paanshëm për vërtetësinë apo demagogjinë e premtimeve për meritokraci dhe ne jemi të detyruar ta dëgjojmë verdiktin e këtij gjykatësi, përgjatë rrjedhës së vet. Ta dëgjojmë dhe të reflektojmë!



Ukkashe ibn Mihsani

- radijallahu anhu -

Kalorësi më i mirë

Mustafa Erish

Ukkashe ibn Mihsani, radijallahu anhu, është një sahab që fitoi lavdërimin e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem. Për të Profeti (a.s.), ka thënë: "Kalorësi më i mirë!.."

Ai ishte një djalë i ri, i cili i shfrytëzonte mundësitë që i jepeshin, i kujdesshëm, i zgjuar dhe trim!..

Ai ishte një hero që printe përpara pa u trembur syri në fushën e luftës dhe binte në sy me lëvizjet e tij të shpejta!..

Ishte një trim që njihej si "njeriu më i bukur" për shkak të fytyrës së hijshme dhe moralit të lartë që kishte!..

Lindi dhe u rrit në Mekë. I përkiste fisit Beni Esed. Në moshën njëzetvjeçare, mësoi fshehurazi për Islam. Bashkë me vëllain e tij, Ebu Sinanin iu dorëzuan të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, dhe u bënë myslimanë.

Ai nuk u nda kurrë nga Hazreti Pejgamberi, alejhi's-salam. Qëndroi në shtëpinë e Erkamit. Fali namaz bashkë me të Dërguarin e Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, mësoi shpalljen duke ndjekur me kujdes ajetet kurane. Ua shpjegoi Islamit të afërmve të tij dhe u përpoq që ata të bëheshin myslimanë. Motra e tij, Ummu Kajsi, radijallahu anha, e pranoi Islamit nëpërmjet tij.

Politeistët mekas, nuk arrinin ta pranonin dot faktin se një djalosh i ri dhe i pashëm si Ukkashe, radijallahu anhu, ishte bërë mysliman. Ata u përpoqën ta nxirrnin nga feja, duke i bërë presion dhe duke e torturuar, por nuk arritën të kishin sukses. Ai nuk bëri lëshim nga besimi i tij dhe nuk e braktisi kurr atë.

Kur në Mekë u shtuan vuajtjet, presionet, padrejtësi-

të dhe torturat, Ukkashe ibn Mihsani, radijallahu anhu, bashkë me Abdullah ibn Xhahshin, radijallahu anhu, i cili ishte prej fisit të tij, u shpërngulën në Medine.

Kur u bë xhamia, qëndroi në Suffe dhe vazhdoi të mësojë dije e urtësi nga i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem.

Politeistët mekas nuk i lanë rehat myslimanët edhe në Medine. Atyre u hapën luftë për ta zhdukur Islamit nga faja e dheut. Pasi Allahu i Madhëruar dha leje për xhihad, filluan luftërat.

Ukkashe ibn Mihsani, radijallahu anhu, mori pjesë në të gjitha luftërat me në krye Bedrin, Uhudin dhe Hendekun. (el-Istiaab, III, 1080.)

Ai mori pjesë në operacionin e Abdullah ibn Xhahshit, i cili ishte i pari. Aty shfaqti sjellje të zgjuara dhe të mençura. Këto sjellje të tij, tregohen kështu:

"I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, në muajin Rexhep, një vit e gjysmë pas hixhretit, dërgoi një grup prej dymbëdhjetë vetash në vendin e quajtur Batn en-Nahle për të ndjekur karvanin e kurejshëve.

Karvani ishte ndalur dhe po pushonte. Kur panë myslimanët, menjëherë filluan të mblidheshin. Ukkashe ibn Mihsani, radijallahu anhu, menjëherë e qethi kokën për të mos i trembur dhe shkoi tek ata.

Kur njerëzit e karvanit e panë Ukkashen, radijallahu anhu, në këtë gjendje, u qetësuan duke menduar se ata kishin ardhur për të bërë umre.

Sahabët përfituan nga qetësimi i atyre. Në këtë mënyrë, e sulmuan karvanin, i kapën robër dhe u kthyen në Medine. Ndërsa Abdullah ibn Hadramin, i cili u përpoq



të arratisesh nga karvani, e vranë. Ky ishte operacioni i parë, përplasja e parë dhe njeriu i parë që vranë myslimanët.” (Bejhaki, Delail, III, 17-21; Ibn Sa'd, II, 10.)

Ukkashe ibn Mihsani, radijallahu anhu, ishte një trim guximtar dhe i patrembur. Në luftën e Bedrit pati shfaqur heroizëm të madh me degën e hurmës që kishte në dorë. Ai e tregon kështu këtë ditë:

“U zhyta në mes të rreshtave të armiqve dhe e hidhja në tokë këdo që më dilte përpara. Befas, m'u thye shpata. Menjëherë shkova te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, dhe i tregova për gjendjen time. Hazreti Pejgamberi, alejhi's-selam, më dha një degë hurme dhe më tha: “Lufto me këtë, o Ukkashe!”

Unë nuk hezitova aspak. E mora degën e hurmës dhe u ktheva në fushën e betejës. Dega që kisha në dorë, u shndërrua në një shpatë të fortë dhe të bardhë. Unë luftova me këtë shpatë derisa i mposhtëm politeistët mekas.” (Ibn Kethir, el-Bidaje ve'n-Nihaje, III, 291; Usdu'l-Gabe, IV, 64.)

Një ditë, kur Dërguari i Allahut (s.a.s.), po qëndronte me sahabët, u kujtoi atyre këtë heroizëm të Ukkashes (r.a.) dhe u tha: “Kalarësi më i mirë është i yni.” Sahabët e nderuar e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! Kush është ai?” Hz. Pejgamberi (a.s.), u përgjigj: “Ai është Ukkashe ibn Mihsani.”

Ukkashe ibn Mihsani, radijallahu anhu, ishte komandant edhe në operacionin e Gamres. Ishte viti i gjashtë i hixhretit. Myslimanët kishin marrë lajmin se Beni Esedët do t'i sulmonin.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, përgatiti një njësi ushtarake prej dyzet vetash nën komandën e Ukkashe ibn Mihsanit, radijallahu anhu, dhe e dërgoi në Gamre, pra në vendin ku banonin Beni Esedët. Ata u kthyen në Medine me disa robër prej tyre dhe me dyqind deve si plaçkë lufte.

Ai ishte shumë i mençur, trim dhe i kujdesshëm. I shfrytëzonte shumë mirë mundësitë që i jepeshin. Mbështetej jashtë mase te Allahu i Madhëruar. Sjelljet e tij të zgjuara dhe të kujdesshme, shihen qartë në këtë hadith fisnik:

“Një ditë, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, njoftoi se Allahu i Lartësuar do t'i mbrojë në dynja e në ahiret dhe do t'i fusë në xhenet pa llogari dhe pa i ndëshkuar ata që i mbështeten Atij. Pastaj tha:

“M'u shfaqën popujt e kaluar. Pashë pejgamber që kishte pranë një grup të vogël katër-pesë vetash. Pashë pejgamber që pranë tij kishte vetëm një njeri. Pashë edhe pejgamber, që nuk kishte pranë asnjë. Në ato momente, përpara më doli një grup i madh njerëzish.

Mendova se ishte umeti im. Më thanë: ‘Ky është umeti i Musait (a.s.). Ti shiko në horizont!’ Hodha shikimin lart dhe pashë një njollë të zezë shumë të madhe. Më thanë: ‘Ja, ky është umeti yt. Ndërmjet tyre ka shtatëdhjetë mijë vetë, që do hyjnë në xhenet pa dhënë llogari dhe pa u ndëshkuar.’

Ibn Abbasi, radijallahu anhu, thotë: “Pasi e tha këtë, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u ngrit dhe shkoi në shtëpi. Sahabët që ndodheshin aty, filluan të flisnin se kush mund të ishin këta shtatëdhjetë mijë njerëz.

Disa thoshin: Këta duhet të jenë njerëzit që kanë marrë pjesë në kuvendet e Hz. Pejgamberit. Disa të tjerë, thoshin: Këta janë ata njerëz që kanë lindur pasi ka ardhur Islami dhe nuk e kanë përjetuar shirkun. Ndërkohë që ata po diskutonin rreth kësaj çështjeje, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, erdhi aty. Sahabët e nderuar i thanë:

“Po flasim rreth çështjes se kush janë ata që do hyjnë në xhenet pa dhënë llogari dhe pa u ndëshkuar.”

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u tha:

“Ata janë njerëz që nuk bëjnë magji dhe nuk urdhërojnë të bëhet diçka e tillë, që nuk i besojnë fatit të keq dhe i mbështeten Zotit.”

Pasi Ukkashe ibn Mihsan e dëgjoi këtë, menjëherë u hodh nga vendi i tij dhe tha:

“Lute Allahun të më bëjë mua prej tyre, o i Dërguari i Allahut!”

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, tha:

“Ti je prej tyre!”

Pastaj u ngrit edhe një sahab tjetër dhe tha:

“Lutu që edhe mua të më bëjë prej tyre, o i Dërguari i Allahut!” Hazreti Pejgamberi (s.a.s.), këtë radhë tha:

Ukkashe u tregua më i shpejtë se ti për ta shfrytëzuar këtë mundësi. Ukkashe ta kaloi në këtë çështje. (Muslim, Iman, 374; Buhari, Rikak, 50.)

Në periudhën e hilafetit të Hazreti Ebu Bekrit, radijallahu anhu, në vitin e dymbëdhjetë të hixhretit, nën komandën e Halid ibn Velidit, radijallahu anhu, u dërgua një ushtri në Tuhejla, sepse banorët e këtij vendi e kishin lënë fenë. Edhe Ukkashe ibn Mihsani, radijallahu anhu, gjendej në këtë ushtri.

Ai, bashkë me Thabit ibn Erkamin, radijallahu anhu, ishin dërguar si forcë zbuluese te armiku. Kur u fut në sulm për t'iu afruar Tuhejlës, ra dëshmor në moshën dyzet e katër vjeç. (Usdu'l-Gabe, IV, 64.)

Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Ai ishte një djalë i ri, i cili i shfrytëzonte mundësitë që i jepeshin, i kujdesshëm, i zgjuar dhe trim!..

KULTURA POPULI

Prof. dr. Mehmet Gërmez

Me përpahjen e gjerë të mjeteve të komunikimit masiv në periudhën moderne, kultura populiste e cila ka përfshirë nën ndikimin e saj pothuajse çdo anë të jetës sonë, po zaptin gjithnjë e më tepër mendimin, shpirtin dhe personalitetin tonë. Kultura populiste nuk po mjaftohet vetëm me pushtimin, por po i shndërron vlerat tona materiale dhe shpirtërore një e nga një në material konsumi. Duke u bërë tërheqëse për masën, kultura populiste ka filluar të krijojë hartën e vet të shenjtë. Sot mund të flasim për një degjenerim serioz të përfutur nga ndikimi i popularizmit, duke filluar nga mënyra e ngrënies, pirjes, veshjes, përshendetjes, urimeve, fejesës, martesës, komunikimit, muzikës, artit etj.

Individi i mbetur nën ndikimin e kulturës populiste, për të vazhduar ekzistencën ose për të fituar status në shoqëri është i detyruar të shndërrohet në objekt të kësaj kulture ose për të mos u përjashtuar nga shoqëria, është i detyruar të jetë i informuar rreth elementeve të kësaj kulture.

Kultura populiste, e cila zotëron aftësinë për të ndikuar në një kohë mjaft të shkurtër mbi shoqërinë, fatkeqësisht është shndërruar sot në mjetin më të rëndësishëm të ekspansionit kulturor. Kjo kulturë po

përdoret si mënyra më e shkurtër dhe e shpejtë për ta zhveshur shoqërinë nga vlerat dhe kultura e vet tradicionale. Kjo kulturë shfaqet duke krijuar dëshira të përkohshme, që tërheqin interesin e shoqërisë, pastaj zhduket duke u konsumuar në mënyrë të pavetëdijshme nga populli. Megjithëse kultura populiste shfaqet si një dukuri e preferuar nga populli, ajo nuk mbështet në asnjë vlerë.

Kultura populiste është e fokusuar kryesisht te rinia, sepse ajo është më e gatshme për t'u përshtatur me gjendjet e reja dhe përvetësuar vlerat e kulturave të ndryshme. Duke qenë e mbushur me ndjenja, energji, dëshira, pasione dhe emocione të larta, rinia bëhet shpejt pre e rrjetës së kulturës populiste.

Të gjitha identitetet e rreme, heronjtë e rremë, bota dhe imazhet shumëngjyrëshe që u serviren si modele të rinjve, të cilët janë akoma në periudhën e njohjes së vetvetes, inkurajojnë kulturën populiste. Në ndikimin e kulturës populiste, rinia alienizohet nga shoqëria ku jeton, duke u përballur kështu me kriza identiteti dhe brezash. Si përfundim, na shfaqet një rini e shkëputur nga familja dhe vlerat fetaro-shpirtërore, e privuar nga qëllimet dhe idealet e larta dhe e zhytur pas pasioneve, dëshirave dhe epsheve. Edhe pse mund të shpëtojnë në

LISTE DHE RINIA

planin material, në planin shpirtëror dëmet janë bërë pothuajse të pandreqshme. Prandaj është detyrë e çdo myslimani t'i ofrojë rinisë një jetë konform vlerave fetare.

Rinia duhet të edukohet me vlerat e dashurisë, respektit, dinjitetit, punës, sakrificës, nderit, diturisë dhe guximit. Ata nuk duhet të jenë pararojë në shkatërrimin e vlerave, por në ruajtjen dhe mbajtjen gjallë të tyre. Të rinjtë duhet të jenë ushtarët pararendës të kauzës islame në gjithë botën. Vetëm në këtë mënyrë mund të dalin personalitete të mëdha të përmasave botërore. Kjo kulturë mund të prodhojë profesionistë, por nuk mund të prodhojë personalite që të marrin përsipër problemet e shoqërisë.

Rinia duhet t'i marrë vlerat nga Kurani dhe jeta model e Pejgamberit (a.s.). Ata duhet të zënë një vend shumë të rëndësishëm në botën e Pejgamberit tonë të dashur. Pejgamberi (a.s.), gjithmonë ka krijuar një lidhje të sinqertë dhe të veçantë me të rinjtë. Ai është interesuar në mënyrë të veçantë për edukimin e rinisë dhe shkolla ku u edukuan këtë të rinj nxori njerëz që udhëhoqën botën drejt dritës hyjnore. Ata morën përgjegjësi të mëdha në administratë, ushtri, arsim, tregti etj.

Personalitete të tilla, si: Ebu Hurejra, Abdullah ibn Omer, Adullah ibn Mesur, Abdullah ibn Abbas, Muadh ibn Xhebel, Enes ibn Malik (r.anhuma), e shumë të tjerë

që u edukuan nën kujdesin e Pejgamberit (a.s.), janë shembuj model të kontributit në ndërtimin e qytetërimit dhe kulturës islame në botë.

Natyrisht që rinia ka problemet e veta karakteristike për periudhën e saj. Periudha e rinisë është një periudhë ku fuqia dhe entuziazmi janë në kulmin e tyre. Po t'u shtosh këtyre dy elementeve edhe mungesën e përvojës, atëherë rreziku për të hyrë në qorrsoke është shumë i madh. Përgjegjësia për t'i ndihmuar ata të shikojnë gabimet, është e të rriturve, e prindërve, e mësuesve, e hoxhallarëve etj. Në të njëjtën kohë, është shumë e rëndësishme që rinia në këtë periudhë të orientohet në respektimin e urdhëresave dhe ndalesave fetare. Pejgamberi (a.s.), i ka siguruar të riut që ruhet nga harami hije nën arshin e Allahut në Ditën e Gjykit. Prezantimi i ibadetit si një nga shkaqet kryesore në përfshirjen e rinisë në grupin që do të jetë nën hijen e arshit të Allahut, tregon rolin e ibadetit në ruajtjen e rinisë nga dënimi hyjnor dhe rëndësinë e një rinie të pastër, që qëndron larg haremeve, për të ndërtuar një shoqëri të pastër dhe të shëndoshë.

Dëshira jonë më e madhe është edukimi i një rinie të vetëdijshme dhe të gatshme për të marrë mbi supe përgjegjësitë e së ardhmes dhe për të ndërtuar botën sipas vlerave hyjnore. Një rini që do të jetë model për botën islame në veçanti dhe për të gjithë botën në përgjithësi...





Sulbe të zgjedhura

Ferit Piku

Shoqëria E MIRË

Profeti Muhamed (a.s.), ka thënë: “Njeriu është në fenë e shokut të tij, prandaj le të shikojë se kë ka për shok”¹.

Sado i aftë të jetë njeriu, sado i pasur apo i zgjuar të jetë, ai ka nevojë për shokë, për miq e për shoqëri. Ka nevojë për shokë që këshillojnë, për miq që e ndihmojnë, për shoqëri që i gjendet pranë kur ka nevojë. Njeriu nuk jeton dot i vetëm. Prandaj thonë që dënimi më i madh, që mund t’i bësh ndonjë njeriu, është ta izolosh atë.

Njeriu në gjuhën arabe quhet *insan* dhe kuptimi i kësaj fjalë është i *shoqërueshëm*. Madje, as shejtani nuk rri dot vetëm. Kur Allahu (xh.sh.), e mallkoi atë dhe e caktoi të ishte nga banorët e xhehenemit, ai tha: “O Zot, më lër të bëj shokë në dynja dhe në ahiret.” Allahu (xh.sh.), i tha: **“Ti do të bësh shumë shokë, përveç besimtarëve, sepse ata nuk mund t’i kesh shokë.”** (Hixhr, 42). Shejtani i devijon shokët e tij në këtë dynja dhe i ka bashkëvuajtës të tij në zjarrin e xhehenemit.

Ne nuk do të flasim për shoqërinë në përgjithësi, se askush nuk është i vetëm në këtë botë, por duam të flasim për shoqërinë e mirë, për ndikimin e saj, për këtë dhunti të Allahut (xh.sh.).

A e ndjejmë këtë dhuatë që na ka dhënë Zoti i gjithësisë? Flasim për këtë shoqëri, se për këtë u lut Ademi (a.s.), edhe pse Zoti e krijoi në mes të xhenetit. Thonë se Ademi e ndjeu veten të mangët, e ndjeu veten bosh dhe iu lut Allahut (xh.sh.), t’i bëjë një shok, t’i bëjë një shoqëruar dhe Allahu i bëri bashkëshortin e tij, Havanë.

Për shoqërinë e mirë u lut Musai (a.s.), kur Zoti e dërgoi te faraoni. Musai (a.s.), tha: **“O Zot, unë jam i**

vetëm, më mundëso që të kem një shok me vete”.

Atëherë Allahu (xh.sh.), i dha Harunin (a.s.).

Për shoqërinë e mirë u lut profeti Muhamed (a.s.) dhe Allahu (xh.sh.), i dha shumë shokë e më të mirët prej tyre ishin Ebu Bekri (r.a.) dhe Omeri (r.a.). Ai i përqaftonte ata të dy, vinte njërin dorë mbi supin e njërit dhe dorën tjetër tek supi i tjetrit dhe thoshte: **“Kështu siç na ka bashkuar Allahu në dynja, kështu do të ringjallemi në jetën tjetër”**.²

Për këtë shoqëri lutemi edhe ne, pavarësisht se ndoshta nuk e ndjejmë diçka të tillë, por për çdo namaz ne themi: “Ihdinas Siratal mustekim – na udhëzo ne në rrugën e drejtë”. Po kush është **“Ne”**, sepse ndodh që ti falesh i vetëm? Ata janë të gjithë myslimanët. Feja nuk shijohet pa shokë, dynjaja nuk shijohet pa shokë, madje edhe xheneti nuk shijohet pa shokë.

Shoqëria ndikon shumë te njeriu. Për këtë mjafton të pyesim ata prindër, fëmijët e të cilëve kanë marrë rrugën e së keqes, rrugën e drogës, prostitucionit e alkoolit. Pjesa më e madhe e këtyre prindërve thonë: “Vallahi e kam pasur djalin shumë të mirë, por e prishi shoqëria”. Kjo është e vërtetë, pasi pjesën më të madhe të njerëzve i prish shoqëria e keqe. Nëse do të bësh mirë në një shoqëri të tillë, nuk të lënë shokët. Nëse do të ikësh, përsëri nuk të lënë shokët e kështu me radhë.

Nga ana tjetër edhe shoqëria e mirë ndikon për mirë. Pyeti ata njerëz, që Zoti ua hapi zemrën, pasi e kishin të mbyllur, ua hapi sytë, pasi ishin të verbër, i nxori në jetë, pasi ishin drejt vdekjes. Do të shikosh se këta njerëz e

1. **Hadith i pranuar.** Ebu Daudi (4833) dhe Tirmidhiu (2378). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të pranuar.

2. **Hadith i dobët.** Tirmidhiu (3669) dhe Ibn Maxheh (99). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të dobët.

falënderojnë Allahun (xh.sh.), që u ka dhënë shokë të mirë, të cilët i kanë mbajtur për krahu dhe nuk i kanë lënë të rrëzohen poshtë. Të gjithë kemi qenë gabimtarë, por Allahu (xh.sh.), na dha shokë të mirë, të cilët u bënë sebeb që ne të afrohemi te madhështia e Zotit dhe t'u largohemi gjynaheve.

Dikush vrau 100 vetë, por u pendua dhe kërkoi këshillën e një njeriu të mirë. Dikush i tha: "Mos rri në këtë vend. Këtu nuk mund të bëhesh njeri i mirë, sepse shoqëria është e keqe, por shko tek ai fshati atje tej, se atje ka njerëz të mirë, të cilët do të të ndihmojnë". Kjo ishte këshilla më e vyer për këtë njeri. Ai u nis për tek ai fshat, por rrugës i erdhi vdekja. Pati debat mes melekëve të mëshirës dhe të dënimit se kush do ta merrte dhe pasi matën rrugën, ai shpëtoi sepse kishte qenë më afër fshatit ku kishte njerëz të mirë.

Shoqëria e mirë është dhunti prej Zotit të gjithësisë. Për këtë duhet ta falënderojmë Allahun ditë e natë. Ne e falënderojmë Zotin për shëndetin që na ka dhënë, për fëmijët, për pasurinë, për të mirat, por vetëm pak njerëz e falënderojnë Zotin për shoqërinë që u ka dhënë. Shoqëria e mirë është rrizk dhe bereqet prej Allahut (xh.sh.). Profeti (a.s.), ka thënë: *"Atij njeriu që Zoti ia do të mirën, i jep një shok të mirë. Ai të kujton kur ti harron, ai të ngre kur ti rrëzohesh, të drejton kur ti devijon"*³ Shoku i mirë është si puna e pasqyrës. Ti qëndron para saj, rregullon veten tënde dhe i heq të metat nga fytyra jote. Kështu është edhe shoku i mirë. Ai është si dora, që ndihmon shoqen e saj e të dyja bashkë lajnë fytyrën. Ndërsa shoku i keq të shkatërron, edhe pse ti nuk e ndjen diçka të tillë.

Vëllezër! Vallahi duhet ta falënderojmë Allahun (xh.sh.), natë e ditë për shoqërinë që na ka dhënë, se është dhuratë e madhe, që nuk blihet me para.

Shoqëria mes myslimanëve është shoqëri pa interesa. Ne e ndihmojmë njëri-tjetrin vetëm për hir të Zotit. Është e habitshme kur shikon se si vëllai yt mysliman vjen e të ndihmon atëherë kur nuk i ke kërkuar ndihmë, vjen e të rri pranë atëherë kur s'ta pret mendja. Ai lodhet e punon për ty, sepse kështu fiton xhenetin.

A ka shoqëri të tillë në botë? Sot nuk ka shoqëri pa interesa, përveç asaj shoqërie që është ndërtuar mbi bekimin e Allahut (xh.sh.), sepse unë kërkoj xhenetin kur të ndihmoj ty dhe anasjelltas. Kjo është shoqëri dhe rrugë për xhenet, jo vetëm për jetën tjetër, por edhe për këtë jetë. Sot janë të rrallë ata njerëz, që lidhen me njëri-tjetrin pa pasur asnjë interes. Ne myslimanët kemi vetëm një interes të përbashkët e ai është xheneti i Allahut (xh.sh.).

³ **Hadith i vërtetë.** Ahmedi (6/70) dhe Ebu Daudi (2932). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të vërtetë.



*"Atij njeriu
që Zoti ia do të mirën,
i jep një shok të mirë.*

*Ai të kujton
kur ti harron,
ai të ngre kur ti
rrëzohesh,
të drejton
kur ti devijon!*

"Ditën e Gjykimit do të ketë njerëz, që janë ulur në podiume prej drite rreth Arshit të Allahut (xh.sh.). Fytyrat e tyre do të jenë dritë. Nuk janë as profetë e as dëshmorë, por profetët dhe dëshmorët i kanë zili këta njerëz. Ata janë njerëz, që e kanë dashur njëri – tjetrin për hir të Allahut (xh.sh.)"



Profeti (a.s.), tregon: "Një njeri e donte shokun e tij pa pasur kurrfarë interesi. Një ditë ai niset të shkojë për t' i bërë një vizitë atij. Rrugës takon një melek në formën e një njeriu, i cili e pyet:

- Për ku po shkon, o njeri?

- Po shkoj të vizitoj vëllain tim për hir të Allahut – përgjigjet burri.

Meleku vazhdon:

- A mos ke ndonjë interes, tregti apo lidhje familjare me të?

Burri përgjigjet:

- Vallahi nuk kam asnjë interes, as ndonjë tregti e as nuk kam lidhje familjare me atë person, por po shkoj t' i bëj një vizitë vetëm për hir të Allahut (xh.sh.).

Atëherë meleku i thotë:

Unë jam meleku i Zotit. Më ka dërguar Allahu (xh.sh.), që të të them, se Allahu (xh.sh.), të do ty, siç e deshe ti vëllain tënd"⁴

Kjo është shoqëria për hir të Allahut (xh.sh.).

Madje edhe në xhenet nuk do të hyjmë të vetëm, por bashkë me vëllezërit tanë. Zoti nuk i fut besimtarët në xhenet tek e tek, por të gjithë bashkë të kapur dorë për dorë. A e imagjnon këtë kënaqësi, kur Allahut (xh.sh.), të thotë: **"Futuni, o besimtarë, dorë për dorë të gjithë në xhenet"**. Allahu (xh.sh.), kënaqet kur i shikon robërit e Tij, që hyjnë në xhenet të lidhur me njëri – tjetrin, siç ishin të lidhur në dynja. Kjo lloj shoqërie të shoqëron deri në xhenet. Ajo shoqëri që të lë që në këtë dynja, është shoqëri për interes apo për diçka tjetër, por nuk është shoqëri, të cilën e ka bekuar Allahu (xh.sh.).

Profeti (a.s.), ka thënë: "Ditën e Gjykimit do të ketë njerëz, që janë ulur në podiume prej drite rreth Arshit të Allahut (xh.sh.). Fytyrat e tyre do të jenë dritë. Nuk janë as profetë e as dëshmorë, por profetët dhe dëshmorët i kanë zili këta njerëz. Ata janë njerëz, që e kanë dashur njëri – tjetrin për hir të Allahut (xh.sh.)"⁵

Kurse shoqëria e keqe të shkatërron, duke të tërhequr çdo ditë nga e keqja dhe ti nuk mund të dalësh nga ai rreth i mbyllur, sepse nuk mund të largohesh nga shokët e këqinj. Shumë njerëz kanë qenë shumë afër së vërtetës, por është bërë shkak një shok i keq, që i ka tërhequr tek e keqja. Shumë të tjerë e duan të mirën. Nëse i pyet këta njerëz, ata thonë: "Vallahi e duam të mirën, por nuk mund të ndryshojmë dot." Ata e thonë këtë, sepse e keqja i ka rrethuar nga të katër anët.

Tregohet për Ukbe Ibn Rebian, një person që i lindi në zemër të pranonte Islam. Ai u nis për te Profeti

4. **Hadith i vërtetë.** Muslimi (2567)

5. **Hadith i vërtetë.** Hakimi (4/471). Hakimi e vlerëson vargun e hadithit të vërtetë dhe me të pajtohet edhe Dhehebiu.

(a.s.), që të pranonte Islamin. Nëse do të shkonte në Medine tek Profeti (a.s.), ajo do të ishte dita më fatlume e jetës së tij, por për fat të keq ajo kishte qenë dita më e keqe e jetës së tij. Ai kishte një shok shumë të keq, Ebu Xhehlin, simbolin e armikut të Allahut dhe të Profetit të Tij. Ai takohet me Ebu Xhehlin, i cili e pyet: "Për ku je nisur o mik i vjetër?" Ukbe përgjigjet: "Jam nisur për në Medine të takoj Muhamedin (a.s.), sepse dua të bëhem mysliman". Ebu Xhehli ia kthen: "Nëse shkon atje, mos fol kurrë më me mua dhe mos më dil më përpara". Ukbe Ibn Rebia mbeti keq. Ai ishte mes shoqërisë së vjetër të Ebu Xhehilit dhe shoqërisë së re të Muhamedit (a.s.). Zemra e tij anoi nga shoqëria e vjetër. Kështu ai zgjodhi shoqërinë e Ebu Xhehilit dhe ashtu siç qëndroi me të në këtë dynja, ashtu do të jetë në shoqërinë e tij, në zjarrin e xhehenemit në Ahiret. Kjo është shoqëria e keqe.

Allahu (xh.sh.), tregon për një nga banorët e xhenetit, i cili kishte pasur një shok të ngushtë, por nuk e kishte besimin njësoj si shoku i tij. Këtë e futi Zoti në xhenet, ndërsa shokun e tij e futi në zjarr. Pasi u rehatua mirë e mirë, i vajti mendja tek shoku i tij dhe i kërkoi leje Allahut që ta shikojë shokun e tij. Melekët e nxjerrin këtë person në ballkonet e xhenetit dhe ai shikon shokun e tij diku atje në mes të zjarrit të xhehenemit, që po vuante dënimin e tij. Ky njeri fillon të qajë dhe thotë: "Ti ishe shoku im i ngushtë. A e shikon ku të kanë çuar këshillat e tua që më thoshe: "Lëre Zotin, lëre namazin, lëre të mirën, se nuk të duhet ajo punë". "Më paska dashur shumë Allahu (xh.sh.), që nuk më bëri si ti. Po të mos ishte mëshira e Zotit dhe udhëzimi i tij, do të isha bashkë me ty në zjarrin e xhehenemit".

Me këtë që thamë kemi dy qëllime:

1- Qëllimi i parë: A e kërkojmë shoqërinë e mirë, siç kërkojmë rrizkun tonë? Shoku i mirë është xhevahir, është dhuratë prej Allahut (xh.sh.), sidomos në këtë kohë kur e keqja është shtuar në masë. Ky shok të ndihmon e të gjendet gjithmonë pranë. Falënderojë Allahun (xh.sh.), për këtë shoqëri. Bëhu shok i mirë dhe mbaje shoqërinë e mirë. Mos e prish shoqërinë tënde për pak e për shumë. Mos u bëj cinik e as egoist. Munde veten tënde, se këta njerëz nuk do t'i gjesh shumë kollaj.

2- Qëllimi i dytë: Të shikojmë se me kë shoqërohen fëmijët tanë. Nëse fëmija yt shoqërohet me njerëz të mirë, me fëmijë të mirë, do të të lehtësohet gjysma e punës. Por, nëse fëmija shoqërohet me shokë të këqinj, do të të dalë nga duart e do të vijë një moment, që do mallkosh ditën që e le fëmijën tënd të rrijë me atë shok, sepse ai e humb fëmijën tënd. Sot e keqja është shtuar më shumë se kurrë më parë, prandaj le të kërkojmë shokë për fëmijët tanë. Për këtë qëllim, lidhi fëmijët

e tu me fëmijët e besimtarëve. Le të bëhen si tullat e ndërtesës, që mbajnë njëra – tjetrën.

Pyesim veten se ku janë shokët e mirë. Vallahi ka njerëz të mirë, edhe pse ndoshta nuk janë në xhami. Kërkoji këta njerëz. Bëhu shkak që këta njerëz të drejtohen, që t'i kesh shokë të mirë. Njerëz të mirë ka sa të duash, por duhen kërkuar.

Nga ana tjetër, nuk bëjmë thirrje që të shkëputemi nga shoqëria jonë, sepse qenka e keqe. Ne duhet të kemi marrëdhënie me ta, sepse Allahu (xh.sh.), të ka krijuar mes këtyre njerëzve. Duam apo nuk duam ne, nuk mund të jetojmë të vetmuar. Përveç kësaj, nëse ti nuk u flet për të mirën, nuk i udhëzon tek e mira, kush do ta bëjë. Nëse e mira nuk bën përpjekje për ta ndryshuar të keqen, e keqja do të shtohet gjithnjë e më shumë. Le ta lusim Zotin, të na takojë me njerëzit e mirë ashtu siç lutej Profeti (a.s.): "O Zot, më drejto tek njerëzit më të mirë".⁶ Allahu (xh.sh.) i tha: "Mos e largo shikimin nga ata të mirët, edhe pse janë fukarenj..." (Kehf: 28)

Në mbyllje po tregojmë një fjalë shumë të shkurtër të Profetit (a.s.), që ia kalon çdo fjalimi sado të gjatë. Profeti (a.s.), ka thënë: "Shembulli i shokut të mirë është si puna e shitësit të parfumeve. Shitësi i parfumeve, edhe sikur të mos ta japë një parfum për dhuratë, ai nuk të bën keq dhe nuk i vjen erë e keqe. Më e pakta që mund të përfitosh prej tij do të jetë se edhe ty do të të vijë era parfum, erë e mirë. Ndërsa, shembulli i shokut të keq është si puna e farkëtarit. Nëse nuk ta djeg rrobën me zjarr, ai të le erën e keqe të tymit".⁷

Le t'i mbajmë lidhjet me të gjithë njerëzit, por ama kurrë nuk duhet ta shesim shokun e mirë, por ta kërkojmë e kur ta gjejmë, duhet ta mbajmë fort atë, sepse është shok për dynja e për ahiret. Ditën e Gjykimit do të zhduken të gjitha shoqëritë e do të mbetet vetëm shoqëria e atyre, që janë dashur për hir të Allahut (xh.sh.).

E lusim Allahun (xh.sh.), të na japë një shoqëri të mirë e të na bëjë shokë të mirë. E lusim Allahun (xh.sh.), t'i ruajë fëmijët tanë nga shoqëria e keqe e t'i udhëzojë ata për mirë. Lusim Zotin t'i lidhë zemrat tona vetëm për hir të Madhësisë së Tij. Allahu (xh.sh.), na mundësoftë që të jemi të gjithë bashkë në xhenetet e Tij.

Amin!..

6. **Hadith i pranuar për shkak të dëshmime përforcuese.** Ahmedi (5/191). Shejh Ahmed Zejati në verifikimin e tij të musnedit të Ahmedit e vlerëson hadithin të pranuar, ndërsa shejh Shuajbi e vlerëson hadithin të dobët. Hadithin e shënon gjithashtu Hakimi (1/516) dhe Taberaniu në Dua (320, 321). Verifikuesi i librit "Dua" e vlerëson hadithin të pranuar për shkak të dëshmime përforcuese.

7. **Hadith i vertetë.** Buhari (5534) dhe Muslimi (2628)

BOLLGURI ZVOGËLON KOLESTEROLIN, RRRIT EFEKTIN E ANTIBIOTIKËVE

Bollguri është një ushqim që krijohet nga mielli i tërshërës. Interesimi në bollgur është rritur në mënyrë të konsiderueshme gjatë 20 vjetëve të fundit për shkak të përfitimeve të veta shëndetësore.

Studimet kanë treguar që nëse hani një pjatë me bollgur çdo ditë, nivelet e kolesterolit në gjak do të bien për 12 deri në 24 përqind, e sidomos nëse ato janë shumë të larta, për shkak të përmbajtjes së fibrave të tretshme.

Bollguri është burim i pasur me fibër, e cila formon një lloj xheli në zorrët tua që ndihmon në zvogëlimin e absorbimit të yndyrave që hani. Është i pasur me vitaminën E, betakarotinë dhe betaglukan, që ndihmojnë në forcimin e sistemit të imunitetit. Bollguri, rrit edhe efektin e antibiotikëve.

Kur u publikuan zbulimet në vitet e <80, bollguri u bë një ushqim shumë i popullarizuar dhe shumë i kërkuar. Popullariteti i tij u rrit edhe më shumë kur Administrata e Ushqimit dhe Ilaçeve në SHBA konfirmoi që ushqimet të cilat përbëhen nga mielli i tërshërës ose krundet e tërshërës, mund të përfshijnë përfitime për zemrën, nëse kombinohen edhe me një dietë me pak yndyrë.

Bollguri, rekomandohet ta përfshini në menynë e përditshme ushqimore. Ky është njëri prej vakteve më të mira në çdo kohë të ditës, sepse na ngopë, ndërsa nuk shkakton urth. Mund t'i shtoni edhe rrush të thatë, sepse bollguri absorbon thartirën.

PIRJA E KAKAOS ÇDO DITË, RRRIT KOLESTEROLIN E MIRË

Pirja e kakaos çdo ditë mund ta rrisë nivelin e HDL kolesterolit ("të mirë"), bëjnë të ditur hulumtuesit japonez të Ochanomizu University nga Tokioja. Ata studuan 25 burra të shëndetshëm japonez me nivel normal ose mesatarisht të lartë të kolesterolit.

Asnjëri prej tyre nuk kishte marrë barna, antioksidues ose vitamina. Ata nuk kishin as mbipeshë, duke gjykuar sipas mesatares së indeksit të masës trupore dhe nuk kishin pirë shumë alkool.

Së pari, hulumtuesit kontrolluan mostrat e gjakut dhe të urinës së pjesëmarrësve në studim dhe i ndanë në dy grupe. Grupi i parë u caktua të pijë sheqer me përmbajtje kakaosje çdo ditë për 12 javë. Grupit tjetër iu dha të pinë pije sheqerore që nuk përmbanin kakao, po ashtu për 12 javë.

Por grupi i parë nuk pinin kakao të rëndomtë. Studiuesit blenë kokrra të kakaos i poqën, i qëruan dhe i copëtuan ato në laborator. Ata po ashtu analizuan edhe pudrën e kakaos për të qenë të sigurt se nuk kishte humbur sasi të madhe të antioksiduesve gjatë përpunimit.

Në fund të eksperimentit 12javor, pjesëmarrësit bënë disa analiza të mostrave të gjakut dhe të urinës.

HDL dhe LDL kolesterolit

Njerëzit në grupin që morën kakao treguan një rritje 24% të nivelit të HDL kolesterolit. Nivelet e HDL po ashtu u rriten edhe në grupet tjera krahasuese, por në një nivel më të ulët (5% ngritje në HDL).

Hulumtuesit kanë testuar edhe LDL kolesterolin ("e keq") të tyre. Testet kanë përmbajtur disa lloje të 'shprishura' të LDL kolesterolit me disa radikale të lira që mundësojnë procesin e oksidimit. LDL kolesterolit i oksiduar mund të jetë pjesërisht i rrezikshëm, pasi që oksidimi mund të ndihmojë që LDL kolesterolit të grumbullohet në arterie, shpjegojnë hulumtuesit.

Testet laboratorike kanë treguar se LDL kolesterolit i njerëzve që kanë pirë kakao gjatë ditës, për 12 javë rresht, ishte më shumë rezistues ndaj oksidimit, se sa LDL kolesterolit i atyre që nuk kanë pirë kakao.

Sidoqoftë, studimi tregon nivele të njëjta të LDL kolesterolit në të dy grupet, përfshirë edhe LDL e oksiduar (d.m.th. LDL i përgjithshëm), pa varësisht nga konsumimi i kakaos.

Antioksiduesit e kakaos

Kakaoja përmban antioksidues të grupit të polifenolëve, që mund të jenë përgjegjës për rezultatin e studimit, thonë kërkuesit. Por, studimi nuk dëshmon se kakaoja ishte e vetmja arsye për rritjen e HDL kolesterolit të njerëzve.

Hulumtuesit rekomandojnë pije të kakaos çdo ditë për çdokënd. Çaji, vena, pemët dhe perimet po ashtu përmbajnë polifenole dhe mund të ndihmojnë shëndetin e zemrës.

"Për më tepër", janë shprehur ata, "është e pakundërshtueshme se një balancim ditor i ushqimit është i rëndësishëm për mbështetjen e shëndetit të njeriut". Me fjalë tjera, mos llogaritni në kakao për të lënë anash ushqimet tjera.

JAPONI, DHOMA PËR FALJE NË AEROPORT PËR VIZITORË MYSLIMANË

Për shkak të rritjes së numrit të turistëve dhe investitorëve myslimanë, autoritetet japoneze janë duke planifikuar që t'u krijojnë më shumë lehtësi miqve myslimanë, duke bërë dhoma për faljen e namazit në aeroport, si dhe t'u sigurojnë ushqim hallall.

Me afrimin e Olimpiadës Verore 2020 në Tokio, lojërat pritet të tërheqin miliona vizitorë nga e gjithë bota, veçanërisht nga vendet myslimane si Malajzia, Indonezia dhe Azia jug-lindore. Prandaj, Japonia është duke përgatitur veten me kurse trajnimi për të informuar bizneset dhe aeroportet për Islamin, që shërbimet e tyre të jenë të përshtatshme për klientët myslimanë.

Hapat përfshijnë instalimin e dhomave për falje në aeroport së bashku me objektet për pastrim, të cilat duhet të jenë gati deri në Janar.

Islami u prezantua fillimisht në Japoni në vitin 1920, kur myslimanët turk ikën nga shtypja brutale e Bashkimit Sovjetik për shkak të fesë dhe u strehuan në këtë

vend. Në vitin 1930, 1000 myslimanë jetonin në Japoni. Sot, kjo shifër është rreth 120,000.



SHQIPËRIA, VENDI MË I BUKUR PËR T'U VIZITUAR NË 2014-ËN

Viti 2013 po i vjen fundi dhe së bashku më të po i vjen fundi edhe pushimeve për këtë vit. Ajo që duhet



të mendojmë tani, është viti 2014. Ende nuk e dini se ku mund të shkoni për pushime gjatë vitit 2014?

Atëherë lexoni këshillat që iu jep "Yomadic", pas një kërkimi disamujor që ka bërë për të zbuluar gjërat më të bukura të vendeve evropiane.



Po shteti më i bukur në Evropë që vlen për tu vizituar, cili është?

Pa dyshim që në vend të parë renditet Shqipëria. Edhe pse kishte shumë shtete të tjerë që konkurronin, Shqipëria i sfidon të gjitha vendet e tjera.

Kombinimi i pjesëve historike, plazhet, kultura, ushqimi, si dhe vlera e parasë, e bëjnë Shqipërinë vendin më të mirë për tu vizituar përgjatë 2014-ës. Ndër qytetet që vlejnë të përmenden janë Berati dhe Gjirokastra, që janë pjesë e UNESCO-s. Po ashtu edhe fshati turistik, Tushemisht, që ndodhet në Pogradec, buzë liqenit tre milion vjeçar, me ujë natyral të freskët dhe me rrugicat



me gurë, ia vlen që të kalosh pushime të qeta.

Po pse sugjerohet viti 2014 për të vizituar Shqipërinë?

Sepse ky vend ka ende probleme në infrastrukturë, në rrugë dhe turizëm. Por fakti është që Shqipëria ka bërë hapa gjigandë në ndryshimin e gjithë këtyre gjërave dhe pritet të ndryshojnë akoma shumë gjëra të tjera për mirë. Shqipëria po ndryshon shumë shpejt, dhe turizmi po pëson një zhvillim të paimagjinueshëm.

BLIZZIDENT PRODHON FURÇEN E JASHTËZAKONSHME TË DHËMBËVE NË 3D

Njëra ndër aplikacionet më premtuese të shtypit në 3D është personalizimi i objekteve të përditshme e deri tek shtypi i organeve shumë komplekse, siç janë trupat njerëzore.

Njëri prej rasteve të fundit ku kjo teknologji është realizuar me sukses është edhe furça e dhëmbëve e krijuar nga Blizzident, e cila përfshin dy lloje të teknologjive - skanimin 3D dhe shtypin 3D.

Dhe rezultat i kombinimit të këtyre teknologjive është furça magjike e dhëmbëve, e cila ka formën e dhëmbëve tuaj. E tëra që duhet të bëhet, është të kafshohet furça, të kafshohet për ta marrë formën e dhëmbëve për më pak se 6 sekonda, dhe dhëmbët tuaj janë të pastër nga të gjitha anët.

Të paktën kështu thonë krijuesit e saj, të cilët produktin e tyre e kanë bazuar në shtypin e kohëve të fundit, atë në 3D.

Pajisja me furçën e Blizzident është mjaft e thjeshtë. Ju duhet të shkoni tek dentisti juaj për ta marrë për-shtypjen e dhëmbëve tuaj. Më pas ju e dërgoni formën e



dhëmbëve tuaj tek një laborator dentar dhe rezultatet dixhitale i ngarkoni në faqen e Blizzident.

PLASTIKË NGA LËVORJA E BANANES

Projekti i bioplastikës nga bananja i shkencëtares adoleshente nga Turqia fitoi çmimin "Science in Action" në Google Science Fair

Zëvendësimi natyror për plastikën vjen papritmas nga një nxënëse 16 vjeçare. Elif Bilgin nga Turqia ka arritur të prodhojë plastikë nga lëvorja e bananes.

100% natyrore dhe aq thjeshtë për t'u prodhuar saqë, sipas saj, çdokush mund ta bëjë. Me këtë zbulim ajo ka fituar çmimin "Science in Action", 50.000 dollarë, jo i mjaftueshëm për një mrekulli të tillë. Bioplastika e posedon të njëjtën fortësi sikur plastika normale, që do të thotë se nga ajo mund të prodhohet një shishe që do ta mbante ujën. Dallimi i vetëm është se bioplastika

shpërbëhet më shpejtë dhe nuk e ndotë ambientin.

Elifi shpenzoi dy vjet për zhvillimin e projektit të saj, me ç'rast pati 10 dështime. Ose bëhej plastika shumë e fortë, ose shpërbëhej shumë shpejt. Së fundi ia arriti të prodhonte plastikë me vetitë që shumë gjatë i kishte kërkuar.

Ky lloj i plastikës natyrore do të mund ta zvogëlon-te ndotjen e ambientit të shkaktuar deri më tash nga plastika.

